

Profesor në Kolegjin Universitar Norvegjez të Mbrojtjes, i specializuar në çështjen ruse të sigurisë. Në vitin 1997-1998, për interesa profesionale ka ndjekur kursin intensiv të gjuhës shqipe në Shkollën Ushtarake të Gjuhëve të Huaja në Norvegji dhe më pas ka shërbyer në trupat e KFOR-it në Kosovë. Interesi dhe investimi për gjuhën dhe kulturën shqiptare ka qenë i vazhdueshëm dhe ka studiuar shqip me profesorët më të mirë shqiptarë. Në vitin 2013, përktheu nga shqipja në norvegjisht romanin “*Darka e gabuar*” të Ismail Kadaresë dhe 5 vite më pas, në 2018-ën, përkthen romamin “*Kukulla*”.

Përkthyesi nga shqipja në norvegjisht i Kadaresë

JARDAR ØSTBØ

Nuk do ta përktheja një libër përveçse nga gjuha e autorit

Intervistoi Anisa Ymeri

SHËNIME PËR LIBRAT

Vlora Konushevci, “Martesat, valixhet dhe ngarkesat e tjera”, “Onufri”

PERSPEKTIVA E SË PATHËNËS NË MEDIUMIN LETRAR

Nga Alisa Velaj

(fq. 5)

Reflektim mbi një aspekt të librit “Politika si ide” të Valentina Leskajt, “Toena”

KA SHUMË GJËRA PËR TË BËRË, NËSE LINDESH GRUA

Nga Arta Marku Qëndro

(fq. 6)

Xhahid Bushati, “Ku frymojnë ëndrrat femënore”, “Mediaprint”

PËRZGJEDHJE ME PËRKUSHTIM DHE DASHURI

Nga Xhevat Sylva

(fq. 7)

Kulturologji

POETIKA E TRISHTIMIT

Nga Zija Vukaj

(fq. 9)

Një meditim për librin poetik të Ahmet Selmanit: “Embsuame paskajore”

PASKAJORJA POETIKE: NDËRMJET FJALËS (DHE) MUNGESËS

Nga Sevdail Zejnullahu

(fq. 11)



(fq. 12)

Ekam të vështirë t’u qasem këtyre kolosëve, që u përkasin edhe kulturës shqiptare, edhe asaj Eturke, greke apo franceze. Ata me talentin e tyre, u bënë ura të mëdha, ku kulturat bashkojnë, veçmas në Ballkanin tonë. I tillë është edhe Ali Dino (1890-1938), që siç ka shkruar Papantoniu, në nëntor të vitit 1938, në gazetën “Elefteria Vima”: “Ali Dino është një shqiptar, që dallohet nga aksenti i tij. Por përta i përket të tjerave, ai është një artist internacional. Krijimet e tij e vendosin atë ndër karikaturistët më të mirë të Evropës” (cituar nga Luan Rama “Dino, Shtegtari i Portës Sublime”).

ALBUMI I ALI DINOS DHE NJË PORTRET PËR MUSA DEMIN

Nga Enver Kushi

Murgu i famshëm grek i shekullit XVIII

Kostandinos Dapontes Cesarios, vlerësime për shqiptarët dhe poezia e tij për Skënderbeun

Nga Dr. Luan Zyka

(fq. 8)

Romani *Misinterpretation*, kandidat për Booker Prize 2025

Spiralet analitike te *Misinterpretation*, romani i autores Ledia Xhoga

Nga Pol Milo

(fq. 20)



BIBLIOTEKË

Dhimitër Pojanaku

(fq. 10)

Kapriçiot e hënës

Banana Yoshimoto

(fq. 14)

Parandjenjë e trishtë

Përkthyer nga Ledia Dushi

Ballzor Hoxha

(fq. 16)

Nuk kishte arritur as te dera e fqinjëve

Besa Kalaja

(fq. 17)

Në tjetrën dhomë

Valery, Stevens, Heaney, Sorescu, Ligan

(fq. 18)

Lexuesi që bëhet libër

Zgjodhi dhe përktheu : Rudolf Marku

Mehmet Elezi

(fq. 19)

Romeo pa emër

Arben Meksi

(fq. 24)

Karikatura e së shtunës

Romani “Gjithë dashnorët e natës”, i Mieko Kawakamit

Dilema e Dyfishtë e Idealit Femëror

Jo Hamya/NYT

(fq. 21)

Një mace që flet, një identitet që hesht –

Pajtim Statovci

Nga Xhoina Salaj

(fq. 22)

I nderuar Z. Jardar Østbø, do të dëshiroja shumë që këtë bisedë ta nisnim me një kuriozitet që e pata prej momentit kur ju dëgjova të flisnit kaq rrjedhshëm shqip. Është e rrallë që një norvegjez, të mësojë një gjuhë si shqipja dhe ta shndërrojë atë në një gjuhë pune. Si e keni mësuar gjuhën shqipe, për të mbërritur deri në përkthimin e veprave letrare?

Gjithmonë kam qenë i interesuar në mësimin e gjuhëve të huaja dhe veçanërisht më kanë interesuar gjuhët e Evropës Lindore, ato të vendeve të ish-blokut komunist. Menjëherë pas përfundimit të shkollës së mesme kam mësuar gjuhën ruse; kam përfunduar ciklin e parë të studimeve universitare dhe kishte një ofertë për të mësuar shqipen. Mendoja që kjo nuk mund të jetë e vertetë sepse është diçka shumë e bukur për të qenë e vërtetë ngase e dëshiroja shumë mësimin e një gjuhe tjetër. Kjo ndodhi në ushtri! Në Norvegji, ne kemi një shkollë e cila ka shumë traditë për mësimin e gjuhës ruse gjatë Luftës së Ftohtë; shumë njerëz të elitës, kanë mësuar gjuhën ruse si pjesë të shërbimit të tyre në ushtri. Kjo shkollë ka pasur një reputacion shumë të lartë. Kjo ofertë erdhi në vitin 1998, koha e luftimeve në Ballkan dhe kur gjendja në Kosovë ishte shumë e paqetë. Ishte para Luftës së Kosovës, kur UÇK-ja kishte një aktivitet të fortë kundër policisë, kundër ushtrisë serbe. Është befasuese por drejtuesit e shtetit norvegjez në atë kohë, kanë parashikuar se do të jetë një mision paqeruajtës në Kosovë dhe se duhen përkthyes të gjuhës shqipe. Për këtë arsye, ata themeluan një kurs të gjuhës intensive të shqipes në këtë shkollë ushtarake të gjuhëve. Ata mendonin se po, mund të përdoren përkthyesit vendas, por është më mirë kur edhe ushtarakët mund ta flasin gjuhën dhe mund të jenë edhe më profesional. Por edhe banorët vendas ndihen më mirë kështu. Unë kam kryer kursin e parë me një mësues nga Kosova, filolog ishte ai, Rrahim Kërçuku me të cilin mësonim 5 orë në ditë. Ka qenë shkollë, e cila sot quhet "Shkolla Ushtarake e Gjuhëve të Huaja". Po aty kam mësuar gjuhën ruse por kursi i shqipes ishte krejt i ri, dhe 5 orë intensive mësimi, shoqëroheshin me detyrat e shtëpisë.

Por ajo çfarë detyroheshim të bënim më pas ishte, shërbimi ynë në forcat paqeruajtëse. Dhe unë doemos kam shërbyer. Kam qenë në KFOR në Kosovë për 1 vit. Kursi zgjati 1 vit dhe gjatë këtij viti kemi qenë edhe këtu në Tiranë, ku kemi qëndruar 1 muaj dhe kemi marrë mësim nga profesorë të dalluar, Enver Hysa dhe Emil Lafe. Pedagogë të mrekullueshëm që ende jetojnë, për fat.

Si ka qenë ta mësoje këtë gjuhë...

Ju e theksuat në fillim se jeni i pasionuar pas mësimin të gjuhëve të huaja e mbase kjo ju ka bërë përqafues të idesë për të mësuar një gjuhë të re, por shqipja është "gjuhë e një kombi të vogël", ndonëse flitet në të gjithë Rajonin. Është gjuha e një kombi shumë të vogël në Europë.

Për mua atëhere, kjo ishte një sfidë. Isha i ri, ishte diçka shumë interesante dhe ndihesha i veçantë kur e mora një mundësi të tillë. Duke qenë se ishim të

Përkthyesi nga shqipja në norvegjisht i Kadaresë

JARDAR ØSTBØ:


Nuk do ta përktheja një libër përveçse nga gjuha e autorit

Intervistoi Anisa Ymeri

detyruar të shërbenim më pas, kishte dy gjëra të mira: së pari, ishte gjuhë e veçantë; së dyti, do të kishte praktikë. Pra, do të kisha punë dhe kjo është diçka shumë e mirë.

Por edhe kur vij këtu në Shqipëri, njerëzit befasohen nga shqipja ime, dhe kjo hyn tek kënaqësitë e mëdha personale që kam, është shumë e këndshme.

Por nuk u mjaftuat me kaq! Ju, sigurisht në nisje e keni mësuar shqipen për çështje profesionale e që iu ka ndihmuar të bëni diçka më shumë profesionalisht, të cilën pa shqipen, s'do të kishit mundur. Ama e tejkaluat këtë sepse nuk e keni përdorur shqipen tuaj vetëm për çështje profesionale. Erdhi natyrshëm?



Me profesion, mund të thuhet se jam filolog pasi kam kryer Fakultetin e Historisë dhe Filizofisë dhe përherë kam qenë shumë i interesuar për kulturën, letërsinë dhe gjuhën. Sipas meje, ato nuk mund të dallohen pasi janë së bashku, gjithmonë.

Kështu, për mua, kjo ishte diçka e natyrshme pasi vij nga ai fakultet, në të cilin leximi i letërsisë ishte një kusht dhe një pjesë shumë e rëndësishme e shkollimit. Në vijim, kemi punuar shumë për leximin e klasikëve rusë, ndërsa studioja rusisht pasi në një shkollë ushtarake në të cilën mësohet gjuha, përqendrohet në praktikë dhe në gramatikën teorike. Unë jam mësuar që t'i përvetësoj gjuhët në këtë mënyrë, edhe përmes letërsisë dhe leximit. Për mua ka qenë fare pak teori dhe nga dëshira për të mësuar më shumë, praktikojta. Pas periudhës të shërbimit në forcat paqeruajtëse në Kosovë, nisa punë të tjera. U përqendrova në politikën ruse dhe studimet ushtarake, dhe nuk kisha mundësi që të eksploroja botën shqiptare. Por në vitin 2006, ajo shkollë kishte nevojë për një mësimdhënës të shqipes. Vërtet kisha kryer vetëm një vit studim intensiv të shqipes dhe e kisha pak të vështirë, ama kisha shumë përvojë nga terreni, nga mësimi praktik i shqipes, kisha edhe përvojën e filologjisë dhe e mora përsipër këtë sfidë shumë të madhe. Për mua, gjuha shqipe gjithmonë ka qenë e lidhur me sfida të mëdha sepse punoja si përkthyes pas 1 viti shkollimi, që është fare pak por kam qenë i mësuar me këtë gjendje dhe më duhej të luftoja fort për t'u përmirësuar. Ndaj edhe 1 vit, kam dhënë mësim për të tjerë studentë dhe ky ka qenë kursi i fundit që në atë shkollë në Norvegji, u mësua shqipja.

Ju e thatë, që nëse do të mësosh një gjuhë, do të duhet që të lexosh edhe letërsinë e atij vendi. Ndaj, sipas kësaj perspektive, është e zakonshme që ju nisët të lexonit letërsi shqipe. Çfarë keni lexuar për herë të parë nga Kadareja...?

Hera e parë që kam lexuar diçka nga Kadareja, ishte atë vit kur isha edhe mësimdhënës i shqipes në këtë shkollë ushtarake të gjuhëve. Bashkë me studentët e atij kursi, për 1 muaj ne u zhvendosëm në Shqipëri. Ishte një

moment kur isha i lirë nga çdo angazhim pasi mësimin, studentët e merrnin nga Prof. Emil Lafe dhe disa akademikë e pedagogë të tjerë të shqipes. Ishte momenti kur edhe kisha kohë të lirë për të zhvilluar njohuritë e mija të shqipes. Kisha fonde nga shkolla për ta bërë këtë gjë dhe kjo ishte situatë ideale. Prof. Lafe bënte leksione me mua pasdite, ndërsa paradite lexoja **“Kronikë në gur”**. E kam lexuar profesionalisht dhe çdo pyetje që kam pasur, kam marrë një përgjigje gjuhësore nga Prof. Emili. Për këtë shkak, kam pasur një njohje shumë të thellë të kulturës, historisë dhe gjuhës. Ishte viti 2006! **Më pas kam lexuar “Gjeneralin e ushtrisë së vdekur”**. Mua më ka pëlqyer më shumë “Kronikë në gur”. Është një ndjenjë shumë specifike ajo që përcjell ai roman, historikisht por edhe për marrëdhënien mes njerëzve. Mund edhe të thuhet se në fakt, qyteti është protagonist i romanit.

...dhe kur keni shkuar në Gjirokastrë, atë që e kishit përfytyruar përmes leximit të “Kronikës në gur”, e keni gjetur në qytet? Ndjesinë, arritet dot ta përjetoni?

Jo kur isha përpara 2 vitesh! Por PO, kur isha në vitin 2006, bashkë me studentët të kursit të gjuhës shqipe. Ishte një ndjesi shumë e veçantë dhe e fortë. Nuk kishte fare turistë në qytet. E pashë dhe e kuptova se shumë njerëz kishin emigruar dhe qyteti ishte zbrazur, por ndjesia e “Kronikë në gur”, ishte aty. E kam gjetur atë gjendje që përjetova ndërsa lexoja.

Vite më pas, ju morët vendimin për të përkthyer letërsi nga shqipja. Sigurisht, të përkthesh një vepër letrare, sidomos të një shkrimtari të njohur botëror, që edhe lexuesit norvegjezë e njohin dhe e kanë lexuar, por të përkthyer përmes gjuhëve të tjera...

Si e morët ju këtë vendim, për të përkthyer romanet “Darka e gabuar” dhe “Kukulla”?

Nuk mund të kujtoj një moment të caktuar se kur kam vendosur që të përkthej një vepër të Kadaresë por duhet të ketë qenë me siguri viti 2005 kur unë lexoja “Kronikë në gur”, kur më është ngjallur një dëshirë e madhe për ta përkthyer. Dhe për këtë arsye, e kam përkthyer një pjesë të këtij romani dhe e kam dërguar në një shtëpi botuese. Por, më kthyen një përgjigje e cila më stepi: **Është përkthyer! Nuk ka nevojë për një përkthim tjetër.**

Por kur përmbylla studimet e mia doktorale, edhe njëherë kisha kohë të lirë dhe një mik imi që është redaktor i letërsisë në gjuhë të huaj në një shtëpi botuese, kishte dëgjuar se jam i lirë, dhe ishte një rast i mirë për të përkthyer. Ai e dinte se unë isha ndoshta i vetmi që mund të përktheja një autor nga shqipja. Jo për shkakun se kisha një nivel aq të lartë të shqipes, por nuk ka një norvegjez tjetër që mund të përkthejë nga shqipja dhe se përvoja ime në filologji, ishte përparësi. Duhet të them se isha me fat. Ky nuk ishte vendimi im! Ishte vendimi i botuesit dhe unë e kam pranuar me shumë dëshirë. Ishte diçka që do ta bëja me shumë shumë dëshirë.



Ishte sfidë?

Ishte edhe njëherë, një tjetër sfidë me gjuhën shqipe, si gjithmonë!

Por kisha shumë fat që unë kam marrë ato mësimet të shqipes me Prof. Emil Lafen për “Kronikë në gur”. Doemos, nuk janë njësoj por ka shumë gjëra të cilat mund të krahasohen dhe isha i njohur me shkrimtarin, në thellësi...

E kur përkthehet një vepër, sikurse edhe ju e përmendët, nuk mjafton vetëm të njohësh gjuhën, por është çështje e kulturës, historisë, kohës kur ndodhin ngjarjet...janë dije të cilat i keni edhe sepse jeni formuar në histori. Por Kadareja, renditet ndër ata shkrimtarë jo të lehtë për t’u lexuar, edhe nga ne që e lexojmë në gjuhën origjinale. Përgjegjësi e madhe të ndërmarrësh një sfidë të tillë?

Më vjen mirë që kuptoj se, është i vështirë, edhe për ju, jo vetëm për mua.

PO! Është një sfidë e madhe por dua t’i rikthehem edhe njëherë mësimave të vyera me Prof. Lafen, të cilat kanë qenë më shumë se shkollë. Përpara kisha gjithashtu edhe një përkthim të veprave në gjermanisht...dhe kam shfrytëzuar atë tekst për të parë më shumë shënimet sqaruese të përthimit, dhe kjo më ka ndihmuar gjithashtu. Mund të them edhe që kam mësuar shumë gjatë procesit të përkthimit, shumë.

“Kukulla” është një tjetër roman që ju e keni përkthyer...ç’mendon ti për të dhe si e çmon raportin e shkrimtarit me figurën e nënës?

Sipas meje, ashtu siç unë e kam përjetuar leximin, **“Kronikë në gur”, “Darka e gabuar” dhe “Kukulla”,** janë të lidhur më njëri – tjetrin dhe gjykoj se kanë një marrëdhënie të natyrshme, nga njëri tek tjetri. Sigurisht “Kukulla” trajton marrëdhënien e nënës me djalin por edhe mes brezave në përgjithësi; sikurse moderniteti me kohën e vjetër, me periudhën osmane. Është shumë interesante që kur familja mbërrin në Tiranë nga një qytet shumë tradicional, i mbyllur, patriarkal...e vjen në një qytet modern komunist. Të ndjesh këtë marrëdhënie është shumë interesante, të lexoj se si mbetet ajo kulturë e vjetër te nëna, dhe ai shkrimtari gjenial, i cili ka shumë vetëdije...e trajton ethshëm këtë marrëdhënie. Kjo është vërtet interesante, e cila na tregon për një kohë të vjetër disi mistike, si në “Darkën e gabuar”. Pra, vjen pak mistikë në kohën e racionalizmit, që për mua është një nga ballafaqimet qëndrore të të dyja romaneve që unë i kam përkthyer.

Por kjo është më e fuqishme në romanin “Darka e gabuar” ku autori shfrytëzon atë mit dhe lidhet me psikanalizën. Është shumë interesante kur në fund të romanit, kur vijmë deri në ditët tona, me racionalizmin dhe me gjithçka që do të jetë bazuar në shkencë, qartësi, transparencë...por ama njerëzimit i duhen mitet, i duhen paqartësitë. Këtë kumt e kam lidhur edhe me historinë e vetë Kadaresë si shkrimtar gjatë kohës së komunizmit, kur është dashur të jetojë...

Ju mbase keni informacion për këto vepra që keni përkthyer por edhe përtej tyre, e lexojnë Kadarenë në Norevgji?

Po, lexohet!

“Darka e gabuar” mund të them me siguri që ka pasur mjaft lexues. Ky roman në fakt është **botuar edhe në versionin e xhepit**, gjithashtu është në formatin **audio** dhe **e-book**. Kjo është diçka e cila ka rritur shumë ndjeshëm leximin e tij.

Ndaj, secili mund ta ketë në dorë në formatin që dëshiron dhe kjo është diçka fantastike. Nuk mund t’iu them shifra, por mund t’iu them se ky roman i Kadaresë është lexuar nga një numër jo i vogël norvegjezësh si vepra e parë e Kadaresë, e përkthyer nga gjuha origjinale. Ndërsa për romanin “Kukulla” ende nuk i kam këto të dhëna, por njësoj edhe ai gjendet në të gjitha formatet e leximit.

Dua të theksojmë tani, rëndësinë e përkthimit të një autori nga gjuha origjinale dhe jo nga gjuhë të dyta, shpesh edhe të treta...

Kjo është thelbësore!

Sepse nga përkthimi, nuk humbet diçka, por humbet shumë. Bëra një pushim nga leximi i letërsisë dhe aturorëve shqiptarë, pas përkthimit. Më pas jam kthyer për të lexuar “Prilli i thyer” në shqip, por mora për ndihmë një version në anglisht. Nuk dua të gaboj me këtë që them por me shumë gjasë ishte i përkthyer përmes frengjishtes. Kishte keqkuptime direkt mund të them se për fat të keq, nuk ishte “Prilli i thyer”, origjinalin e të cilit unë kisha në dorë. Ama kam dëgjuar nga lexues dhe studiues, vlerësime të jashtëzakonshme për përkthimet e Jusuf Vronit. Por, si përkthyes, në asnjë rast nuk do të kisha vendosur që të përktheja një autor përmes një gjuhe tjetër, veç gjuhës origjinale në të cilën e ka shkruar autori.

Veç Kadarese, ju lexoni vazhdimisht letërsi shqipe. Aktualisht jeni duke lexuar “Shkëlqimi dhe rënia e Shokut Zyllo” të Dritëro Agollit. Si është qasja juaj me leximin e letërsisë shqipe?

Unë kam bërë atë që kanë bërë shumë botues dhe lexues në vende të tjera, duke lexuar Kadarenë dhe vepra e tij pasi ajo është e përkthyer. Por më vjen keq që nuk kam shumë dijeni për autorë, shkrimtarë shqiptarë të tjerë. Veçse tani e kam një listë dhe kam marrë disa libra të autorëve shqiptarë për t’i lexuar. Ajo që dëshiroj është të lexoj më shumë letërsi bashkëkohore shqipe; sikurse dëshiroj shumë të lexoj klasikët e Rilindjes, dhe me shumë gjasë do ta bëj.

Po për romanin “Shkëlqimi dhe rënia e Shokut Zyllo”, çfarë mendoni?

Është një vepër shumë interesante. Në nisje të leximit, mu duk shumë larg nga situata e ditës! Por sa më shumë thellohesha në lexim, aq më shumë kuptoja se ka gjëra universale; e duhet të themi se probleme të tilla ende ka, me to ndeshet secili prej nesh në shoqëritë ku jetojmë, kudo.

Është shkruar me shumë humor dhe me siguri nuk arrij dot që t’i kuptoj të gjitha thumbimet që autori bën përmes personazheve të tij, por për mua është

kënaqësi e madhe të lexoj vepra dhe autorë në gjuhën shqipe.

Ju sigurisht që keni pasur një kontakt profesional në nisje me Shqipërinë, më pas keni filluar të lexoni letërsi, të përktheni, të kërkonit të njihni të tjerë autorë. Ju gjithashtu keni ardhur disa herë në Shqipëri. Përse kjo lidhje me këtë vend?

Ka shumë studentë me të cilët unë e kam mësuar shqipen dhe ata e kanë parë gjithë këtë, thjesht si punë dhe kanë pasur një lloj interesi për gjuhën dhe për vendin. Ndërsa unë kam investuar shumë për këtë gjuhë dhe për këtë kulturë dhe nuk dua kurrësesi ta humbas atë. Kisha pak vite që nuk kisha qenë këtu në Shqipëri ndaj edhe u riktheva me shumë dëshirë, si turist ndonëse për mua, nuk ka ndonjë ndryshim themelor kjo gjë, mes punës dhe pushimit.

Vendi juaj është një vend në të cilin mund të vij, të arrij të pushoj dhe të zhvilloj lidhjen time me kulturën, e cila më intereson. Vendi tjetër më të cilin kam një lidhje shumë të fortë profesionale, për momentin e kam të pamundur të shkoj. Në Rusi nuk mund të shkoj për shkak të sigurisë, pasi gjithçka mund të ndodhë. Madje për një person të lidhur me ushtrinë, do të ishte e rrezikshme. Ndërsa këtu mund të vij dhe ja ku jam, duke i treguar familjes sime se në këtë vend kemi qenë, kemi qëndruar për disa kohë... dhe siç e kam theksuar, është një ndjesi shumë e këndshme kur njerëzit kuptojnë se flas shqip, befasia e tyre, emocioni që më japin. Përveç kësaj, në vendin tuaj ka shumë bukuri natyrore dhe vlera kulturore ndaj edhe përvoja këtu është përherë shumë e mirë.

...për ta mbyllur, mendoni se mund të përktheni diçka tjetër nga letërsia shqipe?

Nuk kam plan për diçka por doemos që kam dëshirë!

Ajo që dua shumë të bëj tani është të përkthej *“Kronikë në gur”* nga shqipja në norvegjisht. I rikthehem dëshirës së parë. Pas atyre mësimëve të vjera që kam marrë nga Prof. Lafe, kam njohuri të mira dhe shumë të mëdha për ta përkthyer atë kryevepër të Kadaresë. Ajo vërtet është e përkthyer në norvegjisht por nuk është e përkthyer nga shqipja dhe kjo do të ishte një vlerë e shtuar për përvojën e leximit të lexuesit norvegjez.

Doemos mund të mendoj për të përkthyer edhe diçka tjetër, por është çështje kohe dhe fondesh. Pas 2 vitesh kur të mos jem më kreu i grupit të punës së një projekti shumë të rëndësishëm, do të gjej doemos kohë për t’iu rikthyer shqipes dhe letërsisë shqipe. Deri atëherë do të kem lexuar edhe autorë të tjerë të letërsisë bashkëkohore shqipe. Aktualisht, njoh edhe një përkthyes profesionist i cili ka njohuri të shqipes dhe do të kem edhe ndihmë prej tij për të mundur që të kemi një përhapje më të mirë të letërsisë shqipe për lexuesin norvegjez. Sot, lexuesi është shumë i përqëndruar në leximin e Kadaresë sepse ai është përkthyer shumë. Është përkthyer gjithashtu Ylljet Aliçka, por ndjesia ime është se ai libër është i shkruar më shumë, mendoj për një



lexues perëndimor në pikëpamje të nivelit kulturor, “Dosja 12...” apo sikurse është në shqip “Rrëfenja me ndërkombëtarë”.

...është e mundur të sigurohen fonde në Norvegji për përkthime

nga gjuhë të vogla, nga shqipja në këtë rast?

Botuesit janë ata që e njohin më mirë këtë realitet, por unë personalisht, kam siguruar një fond si përkthyes për romanin “Kukulla”. Në Norvegji, pjesa

më e madhe e përkthimeve bëhen nga anglishtja ose suedishtja dhe të sigurosh fonde përkthimi nga këto gjuhë, është e lehtë. Ndërsa për gjuhë të vogla si shqipja apo edhe të tjera, ekziston një fond, mund të aplikosh dhe unë jam njëri prej atyre që kam përfituar, por mundësitë janë më të vogla. Çfarë është më e rëndësishme se kaq është që libri i cili përkthehet dhe botohet, të jetë në listën e librave për t’u shpërndarë në rrjetin e bibliotekave shtetërore. Nëse libri i propozuar për botim, mundet të hyjë në këtë listë, kjo është siguri financiare për botuesin dhe kjo është më e rëndësishmja. Për autorë të panjohur, pak të njohur apo për vepra nga gjuhë të vogla, çështja është disi komplekse pasi është e natyrshme se janë në kërkim të titujve të cilët kanë arritur të jenë të suksesshëm në gjuhën e tyre origjinale apo kanë sukses ndërkombëtarisht. Por dikush duhet të bëjë diçka edhe për letërsinë e vendeve të vogla, apo jo?! Megjithatë, gjendja nuk është ideale dhe duhet të kesh dedikim për ta arritur këtë.

Jardar Østbo

Profesor në Kolegjin Universitar Norvegjez të Mbrojtjes, i specializuar në çështjen ruse të sigurisë.

Në vitin 1997-1998, për interesa profesionale ka ndjekur kursin intensiv të gjuhës shqipe në Shkollën Ushtarake të Gjuhëve të Huaja në Norvegji dhe më pas ka shërbyer në trupat e KFOR-it në Kosovë. Interesi dhe investimi për gjuhën dhe kulturën shqiptare ka qenë i vazhdueshëm dhe ka studiuar shqip me profesorët më të mirë shqiptarë.

Në vitin 2013, përktheu nga shqipja në norvegjisht romanin *“Darka e gabuar”* të Ismail Kadaresë dhe 5 vite më pas, në 2018-ën, përkthen romamin *“Kukulla”*.



Shkrimtari është përherë produkt kulturor. Një copëz kulture lë përherë vulën e saj në ADN-në e çdo krijimi. Krijuesi i mirë patjetër se rreket të matet me fuqinë e abstragimit të realitetit në narrativën e tij. Ndërrmarje kjo që përveç talentit të lindur e të farkëtuar të të rrëfyerit, kërkon dhe objektivitetin absolut për ta bindur lexuesin se ajo çka po shijon si letërsi nuk është vetëm e vërteta e shkrimtarit, por para së gjithash e vërteta e tij. Për këtë lloj mentaliteti të lexuesit duhet një sy psikologu i krijuesit të artit të fjalës. Të rrëfesh bukur dhe me vërtetësi kërkon mund që jo gjithkush ia del. Vlora Konushevc i ka ditur t’ja dalë mbanë që në librin e saj me poezi “Lavdi vetes”. Sepse përtej shijes së gjuhës, ka në perceptim mençurinë sokratike, e cila gërsheton të gjykuarit e thellë dhe ironik të realitetit.

Në librin e parë me poezi “Lavdi vetes”, Konushevc është poete e mençur. Drama e asaj që ngjiz përmes poetikës ka në brendi ironinë tejet objektive, gati-gati çarmatosëse. Ajo shpik në vargje atë lloj realiteti që nuk lë vend për lavdinë a askujt, madje as për lavdinë e vetes; shenjë e objektivitetit që vjen prej syrit të psikologes dhe çmitizimit absolut të çdo lloj situatë sadopak mitike. Për çfarë vlen në fund të fundit mitika e gjithçaje që vetëm na rrënon? Për të dashuruar me forcë rrënimin tonë? Për t’u vetmashtuar si individë e mandej si shoqëri? Leximi i tregimeve të saj, sikurse i poezisë ka për ta shpënë lexuesin elitar pashmangshëm drejt këtyre dilemave. Them lexuesin elitar, sepse lexuesi që thjesht e sheh artin si argëtim estetik, i papajisur asnjë gram me mençuri objektive, nuk është lexuesi që do kënaqej prej autores. Konushevc i ka shqisën e njeriut të bekuar prej të kuptuarit, e cila ia sjell pamjet e të vërtetës pa mundim dhe e ndihmon të jetë e lirë në rrëfimin letrar. E lirë në të “vërtetat letrare” përmes një stili që çliron kujtesë, dilema dhe s’pranon t’i ikë situatave siç personazhet e saj i ikin jetës, duke i ikur më së pari vetes.

Vlora Konushevc, “Martesat, valixhet dhe ngarkesat e tjera”

PRESPEKTIVA E SË PATHËNËS NË MEDIUMIN LETRAR

Nga Alisa Velaj

“Po, më ke pa! Të tanë më shohin! Po kuurrë... – dhe pak u ndal, – ...kush s’e din ku shkoj. As unë!.....

- Pra, të dukem sikur udhëtoj a? Ndoshta po.

Por zakonisht thjesht iki prej vetes.....

- Unë nuk jam kështu siç dukem! – sytë i shkuen drejt shishes bosh, – Askush nuk asht.”

Thamë se shkrimtari është më së pari produkt kulturor. Është e pamundur të gjesh një vepër letrare që përjashton qëndrimet, moralin dhe vlerat e shoqërisë, pasi asnjë shkrimtar nuk është rritur plotësisht i paekspozuar ndaj botës që e rrethon.¹ Personazhet e Konushevcit janë ikanakë që duket se vuajnë prej amokut. Gati të gjithë janë ose në ikje prej vetes, ose në ikje prej jo vetes, kur kjo e fundit u është përdhunuar qysh në embrion. Vetë-mashtues serialë, që frikën brenda vetes e mbajnë me pekule dhe ujin barërat e këqinj që u mendojnë shpirtërat. Në tekstin e mësipërm personazhi është si më i kthjellët se tërë personazhet e tjerë; të paktën ai e di se është ikanak dhe asgjë nuk është ashtu si duket. E megjithatë prapë i mungon guximi për

1 Ms.S.Shalini M.A., B.Ed., (M.Phil.), & A. Samundeswari M.A., M.Phil. *Literature as a reflection of the society*, 1st National Conference on Teaching Innovations and Enhancing Learning (Arts, Science And Technology).

të vlarë frikën e pashpjegueshme brenda vetes e për të vepruar e ndryshuar. Kupton por është i topitur. Personazhet e tjerë janë shumë më tepër tragjikë se ai. Kulmi i tragjizmit ndodh kur fëmija, ajo krijesa e re dhe e pafajshme vritet që në embrion në tregimin “Valixhja” prej një pyetje të thiktë si kjo: ““ - Arijetë, ti kujton se Kosova ndërtohet me ndershmëri?”. Prindi nuk e lë fare fëmijën të lindë njeriun përbrenda. Ja denatyron moralin e së mirës prej kreut të ndodhisë “jetë” dhe një krijesë e tillë shndërrohet në një të rritur që nuk di më ç’të zgjedhë për të qenë e përmbushur. Si mund të dijë, kur prej fillimit i është thënë se e bardha është e zezë dhe anasjelltas.

Ajo që bëjnë shkrimtarët është transportimi i ngjarjeve reale drejt trillimit letrar, duke ia paraqitur shoqërisë si një pasqyrë në të cilën njerëzit mund të shikojnë veten dhe ta korrigjojnë kur është e nevojshme.² Për Konushevcin, letërsia është pasqyrë e realitetit, përballje me të pathënat, medium artistik ku sfidohen normat shoqërore me ironi dhe përpjekje për t’i kuptuar kontradiktat në marrëdhëniet dhe identitetet njerëzore. Identitetet e personazheve përpëliten nga të pathëna që torturojnë shpirtin në atë shkallë sa iu bëhet

2 po aty.

e paduruar ekzistenca. Prandaj zgjedhin të gjithë të ikin diku, pa mbërritur dot askund. Kush nuk ka një stacion prej nga nisët, s’mund të ketë akses në një tjetër stacion ku do të mbërrijë. Ajo që mbartim është ajo që i ikim parreshtur dhe bëhemi shtegtarë të një rrethi vicioz, me valixhe në duar ku pesha e absurdit e pakuptimit na kërrus sikur një kryq mbi shpinë. Kryqëzohemi përditë duke shkuar me këmbët tona drejt vdekjeve të mëdha apo të vogla, alegorike apo faktike.

Tregimi “Lavdia” më tepër se ironi e luftës reale të vitit 1999, është paradoks i thellë i një shoqërie ku vdekja dhe lavdia nuk janë ndodhitë e vërteta, përkundrazi ajo që duhet të ndodhë vjen përherë me shkëlqimin fals të vdekjes në emër të lavdisë së palavdi. Një shoqërie që i ngre monument frikës, një popull ku heroizma vlen më shumë se heroi dhe ku heroi është një qenie pa asnjë ideal. Ai di vetëm të vdesë në emër të një lufte në të cilën është përfshirë kur ende nuk ka pasur kurajon të fashisë betejat e shpirtit të tij. Luftrat në të cilat zëvendësohet heroi me heroiken dhe lavdia e vërtetë me monumentet prej guri, prodhojnë paqe tejet të trazuara.

Të gjitha tregimet e librit paraqesin tëhuajzimin e jetës në korridoret e absurdit psikologjik, historik dhe ekzistencial të një shoqërie. Secili ngjan me tjetrin si dy pika uji. Gati krejt duke rendur kuturu, për të formuar një turmë ikanake, të mbytur në dëshpërim dhe padije. Padije se gjithkujt i ka rënë vetja prej duarsh dhe parakalon përhumbshëm në një paradë të madhe, të pandalshme, si lumë i fryrë dalështrati, që përmyt pa fre tokat më të frytshme. Rrëfimi në vetën e parë, si zgjedhje narrative mbase e pavetëdijshme, vjen edhe si apel i një qenie që sodit, habitet dhe pëson katharsisin shpirtëror në të njëjtën kohë me ne që e lexojmë rrëfimin e saj për veten dhe gjithë të tjerët

VLORA KONUSHEVCI



Martesat, valixhet dhe ngarkesat e tjera

OnufriTregime



“Të jesh grua është kaq tërheqëse. Është një aventurë që kërkon shumë guxim, një sfidë që nuk të mërzit kurrë. **Ke shumë gjëra për të bërë, nëse lindesh grua.** Si fillim duhet të përpiqesh të mbështesësh idenë se Zoti, në ekzistoftë, mund të jetë edhe një grua e moshuar me flokë të thinjur ose një vajzë e bukur. Pastaj, të përpiqesh të shpjegosh se mëkati nuk lindi ditën kur Eva këputi mollën; atë ditë lindi një virtyt i shkëlqyer i quajtur mosbindje. Në fund, duhet të përpiqesh të dëshmosh se brenda trupit tënd, të lëmuar dhe me forma, ka një inteligjencë që ulërin për t’u dëgjuar”.

Në aspektin formal, nuk është thënë mirëfilli kështu, fjalë për fjalë, si të “Zemërimi dhe krenaria” i Oriana Fallacit. Po fundja, ç’vlerë do të kishin përkime të tilla? Por konceptualisht gjen shumë pika të përbashkëta me sa më sipër te “Politika si ide” (Toena, 2021). Nuk është një libër mirëfilli për gruan, nuk do ta quaja as një libër mirëfilli feminist, por e ka të theksuar këtë përmasë teksa gruaja është fund e krye e pranishme, si pikënisje dhe si synim. Edhe kur flitet për politikën, për demokracinë, për demografinë, për fenë, për rrugëtimin në tranzicion, për të djeshmen dhe të sotmen, për botën dhe Shqipërinë, për protagonistë të historisë... gruaja është pjesë, gjithnjë. S’ka si të mos jetë. Ndaj te kjo anë e librit “Politika si ide” dua ta vë fokusin, që zë fill te pena që e ka shkruar: një grua, Valentina Leskaj. Me përvojën e angazhimit në media, në shoqërinë civile¹ dhe në politikë, Leskaj rrëfen, te “Politika si ide”, botën rreth saj; nxjerr në pah shenjat që kanë identifikuar kohën përgjatë të cilës ka ecur; tregon gurët e qosheve pa të cilët një ngrehinë nuk qëndron dot në këmbë, si koncepte dhe si individë; figurat që i kanë skalitur ata gurë... një mjedis i tërë në të cilin gruaja, këndeje dhe andej kufijve, qëndron me dinjitet. Njëherësh gjithçka e rrëfyer jashtë e rrotull saj është e lidhur me nyje të pazgjidhshme me atë që është brenda, me autoren. Sepse gruaja e parë e librit “Politika si ide”, përveçse një fill përshkues e lidhës, është vetë Leskaj me përvojën e saj, e cila mbi pikat mbështetëse, që është bota e fakteve dhe e informacioneve, duke i interpretuar ato, ndërton botën e IDEVE... si një nga **gjërat e shumta për t’u bërë, nëse lindesh grua...**

“Politika si ide” ka disa përkime të papritura mes grave të librit dhe autores së tij. Në fund të fundit, ndërsa **ka shumë gjëra për të bërë, nëse lindesh grua...** kryesisht ato gjëra janë përbashkuese edhe kur kohët dhe vendet të ndajnë.

Si grua, Valentina Leskaj ndalet tek të ngjashmet e saj, të shumta e sidomos të rëndësishme, emra që kanë shënuar historinë tonë e të botës, të cilat ajo jo vetëm i ka takuar por disa herë kanë qenë bashkëprotagoniste në momente kulmore. Megjithatë unë dua të përqendrohem te një shqiptare, edhe për faktin se vazhdon të jetë e mbështjellë me një tis opak, ende sot sikurse në fillimet e diktaturës, sado që jo për të njëjtat arsye. E kam fjalën për Ollga Plumbin. Vetë shpluhurosja e saj është **një gjë që duhet bërë, nëse lindesh grua.** Jo rastësisht Leskaj e ka zgjedhur si një protagoniste që hap faqet e para të librit. Në pamje të parë, nisur nga profili i theksuar feminist që ka pasur, duket sikur nuk mund të mungonte në një libër që titullin e kapitullit hyrës e ka “Gratë, një histori e shkurtër e feminizmit”. Por nuk është vetëm kaq. Prania e pashmangshme zë fill në momentit kur Valentina Leskaj,

1 “Angazhimin në shoqërinë civile e quaj kohën kur jam ndier më mirë, është një ndjesi që ta jep angazhimi që e bën si zgjedhje personale në shërbim të një komuniteti – qoftë edhe të vogël – është çështje lirie që ta mundëson qenia e pavarur, mundësia për të menduar me kokën tënde, brenda misionit, rolit që ti vetë ke zgjedhur të bësh”, *Politika si ide*, f. 90.

Reflektim mbi një aspekt të librit “Politika si ide” të Valentina Leskaj

KA SHUMË GJËRA PËR TË BËRË, NËSE LINDESH GRUA

Nga Arta Marku Qëndro

asokohe gazeta re, shkoi ta intervistonte Ollgën tashmë të tërhequr e në hije, rrethuar më së shumi nga librat e bibliotekës së saj, në banesën e Rugës së Kavajës të “mbuluar nga heshtja”². Ollga ishte një magnet për Valentinën e re, edhe pse atëherë s’kishte si ta pikaste shenjën paralajmëruese për përkimet e mëpasme: Ollga si autore e shkrimeve në mbështetje të gruas në vitet ’30-’40, Valentina po ashtu në vitet 1984-1988, si kryeradaktore e revistës “Shqiptarja e re”; Ollga deputete e parlamentit shqiptar të vitit 1945; Valentina po ashtu, edhe pse në një kohë tjetër, shumë të ndryshme sigurisht e njëherësh të ngjashme sa i përket pranisë jo fort të ndjeshme të grave në ato mjedis. Mënjatë gjërat e tjera që krijojnë hendek mes dy grave, pasojë e kohëve në të cilat jetuan dhe e fateve. Te përkimet dua të rrimë, **te gjërat për të bërë, nëse lindesh grua:**


“Vajzat le të shkojnë të bëjnë dashuri,

2 *Politika si ide*; f.30

vëllezërit ta kuptojnë se është normale”³, shkruante Ollga në vitet ’30-’40 të shekullit të shkuar, në të njëjtën kohë kur Dija e Haki Stërmillit guxoi ta bënte dhe dështoi. E ndërsa Dijet ekzistojnë edhe sot thuajse pas një shekulli - vajza që guxojnë të jenë të lira e burra, vëllezër, baballarë që ua presin rrugën - në veprimtaritë me emërues të përbashkët të drejtat e gruas, Valentina Leskaj nuk kishte si të qëndronte në distancë humnerore me Ollga Plumbin e as me shumë gra të tjera që ka zgjedhur t’i përfshijë në librin e saj. Koha kalon, por **shumë nga gjërat për t’u bërë, nëse lindesh grua**, janë shpesh të njëjta, domosdoshmërisht të përsëritura.

Kur Ollga Plumbi shkruante me pseudonimin Shpresa, dhe thoshte pikërisht se “*gruaja shqiptare është në padijeni mbi gjithë të drejtat që i janë dhënë dhe do të shkojë shumë kohë gjersa ajo mund të përfitojë prej tyre*” me siguri shpresonte se 90 vjet kishin për të qenë një kohë e mjaftueshme. Por, me gjithë ndryshimet e pamohueshme, dhuna

3 *Pilitika si ide*, citim, f.27



mbetet, ndërsa vetë gratë ende s’e dinë plotësisht të drejtën që u përket.

“Jo pak, por 75% e grave të intervistuar në një studim të fundit, mendojnë se dhuna ndaj grave në familje është një problem i madh. Viti 2019 pati mbi 3000 raste dhune me bazë gjinore të raportuara ndërkohë që dihet se në Shqipëri ajo është e nënraportuar. Shumë gra nuk guxojnë të shkojnë e të raportojnë në polici, të tjera nuk e kanë as informacionin për këtë mundësi, pra nuk i njohin të drejtat e tyre dhe institucionet ku mund të drejtohen. Ka edhe nga ato që mendojnë se burri ka të drejtë ta rrahë gruan.” Kësaj here është Leskaj që e thotë. Dhe e thotë në vitin 2021 duke iu referuar një studimi të vitit 2019. Ndërsa mua më vjen shpeshherë para syve, dhe jo vetëm gjatë këtij reflektimi, një grua me shami në kokë që i buzëqeshte kamerës dhe thoshte me një siguri befasuese: “*Gruaja e bën veten që burri ta rrahë*”. Ndoshta fjalët kujtesa i ka ndryshuar, por jo thelbin dhe as tronditjen time tek shihja atë program televiziv të pak kohëve më parë. S’ka dyshim: sfida vazhdon të jetë po aq e mprehtë për gruan dhe guximi për ta përballuar lypset po aq i madh sa ç’e përshkruan Oriana Fallaci, ende sot... Ndaj vazhdon të ketë **shumë gjëra për të bërë, nëse lindesh grua.**

Mes **shumë gjërave për t’u bërë, nëse lindesh grua**, është të qartësosh keqkuptimet lidhur me feminizmin. Sepse “shpesh feminizmi është parë si një qasje kundër, jo pro, në kuptimin kundër tjetrit, te ndryshmit në gjini”⁴. Leskaj me të drejtë këmbëngul se burrat nuk duhet të shihen si pjesë e problemit, por si pjesë e zgjidhjes.⁵

Sigurisht gruaja ndihet e diferencuar përballë burrave, marginalizohet më së shumti prej vetë burrave, pëson dhunë prej burrave. Por ndarja në dy kampe të kundërta sjell luftën si pasojë dhe lufta, edhe në mbaroftë, ka një fitues e një humbës, ndërsa qëllimi i vënies në vend të të drejtave të gruas nuk është humbja e burrave, por të qenët bashkë në një rrafsh burra dhe gra. “Edhe përvoja ka treguar se përfshirja e tyre⁶, aty ku është realizuar, ka dhënë rezultat”. Nuk është gjëja më e thjeshtë për t’u bërë, sigurisht. Në libër Leskaj sjell në kujtesë seminarin e parë për të drejtat e grave, për zgjedhjen e lirë dhe të drejtat riprodhuese që shoqata e saj pat organizuar në ato fillimvitet e epokës së re. “Mes grave që mbizotëronin numerikisht kishte dhe 2-3 burra. Nuk ishte e lehtë për të pasur më shumë. Dhe ata pak burra, u shqetësuan kur pikasën kamerat dhe mbuluan fytyrën me dorë, “edhe pse ishin nga ata që mbaheshin si njerëz mendjehapur. E kam të freskët edhe sot këtë skenë të vitit 1993.”⁷

Shpresa ishte një pseudonim që e pat zgjedhur Ollga Plumbi, me siguri për të përçarur atë që ndiente (fundja nuk luftonte kot) dhe për ta injektuar. Por edhe Leskaj shpresën nuk ngurron ta përçojë, pse jo edhe për ta injektuar. Në fund të fundit është shpresa dhe besimi që nuk e lënë

4 *Politika si ide*, f. 45.

5 *Politika si ide*, f. 45.

6 *Burrave*, f. 45.

7 *Politika si ide*, f. 50



shpërfillëse ndaj disa dritëzave që i sheh të ndizen në mjedisin përreth. Ndaj kur flet për një protestë që u pat bërë me rastin e dhunimit të një 15-vjeçareje në një shkollë të Tiranës, nuk e lë pa përmendur shënimin në pankartën që mbante në dorë një djalë i ri: “Burrat e vërtetë janë feministë”.

Ndër gjërat e shumta për t’u bërë, nëse lindesh grua është mpresja e shqisave dhe gjetja e këndit të duhur të shikimit. E para pasojë është njohja e drejtë: njeh gjendjen e gruas, njeh kufizimet e saj; njeh po ashtu prapaskenën e shifrave që edhe kur duken optimiste nuk janë doemos pasqyrë e një vizioni. Sepse: *“Në kulturën tonë qasja ndaj këtij problemi” shpesh është i orientuar jo si një detyrim i shoqërisë, jo si një e drejtë njerëzore, jo si një nevojë e vendit për të rritur potencialet, por si një mirësi apo favor që u bëhet grave”*⁹. Në shekullin XXI jo gjithnjë koncepti i të drejtave të gruas shihet si plotësisht i barabartë me konceptin e të drejtave të njeriut... ndërsa Ollga Plumbi e pat artikuluar qartë qysh më 1936¹⁰.

Njohja e Leskajt nuk është thjesht dhe vetëm teorike. Ajo e njeh terrenin, e ka shkelur vetë me këmbë, e ka zbuluar në mënyrë të drejtpërdrejtë, për një kohë të gjatë: teksa ka biseduar me Ollgën hijerëndë, të lirë dhe sfiduese, rrethuar nga librat e bibliotekës dhe revistat e gazetat e shumta me artikujt që vetë i shkroi mbi çështjet e gruas, ka takuar edhe gruan dibrane që punonte tokën buzë rrugës ndërsa makina e redaksisë së revistës “Shqiptarja e re” po e çonte për një reportazh. Nuk ishte aspak gruaja tipike e trumbetuar nga propaganda socrealiste, me lopatë në dorë, por me buzëqeshje rrezëllitëse. Nën një tis dëbore që binte nga qielli i hirtë, veshur vetëm me një triko të lehtë, një fund të hollë mbi pantallona, një shami nape mbi kokë dhe këpucë llastiku, dukej plotësisht e nënshtruar ndaj fatit, “si mijëra gra të tjera që kam pasur rast t’i takoj në të gjithë Shqipërinë për shkak të të qenët në gazetari”¹¹. Nëna e 10 fëmijëve që i ushqente “me bukë e ujë, e nëse kam i shtij edhe pak sheqer”¹² ishte një nga faktet e radhës për të kuptuar se **ka shumë gjëra për të bërë, nëse lindesh grua**.

“...Do të doja të lindeshe vajzë. Nuk jam aspak dakord me mamanë time që mendon se të lindesh vajzë është fatkeqësi”, është sërish Oriana Fallaci, kësaj here në librin “Letër një fëmije që kurrë s’u lind”. Sigurisht në njërën anë është Oriana Fallaci, përballë saj e ëma sikurse për analogji në njërën anë mund të jetë Valentina Leskaj dhe përballë saj dibrania shpinëkërrusur që punonte tokën nën flokët e dëborës dhe mezi i ushqente 10 fëmijët. **Gjërat për t’u bërë, nëse lindesh grua** janë më të domosdoshme për të dytat, por nuk janë fort të lehta as për të parat. Sigurisht, të lindesh grua, je e detyruar, ende sot, të ecësh në rrugë të vështira e plot pengesa që të tjerët t’i vënë përpara edhe thjesht se je grua; por ecja nuk është e pamundur, përkundrazi, lënia e gjurmëve po ashtu bashkë me rrëfimin e përvojave si leksione edhe për të tjerët...

“Politika si ide”, mund të konsiderohet një gjurmë e njëherësh leksion. Në fakt është një leksion i shumëfishtë, por ai lidhur me gruan, fort i rëndësishëm, përpos gjithçkaje, ka edhe vlerën se është i shkruar nga një grua që beson te domosdoshmëria e shumë gjërave për t’u bërë...



Xhahid Bushati, pas shumë librave me poezi dhe me përralla për fëmijë, por edhe pas shumë lirikave për të rritur që herë pas here i publikon në fejsbuk, e sidomos pas librave studimorë për letërsinë për fëmijë, por edhe librave të tjerë monografikë, e pasuroi opusin e vet, por edhe të letërsisë sonë në përgjithësi, edhe me një libër të vlefshëm, i cili do të duhej të bëhej pronë e më shumë lexuesve si një thesar i veçantë. Fjala është për antologjinë e poezisë shqipe për fëmijë e të rinj, me titull simpatik dhe intrigues “Ku frymojnë ëndrrat feminare”, botuar para pak kohe nga Shtëpia botuese Mediaprint në Tiranë,

E paralajmëruar më parë nga autori, kjo antologji zgjoi kureshtjen e lexuesve dhe të atyre që merren me krijimtarinë letrare për fëmijë e të rinj në radhë të parë për faktin se ajo pritej nga një shkrimtar i dëshmuar për vlera të mirëfillta letrare për fëmijë, sidomos në poezi dhe në shkrimin e përrallës, por edhe për kontributin e veçantë në fushën e studimit të letërsisë sonë për fëmijë dhe jo vetëm të asaj. Xhahid Bushati është autor i shumë përmbledhjeve me poezi për fëmijë dhe i përmbledhjeve me përralla, por edhe autor i disa librave studimorë në fushën e krijimtarisë letrare për fëmijë; është i nderuar me disa çmime të shumta letrare dhe aktualisht është njëri prej autoriteteve të çmuara në fushën e krijimit dhe të mendimit për letërsinë tonë për fëmijë dhe të rinj. Përvë kësaj, Xhahid Bushatit duhet përmendur dhe duhet t’i jemi falënderues si opinion lexues, por edhe si kulturë kombëtare në përgjithësi edhe për disa libra të tjerë me të cilët ai shpalos shpirtin e vendlindjes së vet Shkodrës nëpër vite, nëpërmjet shkrimeve për shumë figura të shquara të fushës së letërsisë, aktrimit, muzikës, të artit në përgjithësi, madje jo vetëm të këtyre fushave, por edhe institucioneve siç është teatri,

si dhe shkrimeve për të shquar të tjerë që kanë lënë gjurmë në jetën tonë kulturore, shkencore etj.

Puna në sajimin e një antologjie të krijimeve letrare, qoftë në prozë apo në poezi, është me shumë përgjegjësi, ngase ajo mund të ketë mirëkuptime, por edhe keqkuptime nga lexuesit e veçmas nga krijuesit letrarë, meqë iu ofrohet shijeve dhe pritjeve të ndryshme. Kjo do të ketë qenë aq më e vështirë për antologjinë e poezisë shqipe për fëmijë e të rinj, meqë në këtë fushë, që nga fillimet e deri sot, kemi një armatë të tërë krijuesish të cilët kanë dhënë kontributin e tyre të çmueshëm.

Autorit me njohje dhe me përgatitje çfarë ka Xhahid Bushati është vështirë t’i shpëtojnë të pavërejtshme vlerat e njëmendta. Kjo ishte pritja e parë që do ta ketë pasur lexuesi nga antologjia e poezisë shqipe për fëmijë e të rinj, hartuar nga ai. Ai këtu fokusohet në krijimtarinë tonë poetike moderne për fëmijë dhe të rinj. Përfshin autorë të njohur për përkushtimin e tyre dhe për rezultatet në krijimtarinë, duke filluar nga brezi i parë i shkrimtarëve, të cilët e çuan më tej atë që ishte nisur nga rilindësit, si Qamil Guranjaku, Spiro Çomora, Mark Krasniqi, Rexhep Hoxha, Bekim Harxhi, Anton Çetta etj., e deri te brezi shumë i frytshëm i shkrimtarëve, si Bedri Dedja, Odhise Grillo, Vehbi Kikaj, Xhevat Beqaraj, Ismail Kadare, Rifat Kukaj, Dritëro Agolli, Adelina Mamaqi, Agim Deva, Ymer Elshani etj). Përzgjedhja e autorëve dhe poezive që bën Xhahid Bushati për antologjinë e tij kalon nëpër një sitë shumë të shpeshtë, të mëndafshhtë do të thoshim. Nga ajo rrodhën 58 poetë me vlerat e tyre poetike. Në këtë mënyrë, autori Bushati lan një borxh ndaj krijimeve që i ka pëlqyer dhe i ka regjistruar në mbamendjen e tij gjatë leximeve. Këtu janë përshtirë shkrimtarët që shquhen në krijimtarinë poetike,

përkatësisht ata të cilët krijimtaria poetike i bën të njohur në letërsinë për fëmijë, tek të cilët poezia dominon si lloj më i suksesshëm letrar i tyre, pavarësisht se ndonjëri do të ketë shkruar me sukses edhe tregimin, romanin apo dramën. Për këtë arsye në këtë antologji ndoshta mund të mungojë ndonjë emër i njohur në letërsinë tonë për fëmijë për shkakun se, sipas vlerësimit të autorit, do të jetë i më njohur në një lloj tjetër të krijimtarisë letrare për fëmijë e të rinj. Me këtë problem jam ballafaquar edhe vetë gjatë sajimit të një antologjie pak më ndryshe të poezisë shqipe për fëmijë e të rinj (Kuvendim poetik, 2010), për çka janë dhënë disa sqarime të nevojshme që në parathënie.

Ajo që bie në sy posaçërisht për të mirë është se autori i kësaj antologjie vëren dhe përzgjedh poezi vërtet antologjike të autorëve të përfshirë. Ndërton dhe respekton një koncept unik për të gjithë autorët, duke dhënë shënime biobibliografike për ta dhe duke përzgjedhur një krijim poetik nga secili. Shënimet biobibliografike jepen përafërsisht në vëllim të njëjtë, sipas një skeme të caktuar. Ndërsa ajo që posaçërisht bie në sy për të mirë dhe është më e rëndësishmja, është përzgjedhja e suksesshme e vlerave që prezantohen këtu.

Në veshin e ballinës së përgatitur bukur artistikisht autori jep një poezi të Odhise Grillos, e cila përseritet prapë në antologji, mirëpo këtu jepet që në fillim të librit, si një krijim përfaqësues i llojit të krijimit letrar. Ndërkaq në veshin e shpinës së kopertinës jepet një fragment - sintezë e autorit, ku thuhet: “Antologjia poetike përfshin 58 krijues shqiptarë të cilët, me krijimtarinë e tyre kanë lënë gjurmë në fushën e poezisë shqipe për fëmijë dhe të rinj. Gjeografia e kësaj antologjie përfshin autorë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Greqia Gjermania, SHBA-ja etj. Kjo antologji, krahas karakterit njohës, shpërfaq kontributet e çmuara të krijuesve shqiptarë, ku shumë prej tyre iu kushtuan posaçërisht poezisë shqipe për fëmijë e të rinj. Nuk mund të mohohet kurrsesi vlera e poetëve që erdhën nga poezia për të rritur dhe plotësuan e dritësuan më tej portretin e letërsisë shqipe dhe të kësaj antologjie.”

Përveç shumë autorëve të njohur, të cilët janë të pakapërcyeshëm në sajimin e çfarëdo antologjie të poezisë sonë për fëmijë e të rinj, bie në sy, po ashtu, edhe një qasje e përgjegjshme edhe ndaj disa emrave e vlerave të cilat nuk na ka rënë shumë të përmenden kohës së fundit, por që i takojnë poezisë sonë për fëmijë. Të gjendet në këtë përzgjedhje edhe emri i Drago Siliqit, ta zëmë, për shumëkë mund të ishte e papritur, meqë ai ka kohë që ka shkruar në amshim në mënyrë tragjike dhe nuk është përmendur aq shumë së paku si krijues për fëmijë, por kjo nuk i ka shpëtuar njohësit të shkelqyeshëm dhe përcjellësit të vëmendshëm të zhvillimit të poezisë sonë për fëmijë, Xhahid Bushatit. Madje, kur shihet me çfarë poezie prezantohet ai këtu, lexuesi s’ka si të mos e pëlqejë këtë përzgjedhje. Ngjashëm, befasi e këndshme, del të jetë edhe prezantimi i Toni Papuçiut, pastaj edhe i Ledia Ikonomit Bostic, e cila pas disa kontributeve në letërsinë për fëmijë, ka kohë që jeton në Perëndim dhe nuk është përmendur aq shumë nga kolegët shkrimtarë, as nga kritikët studiuesit e letërsisë për fëmijë. Edhe pse lexuesi i vëmendshëm do të ketë informacionin për fatin dy shkrimtarëve të përmendur dhe si rrjedhojë edhe për krijimtarinë e tyre të këputur herët, kur sheh me çfarë krijimesh përfaqësohen ata, gjithsesi do ta admirojë autorin dhe do ta plëlqejë përzgjedhjen. Kështu lexuesi do ta vërtetojë edhe më mirë qasjen dhe njohjen e mirë të lëndës nga autori, i cili këtu na del një arkivist i vlerave të cilat nuk harrohen nga lexuesi i vëmendshëm, sado që duhet të mirëkuptohet edhe subjektiviteti i tij si hartues i kësaj antologjie. Ai bën përzgjedhjen edhe të autorëve, edhe të krijimeve poetike, përcakton vëllimin e antologjisë, duke i marrur të gjitha përgjegjësitë, bazuar para së gjithash në njohjet dhe vlerësimet që ka. E, Xhehaid Bushati, edhe me këtë libër, si edhe me libra të tjerë studimorë i jep një kontribut të veçantë mendimit kritik dhe studimor për letërsinë për fëmijë e të rinj. Edhe këtë, si edhe shumë shkrime të tjera të kësaj fushe, ai i shkruan me kompetencë, me përkushtim dhe dashuri,

Këtë antologji e bën edhe më të pëlqyeshme edhe përgatitja artistike jashtëzakonisht bukur, si dhe shtypi cilësor, për çka meriton mirënjohje dhe lëvdatë të posaçme Shtëpia botuese “Mediaprint”.



8 Fuqizimi i gruas.

9 *Politika si ide*, f. 61.

10 “Akoma jemi shumë prapa në fitimin e të drejtave njerëzore”, Ollga Plumbi cituar te “Politika si ide”, f. 26.

11 *Politika si ide*, f. 85

12 Po aty

Kostandinos Dapontes Cesarios është një figurë e shquar dhe interesante e shekullit 18-të në botën pasbizantine të letrave greke. Ai kishte lindur në ishullin Skopelos nga prindër latinë, të cilët kishin jetuar në ishullin e Andros ku kishte edhe shumë banorë arvanitas të hershëm.

Dapontes përshkoi një jetë gjithë peripecira dhe aventura në qendrat më të njohura ballkanike të shekullit të 18-të; si në Stamboll, në Bukuresht, në Jash etj., pranë sundimtarëve të fuqishëm dhe personaliteteve të kohës.

Ai ishte studjues, rrëhmihës i arkivave, mbledhës dorëshkrimesh. Dapontes ishte shkrimtar dhe poet me vetinë e veçantë se shkrimet e tij i shkruante në vargje, dhe bile me rimë të admirueshme, nëpërmjet të cilave shprehte njohuritë e tij historike, idetë, përshkruante ngjarjet dhe mbresat nga jeta e tij dhe e personazheve të shumtë, të njohur dhe të panjohur.

I mërzitur dhe i zhgënjyer nga jeta publike, ai u dorëzua murg në vitin 1753, ku mori emrin Cezarios, dhe u mbyll në manastire të ndryshme të Malit të Shenjtë

Tashmë si murg, ai kishte lënë shtegtimin e tij gjeografik, duke shtegtuar në botën e dijes, nën dritën hyjnore të manastireve, ku iu përkushtua shkrimeve të shumta fetare, gjeografike, etnografike, socio-antropologjike dhe filologjike të historisë njerëzore që nga lashtësia deri në epokën e tij.

Mbi jetën dhe veprën e tij kanë shkruajtur gjerësisht emrat më të shquar në fushat e tyre si Emile Legrand, Stathas, Nestur Camariano si edhe shumë studjues të tjerë deri në ditët tona.

Në vitet e fundit të jetës, Dapontes udhëtoi nëpër Greqi, në Ballkan dhe kryesisht tek Principatat Transdanubiane për të mbledhur ndihma financiare për manastirin, dhe me paratë e mbledhura ndërtoi dhe zbukuroi kishën e manastirit të Kseropotamos, ku bashkëpunoi me ikonografët e famshëm shqiptarë, vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi (Vako).

Njohja e Dapontes me botën shqiptare

Për një karakter kërkues dhe ngulmues si ai, me etje për të njohur botën dhe i bredhur në hapësirën ballkanike, nuk do ishte e habitshme edhe kontakti i tij me botën shqiptare.

Edhe pse bota shqiptare në atë kohë, gjendej e kredhur në mugëtitirën e historisë dhe në përpëlitjen e shndërrimeve të thella etnoformuese.

Në veprën e tij, “Fjalë panegjirike” të botuar në vitin 1778 në Venedik, Dapontes përshkruan racat e ndryshme të botës së lashtë deri tek koha e tij, duke i karakterizuar ato me cilësinë më të dallueshme në karakterin e tyre.

Dhe vlerësimin e tij për shqiptarët Dapontes do ta shprehte vetëm me një me një fjalë, por fjalë si mal.

Dapontes i cilëson shqiptarët me shprehjen, “Trimëria e shqiptarëve - Αλβανών το εύρωχον”. Po ku e njihte Dapontes karakterin shqiptar ?

Nëpër arkivat e manastireve ku rrëhminte papushim murgu i etur për dije ?

Në Stamboll, apo në botën Vllehe me plot bujarë dhe sundues shqiptarovlleh ? Në historira gojore në netët e gjata të jetës monastike ?

Kishte dëgjuar emrin e tyre nga prindërit e tij, që kishin jetuar në ishullin Andros plot me shqiptarë arvanitas?

Apo kishte jetuar nga afër mes shqiptarëve ?

Nga hulumtimet që kam kryer deri tani për veprën dhe jetën e Dapontes, kam gjetur dokumenta ku dëshmohet se murgu i famshëm ishte njohur me botën shqiptare në gjithë shtegtimin gjeografik dhe shpirtëror të jetës së tij.

Dapontes ka jetuar edhe ka bashkëpunuar me shqiptarë të shquar që jetonin në Shqipëri, si edhe njihte shumë mirë biografinë e kryeshqiptarit Gjergj Kastrioti Skënderbeut.

Në burgimin e tij 20 mujor në Stamboll, në vitin 1747, për shkak të keqbërjeve të tij ose makinacioneve të armiqve të tij në oborrin sulltanor, ai ka qëndruar në qeli me një shqiptar nga Përmeti, (ose nga zona e lumit të Shkumbinit, sipas disa burimeve të tjera), i cili, pasi u dënua me vdekje nga turqit (sepse nk pranonte të ndryshonte besimin fetar), u bë shenjt i Kishës Ortodokse me emrin Shën Kristo Alvaniti (ose kopshtari).

Dapontes e përshkruan karakterin dhe virtutet e Shën Kristo Alvanitis me shprehjet me të bukura në vargjet që shkruajti për të.

*Kristo ishte emri tij, krishter i vërtetë
shërbëtor i bindur i Krishtit, siç thoshte ai vetë,
dyzet vite ishte mosha e tij,
punonte si kopshtar atje në Shqipëri (Αρβαντίαν).*

*Fatlum jam që bashkë në një qeli jetuam,
për besimin e patundur aq shumë biseduam.*

Gjithashtu, kur Daponte ngriti kishën në manastarin Kseropotamos në Malin e Shenjtë (Mont Athos), ikonografët që pikturuan kishën u përgjodhën nga vetë Dapontes, dhe ata ishin vëllezërit e mirënjohur Kostandin dhe Athanas

Murgu i famshëm grek i shekullit XVIII

Kostandinos Dapontes Cesarios, vlerësime për shqiptarët dhe poezia e tij për Skënderbeun

Nga Dr. Luan Zyka

Zografi (Vako) me origjinë nga krahina e Mokrës, me ndihmësin e tyre Naum, (të cilët u paguan me 80.000 grosh për punën e tyre.

Bile në përzgjedhjen e figurave të shenjtëve të ortodoksisë, Dapontes përzgjedhi të viheshin edhe dy martirë të rinj me prejardhje nga Shqipëria, Shën Kristo Alvaniti dhe Oshënar Nikodhimos nga Elbasani, të cilët deri atëhere nuk i njihte as opinioni i gjerë fetar.

Dapontes për Skënderbeun

Ndoshta, edhe kjo njohje me mbresa jetësore nga personalitete të ardhur nga Shqipëria ka ndikuar në interesimin e treguar prej Dapontes ndaj emrit, veprës dhe bëmave të Skëndebeut.

Në shkrimet e tij ai i kushton vargje lirike në përshkrimin e figurës së Gjergj Kastriotit Skënderbeu si simbol i lirisë dhe dinjitetit njerëzor.

*“Kastrioti i dytë, Gjergji i Krujës,
ai fitimtari i pathyeshëm, trimi ngadhnjmtar.
Skënderbe i thotë vetes ky trim legjendar
prijës i Shqipërisë dhe i Epirit mbarë.
Ati i tij fatlum emrin e kish Gjon,
sundimtar i Arbërisë sot e përgjithmon.
Ai pati katër djem, por më shumë shquar
ish vet’ Gjergji, plot fam i rrethuar.
Peng i dha të katër djemtë, tek sulltan Murati
për të jetuar në paqe, u detyrua i ngrati
Kur sulltani e pa Gjergjin nëntë vjeçar,
trupin e fuqishëm, i hijshëm djaloshtar,
shumë i pëlqeu, sa e bëri synet,
dhe emrin Skënderbe ia zgjodhi ai vetë
si Aleksandri i Madh i Maqedonisë së lashtë
sepse vetëm ai i ngjante atij në trimëri.
E mësoi me dije, strateg për ushtri,
në luftëra të pafundme gjithmonë fitimtar,
kudo i dalluar për trimëri të rrallë,
askush tjetër nuk pati lavdi si ai.
Por një ditë sulltanin e braktisi, për At dheun e tij,
zuri vendin e të atit në fronin që i takonte,
kundër Muratit luftoi dhe e mposhti me trimëri,*



*ashtu si edhe mposhti pasardhësit e tij.
Vazhdoi fitimtar dhe pse ra Bizanti,
gjithë jetën e tij i lirë dhe fitimtar.
Historia e tij plot bëma dhe fitore,
me vlera virtuti, me frymë hyjnore.
Ky është një libër me njëzet fashikuj,
Gjithë bëmat e tij aty janë shkruar.
I ndarë në dyzet kapituj,
ky libër kaq i rrallë dhe aq shumë i kërkuar.
Për atë kanë shkruajtur pesë historianë,
Dhositheos, Meletios dhe të tjerë nga çdo anë.*

Gjithshtu interesante janë vargjet e tij, ku ai dëshmon se ka në arkivin e tij një dorëshkrim për bëmat e Skënderbeut, dhe shpreh brengën e thellë për për tu gjendur dikush të financonte botimin e kësaj vepre me vlera të mëdha jo vetëm historike, por edhe didaktike dhe morale, sa ai e cilëson se ky libër do të ishte i denjë dhe i vlefshëm edhe për Psalmoditë kishtarë (Ψαλτήρι). Të tillëa vlera mësimore dhe morale i jepte Dapontes historisë së Skënderbeut.

*“Kam edhe dorëshkrimin e bëmave të ty,
deri sa rroi dhe shkoi në përjetësi,
I rrallë ky dorëshkrim për jetën e tij,
ah, dikush ta botonte, do të hynte në histori !
Këtë vepër plot vlera dhe hire vërtet,
Një libër i duhur do ishte edhe për në Psalmet*

Edhe pse studjues të shumtë të veprës së Dapontes kishin mësuar nga shkrimet e tij se murgu zotëronte dorëshkrimin e Skënderbeut që ai shkruante, deri para ca vitesh ai nuk ishte gjetur akoma.

Për fat, që jo gjithmonë u ndin shqiptarëve, një tjetër shqiptar i shquar, dhe fatkeqsisht pak i dëgjuar në botën akademike dhe kujtesën shqiptare, At Evlogjio Kurila nga Ziçishti i Devollit, kishte depozituar në arkivin e tij në Universitetin e Janinës, edhe dorëshkrimin e Skënderbeut që përmend Dapontes në shkrimet e tij.


Studjues të specializuar grekë që e zbuluan këtë dorëshkrim dhe e botuan kohët e fundit, kanë dale në përfundimin se doracaku me titull “ Bëmat heroike të Gjergj Kastriotit”, është shkruajtur nga një tjetër kronikan i shquar grek prej fanariotëve të Stambollit, K. N.

Por me këtë skanderbeg-as tjetër, do të merremi në kapitujt që pasojnë studimin tonë.

Këto fakte nga jeta dhe vepra e Kosntandin Dapontes Cesarios, përbëjnë shtysë për të vazhduar më tej hulumtimin në dorëshkrimet e shumta të tij, me synim zbulimin e fakteve të reja rreth botës shqiptare të mbledhura apo të shkruajtura nga murgu i famshëm, i cili në shekullin e 18-të, në veprat dhe jetën e tij, i vlerësoi shqiptarët për trimërinë e tyre të paepur, për qëndresën shenjtërore ndaj vlerave shpirtërore, edhe për talentin e tyre krijues artistik.

Brezi i parë romantik nuk ishte Baq i tërhequr nga nata dhe nga makabriteti, sesa nga natyra dhe ëndrra. Për këtë shkak në lëndën e ngjyrave parapëlqimet e tyre shkuan para së gjithash ndaj të gjelbrës dhe blu-së, vetëm në një moment të dytë ndaj të zezës. Në gjysmën e dytë të shekullit XVIII, për herë të parë në Perëndim, ideja e natyrës nuk është më e lidhur sistematikisht me katër elementët (ajri, uji, toka, zjarri), siç kishte qenë praktikisht gjithmonë nga Aristoteli e më pas, por me vegetacionin. Tashmë natyra është e përbërë nga livadhet e pyjet, nga pemët dhe prozhet, nga gjethet dhe degët. Është bërë një vend pushimi e meditimi dhe merr kështu një vlerë metafizike; në fshat Krijuesi duket se është më i pranishëm se në qytet dhe manifestohet në një mënyrë tjetër, në një mënyrë më të drejtpërdrejtë e paqësore, në të njëjtën kohë. Natyrisht, ide të tilla nuk janë krejtësisht të reja, por në periudhën 1760- 1780 marrin një rëndësi të tillë, sa ndikojnë në ndryshimin e ndjeshmërisë. Veçanërisht për sa u përket ngjyrave. E gjelbra, deri atëherë e shpërfillur apo pak e dashur nga poetët, bëhet ngjyra e preferuar e dashnorëve të natyrës, atyre “shëtitësve të vetmuar”, për të cilët Zhan Zhak Ruso u bë këngëtar. Dhe jo vetëm e gjelbra, por edhe bluja, ngjyra e ëndrrës, sepse këta shëtitës humbisnin në ëndrrat e tyre dhe aspironin botë të paarrtishme. E mistershmeja “lule blu” për të cilën flet Novalis (1772- 1801) në romanin e tij të papërfunduar “Heinrich Ofterdingen” është ndoshta simboli më i përsosur i këtyre kërkesave të pamundura, por krijon një pikë mbërritjeje, jo një pikë nisjeje. Moda e blusë romantike fillon një brez më parë, me gjasë në vitin 1774, kur Gëte boton romanin e tij epistolar “Vuajtjet e djaloshtit Verter” dhe e vesh heroin e tij me një xhakë të blu të kombinuar me pantallona të verdhë. Libri ka një sukses të paparë- nga më të mëdhenjtë e të gjitha kohëve- dhe “werthermania” vërshon në të gjithë Evropën, duke arritur më pas deri në Amerikë. Jo vetëm artistët duan t’i paraqesin me pikturë apo gdhendje skenat kryesore të romanit, por së paku për dy dekada të rinjtë donin të visheshin “alla Werther” dhe mbanin të famshmin kostum blu.

Një tjetër ngjyrë, megjithatë, fshihej në hije dhe priste çastin e saj. Në fillim të shekullit që vjen, në fakt, e gjelbra dhe bluja e romantikëve apo e pararomantikëve rezultuan thuhet të zhdukura dhe e zeza nisi të merrte epërsi gjithandej. Në lidhje të ngushtë me natyrën, me ëndrrat e së bukurës e të pafundësisë ndodhin ide pastërtisht më të errëta që do të mbeten në plan të parë në skenën letrare dhe artistike për gati tre breza. Për të refuzuar sovranitetin e arsyes, për të shpallur mbretërinë e emocionit, për të derdhur lotë dhe përdëllyer nuk mjafton më: heroit romantik është bërë një personazh i paqendrueshëm e i ankthshëm, që jo vetëm rikthen “lumturinë e parrëfyeshme të qenies së trishtuar” (Viktor Hygo) por beson se është shenjuar nga fataliteti dhe ndihet i tërhequr nga vdekja. Që në vitet gjashtëdhjetë të shekullit XVIII- “Kështjella e Otrantos” të Horac Walpole del në vitin 1764- romanet “gotikë” anglezë kishin vendosur një lloj shijeje për makabren, por kjo modë u theksua në fundin e shekullit. – “Misteret e Udolfos” të Ann Radcliffe dhe të 1794, “Murgu” të



Matthey G. Lewis të 1795- dhe me të e zeza bën kthimin e saj të madh. Është triumfi i natës e i vdekjes, i shtrigave e i varrezave, i të jashtëzakonshmes e i fantastikes. Vetë Satanai rishfaqet dhe bëhet heroit i poezive të panumërta e i shumë tregimeve- në Gjermani ato të Hoffmann; në Francë ato të Charles Nodier, të Théophile Gautier e të Villiers. “Fausti” i Gëtes ushtroi në këtë fushë një ndikim të njohur, sidomos pjesa e parë e tij botuar në 1808. I frymëzuar nga një personazh historik- një astrolog i shekullit XVI, i bërë personazh legjendar- heroit i Gëtes bën një pakt me Mefistofelin (një prej emrave të Djallit, “ai që nuk do dritën”): në këmbim të shpirtit të tij, ky i fundit i premtonte Faustit t’i kthejë rininë e humbur dhe me të të gjitha kënaqësitë që mund të kënaqin shqisat e tij. Historia zhvillohet në një atmosferë vëçanërisht të zezë. Nuk mungon asgjë: nata, burgu, varreza, kështjella e rrënuar, qelia, pylli, shpella, shtrigat dhe sabati, nata e Valpurgës në lartësitë Blocksberg, në malet e Harzit. Epoka e Verterit duket shumë e largët dhe kostumi i tij blu është zëvendësuar, nën penën e Gëtes, me një paletë që nuk mund të bëhet më e zezë.

Me romantizmin vetë nata fiton një përkohshmëri të veçantë. Për të gjithë poetët ajo është në të njëjtën kohë e ëmbël dhe mizore, vend strehimi dhe ankthesh, fantazmash e udhëtimesh të errëta. “Himnet e natës” të Novalis (1800) e “Netët” e Myse (1835-1837) janë një përgjigje ndaj “Ca net” të Edward Yung, botuar disa dekada më parë (1742-

1745). Këto meditime, të mbizotëruara nga ideja e vdekjes, qenë përkthyer në të gjitha gjuhët e Evropës dhe në vazhdim të shoqëruara nga gdhendjet në stilin marramendës të William Blake (1797). Në “Natë dhjetori” Muse është sflitur nga një personazh misterioz që merr hera- herës aspekte të ndryshme (një fëmijë i varfër, një jetim, një i huaj), por që është gjithnjë “i veshur në të zeza” dhe i ngjan poetit “si një vëlla”. Shopen bën të njëjtën gjë në shumë prej “Nokturneve” të tij (1827- 1846), duke e përkthyer në muzikë këtë temë të dukjes së dyfishtë natën. Gjithkund mbizotëron një ndjenjë trishtimi, kjo e keqe e shekullit, që në mesjetë konsiderohej një sëmundje e vërtetë- etimologjikisht, një teprim i vërit të zi (malinconia)- dhe që për poetët e shekullit XIX bëhet një kusht i detyrueshëm, gati një virtyt. Çdo poet ndjente se duhej të ishte melankolik, të ishte i destinuar të vdiste i ri (Novalis, Kits, Shelli, Bajron) ose të mbyllej në një zi të pashërueshëm. Zherard de Nerval e bën më mirë se çdokush tjetër në fillim të sonetit të tij “El Desdichado”- I pafati, (1853), në katrenën më të njohur të të gjithë poezisë franceze:

“Unë jam i errët,- i ve, i dëshpëruar,
Princ i Akuitanës me kullë të hequr:
I vetmi yll ka vdekur,- e mbi udë të
yllëzuar
Është shtypur diell i zi, veç trishtimi
ka mbetur.”
(shq. z.v.)
Ky diell i zi, që kthehet shpesh në veprën e Nervalit dhe ka pa dyshim

origjinën e vet piktorike në një miniaturë të shekullit XIV, ka zënë vendin e lules blu të Novalis. Është simboli i një brezi të tërë që kënaqet nga sëmundja e vet dhe paralajmëron vargun e frikshëm dhe çjerrës të Charl Bodlerit të disa viteve më vonë: “Satana, ki mëshirë për vuajtjen time të gjatë”. Marrëveshja e Faustit me djallin mbetet më aktuale se kurrë.

Përveç kësaj, një rrymë “fantastike” përshkon pothuajse gjithë shekullin XIX. Edhe pse në frëngjisht kjo fjalë bëhet emër vetëm në vitin 1821, ajo çfarë shenjon është e mëparshme. Nuk bëhet më fjalë për mrekulli përrallore të romantizmit të parë, por për një rrymë shumë më të zezë, në të cilën bëjnë aleancë grotesku, okultja, tërbimi, e madje satanizmi. Ezoterizmi e spiritizmi janë shumë në modë; disa poetë mblidhen në varreza, të tjerë kërkojnë të praktikojnë magjinë e zezë, të tjerë akoma janë anëtarë të shoqërisë sekrete apo marrin pjesë në bankete të përmortshme, duke pirë pije alkoolike në kafa boshe. Akoma në fundin e shekullit në romanin “Në kthim” (1884), Joris Karl Huysmans (1884- 1907) e fillon tregimin e tij duke ndërmendur një të tillë “drekë të përzishme”, të shërbyer nga zezake të zhveshura në një sallë ngrënieje me perde të zeza, ndërsa një orkestër e padukshme luan marshe funebre”. Konsumohen vetëm ushqime të zeza, të errëta apo ngjyrë lejla dhe pihen pije të kësaj ngjyre:

“Ishin shërbyer në pjata me bordurë të zezë, lëng breshke, bukë thekre ruse, ullinj nga Turqia, havjar, putarga qefulli, pastiche të tymosura të Frankfurtit, kafshë gjahu në salcë jamballi apo lustrues këpucësh, krem tartufi, krem i qelibartë çokollate, ëmbëlsira alla angleze, kumbulla, konserva rrushi, mana të zinj, qershi të zeza. Kishin pirë në gota të errëta, verëra të Limanjes e të Roussillon, të Tenedos, të Val del Peñas e të Portos dhe, pas kafesë e rakisë së lëkurës së arrës, ishte shijuar kwas, birra e zezë stout.”

E njëjta shije për zinë dhe vdekjen shfaqet në fushën teatrale në vitet njëzet të shekullit XIX. Nuk ngurohet më të tregohet në skenë dhuna dhe krimi. Fundi i shekullit XVIII kishte zbuluar Shekspirin; romantizmi shtyhet më tej dhe përshtat nga shumë prej personazheve të tij, prej të cilëve bën perënditë e veta mbrojtëse. Hamleti, sidomos, bëhet një hero romantik dhe kostumi i tij i zi, një uniformë e vërtetë, shumë më e ngjashme në ndjeshmëri dhe në modën e momentit sesa kostumi blu tepër për së mbari i Verterit, tashmë krejtësisht i dalë nga moda.

Shoqëria nuk bie më poshtë dhe e bën të zezën ngjyrë mbizotëruese të veshjes mashkullore, një tendencë e destinuar të zgjasë shumë. Dukuria fillon të shfaqet në vitet e fundit të shekullit XVIII, theksohet në kohën e revoluconit francez- një qytetar i nderuar duhej asokohe të vishte një kostum të zi- triumfon në epokën romantike, humbet gjatë gjithë shekullit XIX dhe shteron vetëm në vitet njëzet të shekullit XX. Konsideratë, qoftë për veshjen elegante, atë prej ‘dandy’ dhe të personave të botës, ngritur në modë nga Brummel në Angli rreth vitit 1810, qoftë të burrave me pasuri më modeste, garderobera e të cilëve është e kufizuar dhe që besojnë (mbase me pafajësi?) se gjejnë tek e zeza një ngjyrë mbi të cilën papastërtia dhe ndotja lënë më pak gjurmë.

YJET NDRIÇOJNË GJETKË

Qielli im,
Pa yje sonte.

Unazë gurërënë.

Pas kurrizit të maleve
Fshehur,
Yjet plangprishës,

Kukurisin!

GJUMI I PAQES

Ka vetëm ullinj dhe pleq.

Ullinjtë kohë pa shkundur,
Pleqtë kohë pa dashuri.

Era e detit ngjitet fshatit mbrëmjeve.

Trillon lojëra fëmije,
Symbylltazi,
Me kukulla,
Trena,
Kollotumba.

Trillimezbehur,
Futet nën fustanellat e plakave,
Qemerët e hapur të pleqve,

E tallazit ç'ka mbetur nga erotika.

Paqja,
E dehur prej qetësie,

Flet përçart.

PAK DRITË

Hapini perdet e rënda.
Një brumbull,
I vogël, i brithhtë
I bruztë,
Ka ngecur në cergën e marimangës,
Ngritur në qafën e murit
Dritares karshi.

Është kërthi,
As të përpëlitet,
S'di.

Hapini perdet!
Drita furi,
Marimangën mund ta shpjerë në verbim,
E rrjetën ta anojë,
Shqepë.

Pak dritë!

SMOG

Udhëkryqeve,
Plaka të murrme,
Ngrohen semaforëve jeshil.

Lumenjtë,
Mërzitur nga jeta e ciganit,
Afrohen burimeve,
Kllaposin kapakët,

Kthehen në shtëpi.

Dashuritë e gënjyera,
Mbyllen si molusqe,
Digjen në vetvete.

Vatrave,
Një shi i marrë,
Ngrin zjarrin.

Qyqet,
Arratisur pyjeve,

Ngrejnë fole strehëve.

PENDIMIT

Në je prej vërteti,
Hyr brenda mishit dhe gjakut tim,
Qetësoma e bindma,
Palcën fajtore.

Në je prej gjoje,

DHIMITËR POJANAKU

Kapriçiot e hënës

Poezi



Në ke hedhur një vel gënjeshtre
Vetëm për t'u ushqyer nga besimi im,
Për të më vënë mendjen në gjumë

Vetthumbohu,
Helmohu,

Dhe
Vdis!

KTHIM I LOPËVE NGA KULLOTA

Tek hidhen nga njëra anë e fushës te tjetra,
Gjinj muzngarkuar,

Kanë orët e paradës së modës.

Para shoferëve,
Kërkojnë çmim,
Çmim për gji - më - mbushurën,
Çmim për lëkurën më vezullonjëse,
Çmim për elegancë
Fodullëk.

E fundit,
Ec dalë e ngadalë,

Sa për tërë karvanin.

KAPRIÇIOT E HËNËS

Zbret çdo mbrëmje në luginë.
Vë buzët lumit,
Rrjedha, brilant në gushë të errësirës.

Rrokulliset zallit
Gurët, gjinj të butë, të bardhë.

Fërkohet trungjeve të pemëve,
Palca verbon kilometra larg.

Krejt pa shkak,
Braktis luginën,

E lëshon pa dhimbje mbi krahët e territ.

MUNGESË

Muaj pa detin.

Më mblidhet syri,
Dhe trupi.

Lëkura e çlirët,
Si këmbët e vogla brenda këpucëve të mëdha.

KORÇËS

Përnatë,
Parvazeve,
Gjoja ujit sardellat,
Po synë ia shkel fushës.

E etur për të ngulur katër kunjja,
Si këmbët e një shtrati të ri.

Përse kjo etje për t'u madhuar,
mbretëreshë?
Gënjeshtër të ish paqja e mbretërimit,
Mos të bukurën dhe të llastuarën
E ndjek adolishenca në çdo moshë?!

Përse sakaq kërkon të rritesh sa për
dhjetra qytete,
Te kesh metro
Si njeri të dytë nën vete,
Shina omnabuzësh, vena nën lëkurë,
Semaforë si unaza të stërmëdha mbi
gishta topolakë.

Kot hiqesh sikur të pëlqen!

Nën këmishën tafta,
Ti përnatë,
I afrohesh shtratit të vjetër
Si dimrave,
Mangallit

Ku prushi derdhet nga barku i zjarrit.

QENI I VERDHË

Qeni i zi,
Pullali.

Nata e zezë,
Perçebardhë.

Qeni do hënën
Hëm, hëm,
E pengojnë drurët.

Qeni përplas kokën drurëve,
Dang, dang,
Dhinbjen nuk e ndjen.

Qeni
Leh
Mbyturazi.

Degët grinden.
Qeni sa s'puqet me hënën,
Hëm, hëm,

Hallka e pengon.

Qeni përdredh qafën të lirojë hallkën,
Kërcen edhe më, edhe më...

Hidhërim.
Qeni fle.

Dylli i hënës pikonm mbi kolibe.

Qeni gthin i verdhë.

ZËRA TË NJOHUR

Sa shuaj dritën,
Sa vë kryet mbi jastëk,
Si insektet nga frymëmarrja,
Vdekja më gjen,
Më zukat në vesh.

Si ngrohet mirë e mirë nga frika ime,

Kërcet dhe ikën

PËRRENJTË

Ketra të roitur.

Marathanomakë idhnakë.

Nga mali i thepisur,
Me vrap të marri,
Bëlldum,
Në lumë.

Lavjerrës kryekrisur,
Rënë në boshllëk.

Deteve,
Shohin bëmën e marrëzisë.

Brejtur pendimesh,
Kthehen në rryma rrufeje,
Vorbulla blu,
Jeshil hakmarrjesh,

Kthehen në erëra zhvarrimi.

VERË POLARE

E hidhët kjo vera e sivjetme.
Mëngjes, mesditë e mbrëmje,
Më mërdhijnë gishtat e këmbëve,
Më mpihen thonjtë.

Trishtimi,
I përkëdheluri im,
Kur u rritka sa nuk e nxë shtrati,
Sillka ftohtë.

Më kërkon të vesh çorape dimri,
Ngjyrë jargavan të çelët,
Grafisur mbi thembër me lule të egër.

Përndryshe,
As zjarrin nuk e lë të më ngrohë.

ERIS

Kur jep dashuri,
Veço një pjesëz të zemrës.

Rrethoje si vendroje!

Qarkuar,

Do mbetet syzgjuar,
Mendjendriçuar,
Pakëz e djallëzuar,

Do mbetet
E palënduar,
E paanshme,

Gjykimftohtë.

Ajo copëz e veçuar,
Kullë fari,

Çon zemrën,

Tek fole e dashurive të mëdha.

TABLLO

Mbi kodër,
Në thepisje,
Dhjetëra shtëpi,
Brinjë më brinjë,
Shpinë mbi shpinë,

Mezi marrin frymë.

Nën kodër,
Nën thepisje,

Varreza,
Vrojton luadhet.

Libri poetik *Embsuame paskajore* i Ahmet Selmanit mund të lexohet si një liturgji e gjuhës dhe e qenies - një përpjekje për të kapur përjetësinë jo si kohë lineare, por si mënyrë të të menduarit, të të jetuarit dhe të të shkruarit.

Që në poezinë e parë, autori na vendos përballë një urdhri poetik e metafizik: paskajorja nuk është thjesht formë gramatikore, por mënyrë e qenies, një frymë që nuk përmbillet kurrë dhe: *“Due me lanë diçka përmbas vetes / diçka që s’ka me u shterue as sot as mot.”* Kjo nuk është vetëm dëshirë për kujtim, por për një mbijetesë të qenies përmes gjuhës - një gjuhë që nuk e mbyll kuptimin, por e shtyn gjithnjë më tej, si një testament që nuk pranon fund.

Vargu: *“e që ka me shëmbëllye si përjetësi paskajore...”* shënon thelbin e një etike poetike që refuzon përfundimin, që kërkon ta mbajë fjalën të hapur, të përjetshme në mundësi, jo në zgjidhje. Poezia qëndron kështu në një tension të qëndrueshëm ndërmjet pranisë dhe mungesës, ndërmjet zërit dhe tërheqjes së tij.

Arkitektura e fjalës që nuk mbyllet

Cikli *“Lashtësi paskajore”* nuk fillon me përkufizim, por me një urdhërim të mitologjizuar: *“dhe mbasi e krijoi njeriun / hyji tha: / së pari due me ta dhanë / frymën / zanin / e gjuhën / e ti duhet me e shqiptue / çdo gja / veç në mënyrë / paskajore.”* Këtu, paskajorja nuk është më një kategori gramatikore, por një formë ontologjike shqiptimi: mënyra si qenia përshfaqet në botë përmes gjuhës.

Ajo që vihet në lëvizje nuk është vetëm një estetikë poetike, por një etikë e gjuhës: të mos e mbyllësh fjalën, të mos e pronësosh kuptimin, të mos vendosësh pikë. Paskajorja është akt i frymës - mënyrë e të qenurit që nuk zotëron, por dëshmon, që nuk ndalet, por shpërndahet. Gjuha nuk artikulohet për të përcaktuar, por për të përhapur një ndjeshmëri që nuk ka kufi.

Kështu, në *“Buzukiadë paskajore”*, paskajoret e Mesharit nuk lexohen si forma të vjetra, por si dëshmi të një ligjërimi që rrjedh jashtë kornizës. *“me kujtuom e me endigluom e me shkruom...”* - nuk është rikthim nostalgjik, por vazhdimësi ritmike e një gjuhe që nuk e përmbyll dot veten. Shkrimi bëhet dëgjim, kujtim, ndjesi - një ushtrim i përlësisë përballë asaj që nuk mund të thuhet plotësisht. Në *“Endigluome paskajore”*, akti poetik shndërrohet në dëshirë për t’u bërë ajër - jo për të humbur, por për të qenë i përthithshëm. Të mos mbetesh emër, por frymë që mbushet e kalon përmes të tjerëve. Kjo nuk është fshirje, por një mënyrë e të qenurit që nuk ngul këmbë në vetveten. Vetja bëhet media – jo autoritet i fjalës, por bartës i saj.

“Gjamë paskajore” e çon këtë logjikë drejt kufirit të ndjeshmërisë: klithma, vajtimi, thirrja nuk janë shprehje emocionale, por mënyra të shkrimit të dhimbjes përmes trupit. Gjuha, këtu, nuk shërben për të qetësuar, por për të shkundur. Akti i vajtimit bëhet një formë e dëshmisë së pakufishme, ku fjala nuk mjafton, prandaj kërkohet trupi për ta shqiptuar dhimbjen që nuk përkthehet.

Bukuria nuk është më pamje, por mënyrë qenieje që nuk përkufizohet, që as nuk zotërohet, as nuk pushtohet. Ajo ekziston si impuls që ndez, që të shtyn në një gjendje paskajore të përndezjes, ku fjalët rrëshqasin, ku vështrimi nuk kërkon pronësi, por përjetim.

Mikpritja e paskajores është akt pa kufi, një liri që e zhvesh veten nga mbrojtja. Ajo është një logjikë dhënieje që nuk pret kthim, që ndërton ferrin për vete në emër të një tjetri që nuk kërkon asnjë garanci. Edhe kjo është formë e paskajores: të jesh i hapur ndaj humbjes për të ruajtur mundësinë e tjetrit.

Figura e Gjeto Bashës përvijon një brengë: jo për vdekjen, por për humbjen e fjalës që këndon. Në kthimin e tij nuk ka ringjallje, por rikthim të humbjes së fjalës si akt. Paskajorja është e vetmja mënyrë për ta ruajtur këtë zë - një mënyrë që lejon të jesh pa u kapur, të mbetesh këngë, jo thirrje për lavdi.

Paskajorja, gjithashtu, bëhet mekanizëm i kritikës: në *“Zbim paskajor”* dhe *“Qenësi paskajore”*, ajo shfaqet si strukturë ku figura të dhunës nuk përmenden për t’u gjykuar, por për të treguar se të gjitha janë pjesë e një cikli të vjetër që vazhdon. Gjykimi është i mënjanuar; në vend të tij, ofrohet një pasqyrë ku faji nuk është një emër, por një ritëm që përsëritet.

Në fund, *“Kreu paskajor”* përshkohet nga një vetëdije se mungon diçka thelbësore. Ligji, kujtesa, fjala e urtë - të gjitha kanë lënë një nyje të pazgjidhur. Nuk ka përmbyllje, por thirrje për një fjalë të ndërprerë. Paskajorja e këtij kreu nuk kërkon lavdi, por rikthim në një mënyrë të thjeshtë të të qenit: pa pikë, pa fund, gjithmonë në nisje.

Shtrati i Prokrustit: përthyerja e qenies në tesh e fjalës

Cikli *“Hekë paskajore”* i librit *Embsuame paskajore* ndërtohet si një terren ku fjala nuk shërben më si strehë, por si mjet përndjekjeje. Gjuha këtu nuk është formë e mendimit, por mënyra përmes së cilës përthyet vetë përvoja. Qysh në poezinë hyrëse, *“Zhdukja paskajore”*, fryma poetike nuk shfaqet si ngjizje, por si ndëshkim - një lindje që ndodh në mungesë të hapësirës së vet: *“asht si me fjetë e me u zgjue / në shtratin e Prokrustit.”* Forma është tashmë teh, e jo mbështjellje; është përkufizim që e copëton subjektin në vend që ta shprehë. Fjala nuk e përfaqëson, por e shtrëngon. Ajo është gjithmonë në mënyrë të tjetërsuar, e përdorur nga një tjetër, që shkruan trupin e subjektit sipas masës së vet.

Në këtë sfond, paskajorja e humb funksionin e saj lirues dhe bëhet dëshmi e ndarjes. Në *“Përvjedhja paskajore”*, subjekti vetëdijësohet për këtë: *“me u flijue dhimbshëm / ose me dekë / për kauzën e fjalëve t’moçme”*. Fjala e moçme, fjala e vërtetë, është tashmë vështirësisht e shqiptuar; ajo kërkon flijim për të ekzistuar. Poeti i njeh format e maskimit që merr dhuna e gjuhës - shfaqet e qetë, e urtë, e arsyeshme - por në thelb, ajo plagos, e asgjëson.



Në *“Përvojë paskajore”*, shfaqet figura e të gjallës që nuk mund të ecë dot drejt: *“me gjallnue pa paskajore / asht si me e ba rrugën me një kambë.”* Paskajorja nuk është më vetëm një modalitet foljor - është një organ i munguar. Njeriu që ecën pa të, këndon me gjysmë goje dhe rreh të frymojë me një mushkëri. Ky shtrembim nuk është defekt individual, por pasojë e një bote ku fjala është përdorur për t’u fshehur, jo për të shprehur: *“me e shtrembue edhe nofullën”*, si te poezia: *“Shtrembërim paskajor”*. Ky shtrembim i fjalës, si akt estetik i imponuar, fsheh dhimbjen reale, dhe kështu fjala e bukur bëhet krim i heshtur. Në *“Frymë paskajore”*, subjekti nuk del fitimtar nga përplasja, por del i pathyeshëm: *“e me e shijue kripën e lirisë.”* Liria këtu nuk është shpëtim, por plagë. Është ajo që djeg, por ruan. Fjala paskajore është si kripa: konservon atë që do të humbiste - një ndjeshmëri që nuk pranon të përmbillet në korniza.


“Luftë paskajore” është një poezi që deklaron një betejë të padukshme - një betejë pa britma, pa plagë të dukshme, pa armik të përcaktuar: *“pa e plagosë / pa e vra / e pa e lëfarë askend.”* Fjala nuk është më armë, por akt vetëpërmbytjeje. Ky është dimension i më radikal i rezistencës: të flasësh jo për të lënduar, por për të hapur një tjetër mënyrë të qenies. Fjala këtu është saktësisht ajo që nuk godet, sepse nuk është e prangosur në binarët e thënies së zakonshme.

Në *“Saga paskajore”*, ndjesia e ndërprerjes zhbëhet - jo me mbyllje, por me zgjatje: *“s’asht histori / e mbyllun / por asht sagë / paskajore.”* Kjo nuk është më kohë rrëfimi; është mënyrë për të mos u përmbyllur. Historia ka mbaruar, por saga rri pezull. Fjala vijon – jo sepse ka ç’të thotë, por sepse nuk ka ku të ndalet.

Ky cikël nuk i qaset poezisë si formë estetike, por si mekanizëm për të dëshmuar përçarjen midis përjetimit dhe shqiptimit. Paskajorja bëhet jo vetëm kategori e rrëfimit, por shenjë e një etike tjetër - ajo që nuk lejon mbyllje, as përfundim. Çdo varg është si një nerv i ekspozuar në një trup që ka humbur kufijtë, por jo ndjeshmërinë. Kjo poezi nuk përpigjet të bindë, as të sqarojë; ajo qëndron në buzë të asgjësë, aty ku fjala dridhet, por nuk thyhet.

Anatomia poetike e shoqërisë së rrënuar

Cikli i tretë i përmbledhjes poetike *Embsuame paskajore*, me titullin *“Lëngatë paskajore”*, ngrihet si një hartë poetike e agonisë kolektive - një krizë morale dhe shpirtërore që nuk sublimon, por zgjatet pa fund. Këtu, poezia nuk thërret për shpresë, por e përvijon



gjendjen e një shoqërie që ka harruar të jetë e gjallë.

Selmani përshkruan një realitet ku viktima shndërrohet në garant të dhunës dhe krimi kthehet në zakon. Figura ironike e *“me fytyrë engjëlli a fëmije”* - mishëron hipokrizinë kolektive, që ruan imazhin e pafajësisë ndërsa mban duart me gjak. Plisi, simbol i identitetit kombëtar, është i vetmi objekt që ruan funksion - jo si nder, por si dekor bosh: *“koka s’asht ma për me mendue”*.

Kjo është përmbysja e vetëdijes: krenaria vjen nga humbja, viktima glorifikohet, dhe lavdia është *“shkërbim i ferrit.”* Në këtë kontekst, *“Etje paskajore”* shfaq bindjen si mallkim: nevoja themelore për jetë (uji) përdoret për poshtërim, duke kujtuar figurën mitike të *Bindit - hyji ilir i ujërave*. Kjo është metafizika e një ekzistence që e refuzon veten.

Në *“Trekëndëshi paskajor”*, bashkimi nuk sjell shpresë, por rrënim. *“me krimba smirakë në bark”* përshkruajnë aleancën e zvetënuar që përpin gjithçka si një Bermuda e politikës dhe moralit shqiptar. Ndërsa te *“Mëkat paskajor”*, turpi zë vendin e lavdisë: *Kryezotin e Arbnisë* adhurohet me gojë, por mohohet në vepër - *“me u mburrunë se na vlon i njajti gjak / e mos me nxanunë kurrëgj”* - një kult i zbrazët që justifikon dështimin.

Kjo poeti nuk portretizon robërinë si dhunë të imponuar, por si dëshirë të brendshme: prangat nuk janë më instrumente shtypjeje, por shenja identitare. Subjekti nuk kërkon lirinë, por sigurinë që ofron robëria. Këtu, ligësia nuk vjen nga jashtë - ajo është intime, rritet me ne, bëhet mënyrë e të qenit. Djalli nuk është kërcënim, por bashkëjetesë e heshtur.

Në kulmin e ciklit, ironia thellohet. Poezia nuk ka fund, sepse nuk ka nisje: çdo çlirim është një tjetër teknikë disiplinimi. *“Liria”* është performancë, jo përvojë - një akt vetëmashtrimi të kolektivizuar.

Paskajorja, në këtë cikël, nuk është thjesht kohë foljore - është gjendje e shpërbërjes, vend i një subjekti pa trup, pa referencë, pa mundësi për të artikulluar vetveten. Dhe poezia nuk ofron shpëtim - vetëm një zë që kërkon të dëgjohet, edhe në pezull, edhe kur e di se askush nuk po dëgjon.

Ky është manifesti i një shoqërie të kapur nga zakoni i robërisë, që errësirën e ka bërë habitat të mendimit. Selmani ndërton një estetikë të dëshpërimit, ku fjala nuk shërben më për të ndërtuar, por për të çarë, për të treguar plagën që nuk mbyllet dot. Në këtë mënyrë, *“Lëngatë paskajore”* është jo vetëm cikli i rrënimit, por edhe vetëdija e tij e hidhur.

Gjurmët e paskajores: një poezi që nuk përfundon kurrë

Cikli poetik *Atdheu paskajor* shpaloset si një hartë semiotike ku shenja poetike nuk referon më realitete të qëndrueshme, por dëshmon për një mungesë strukturuese - një boshllëk që ndan fjalën nga objekti, subjektin nga vetja. Këtu, paskajorja largohet nga gramatika për t’u bërë gjendje e qenies: jo kohë, por një formë e pezull e ekzistencës ku fjala nuk zotëron kurrë kuptimin e plotë, ashtu si subjekti nuk është kurrë tërësisht vetvetja.

Toponimet - *Arbni, Jutbinë, Shkup, Shkodër, Çamëri* - nuk funksionojnë më si vendndodhje reale, por si fantazma të kujtesës kulturore. Ato artikulojnë një thirrje pa përgjigje, një rikthim të pamundur. Në vend të narrativës, poezitë krijojnë tension mes dëshirës për të thënë dhe pamundësisë për ta përmbushur thënien.

Në *“Arbnia paskajore”*, fjala gryen tokën me thonj, por nuk gjen rrënjë, veç *“eshtna me gojë të hapur”* - një zbrazëti që flet. Fjala nuk është më origjinë, por mbetje - zë që vjen nga një vend pa trup. Udhëtimi përmes Arbnive nuk është kërkim identiteti, por lëvizje pa drejtim, një endje në harresë. Poezia nuk rindërton atdheun, por shpërfaq pamundësinë për ta menduar atë si të përfunduar, si totalitet.

Figura e *“kryezotit”* në *“Mall paskajor”* nuk është qenie sovraane, por nevojë për praninë e një tjetri që mungon - një boshllëk që e strukturon dëshirën. Edhe malli për Çamërinë nuk është nostalgji, por thirrje ontologjike për diçka që nuk rikthehet kurrë, që mund të dëgjohet vetëm si mungesë. Rikthimi i Kostandinit nga varri nuk është ringjallje, por një çarje midis jetës dhe vdekjes.

Në *“Lavdi paskajore”* dhe *“Bamat paskajore”*, gjuha shfaqet si një detyrë etike, jo si rrëfim. Fjala nuk artikulohet nga arsyeja, por nga *“palca e ashtit”* - një fjalë e dhimbjes që kërkon mishërim përtej logjikës. Këtu, fjala nuk lavdëron atdheun si entitet të përfunduar, por si thirrje që nuk merr përgjigje të plotë.

Poezitë si *“Anatema paskajore”* apo *“Dhënia paskajore”* problematizojnë aktin e sakrificës: nuk ka dhuratë që prodhon pronësi, as flijim që themelon kuptim. Çdo akt simbolik zbulohet si performancë e dështuar. Atdheu nuk është vend, por fushë ku kuptimi shpërndahet, pa u stabilizuar kurrë.

Prandaj, çdo *lavdi, mall* apo *lutje* është një akt i pamjaftueshëm për të qenë i tëri, një *embsuame* që nuk përfundon. Poezia nuk ndërton një rrëfim për kombin, por dëshmon dështimin e një projekti për identitet. Paskajorja nuk është kohë, por një regjim i mungesës, ku historia, gjuha dhe subjekti treten në një figurë që flet pa thënë, që thërret pa archur - një poezi që mbetet gjithmonë në prag.

Topografi e dhimbjes paskajore

Cikli *“Dhimbje paskajore”*, krijon një hapësirë ku “paskajorja” nuk është vetëm një formë gjuhësore, por një gjendje ekzistenciale pa kufi kohor, një përjetim që nuk mbaron dhe nuk mbyllet. Poezitë funksionojnë si gjurmë të mbetura në një territor ku ngjarjet, emocionet dhe simbolikat nuk arrijnë të përfundojnë - ato rrinë pezull, të pambyllura, të pakornizuara.

(Vijon në faqen 13)

Tre Dinot e Prevezës

Janë tre momente, që më kanë njohur me jetën dhe thellësinë e botës artistike të Dinove: Ali Dinos, Arif Dinos dhe Abedin Dinos (i riu). I pari është një shkrim i Ferid Hudhrit, “Piktorë shqiptarë që kanë punuar jashtë Atdheut”, botuar në gazetën “Drita”, më 2 shtator 1979. Në këtë shkrim shumë kurajoz për kohën, ku Dinot ishin anatemuar nga regjimi, jepen të dhëna për tre vëllezërit Dino, jetën e veprën e tyre.

Tashmë Ferid Hudhri është një nga personalitetet e shquara të kulturës shqiptare, që me veprën e tij u ka bërë të njohur shqiptarëve e jo vetëm, trashëgiminë e tyre në fushën e arteve figurative e më gjerë.

Në vitin 2007, botohet libri i studiuesit dhe shkrimtarit Luan Rama “Dino, Shtegtari i Portës Sublime”, që është ribotuar më i plotë në vitin 2017. Ky është një nga librat nga më të mirët për tri A-të e Prevezës, këta kolosë ende të panjohur ose të njohur pak në Shqipëri.

Do të shtoja këtu edhe librin e Niko Stylos, studiues dhe shkrimtar, që është lindur dhe rritur në ato që quhen Çamofshatrat dhe që flet në dialektin e çamërishtes, “Preveziani Abedin Pashë Dino, poezitë e tij dhe Dinot e tjerë”. (Botimet “Pa kufij”, MÛLHEIM A.D.R. 2014). Nuk dua të lë pa përmendur edhe librin e Ahmet Mehmetit “Abedin Dino” (monografi), botim i “Onufrit”, 1998.



E kam të vështirë t’u qasem këtyre kolosëve, që u përkasin edhe kulturës shqiptare, edhe asaj turke, greke apo franceze. Ata me talentin e tyre, u bënë ura të mëdha, ku kulturat bashkojnë, veçmas në Ballkanin tonë. I tillë është edhe Ali Dino (1890-1938), që siç ka shkruar Papantoni, në nëntor të vitit 1938, në gazetën “Elefteria Vima”: “Ali Dino është një shqiptar, që dallohet nga aksenti i tij. Por përsa i përket të tjerave, ai është një artist internacional. Krijimet e tij e vendosin atë ndër karikaturistët më të mirë të Evropës” (cituar nga Luan Rama “Dino, Shtegtari i Portës Sublime”, f. 44).

Ekspozitat

Pra se të shkruaj për albumin “Ali Dino” (greqisht “AAH NTINO”), dua të jap disa të dhëna për ekspozitat e çelura në Prevezë dhe Athinë me karikaturat, vizatimet apo edhe skicat e pikturat e Ali Dinos. Sipas Niko Stylos, shumë prej karikaturave të tij u botuan pa marrë asnjë shpërblim, edhe te “Tribuna e Prevezës” të botuesit Nikita I. Çuçani. Ekspozita me dhjetëra karikatura me ngjyra dhe skica të tij, me temë nga jeta e Prevezës, ishte në atë kohë një ekspozim i përhershëm

ALBUMI I ALI DINOS DHE NJË PORTRET PËR MUSA DEMIN

Nga Enver Kushi



në uzerinë e Verikokaqit”.

Luan Rama shkruan se “Në vitet ’20-’30, Ali Dino bashkëpunoi me revistat e gazetave më në zë të Greqisë, së “Proia” apo “Satanas”, “Flit”, “Fanos of Editors”, si dhe ekspozoi në disa ekspozita kolektive në Athinë e Selanik. Një ekspozitë vetjake e hapi në “Parnassos Hall” dhe një tjetër në “Stratigopoulos Gallery” f. 44. Ali Dino ishte në të njëjtën kohë në shoqërinë e mjeshtërv të tjerë të karikaturës, si: Spahis, Kostanaqis, Sofo, Mavriolakis, Nuar Geivelis, Bezos, Nomikos, Fokos Dhimitriadhis, Koronojanaqis etj. Sipas shkrimtarit francez, Pol Nor, mik i afërt i Ali Dinos, cituar nga Luan Rama, “humori i tij e zbukuronte vizatimin, madje e bënte të kënaqshëm dhe atë çka nuk ishte ashtu. Kështu protagonistët e vizatimeve të tij shkonin t’i shikonin ekspozitat dhe ndalonin para figurave të tyre që paraqiteshin atje duke qëndruar me orë të tëra...”.

Në Athinë, në sallën e pallatit I. Mela, në bulevardin “Mbretëresha Sofia” nr. 4, prej

datës 1-14 prill 1978 Abedin Dino (i riu), i vëllai i Ali Dinos, që në ato vite jetonte dhe punonte në Paris, çeli një ekspozitë me punimet e tij. Në të njëjtën sallë, Safet Dino, vajza e vetme e Ali Dinos, ekspozoi karikaturat dhe skicat politike për politikanët e periudhës 1928-1936, që i kishte botuar ai në gazetën “Mëngjesi”, si bashkëpunëtor i rregullt i saj. Duket që kjo ekspozitë është çelur në Athinë, në 40-vjetorin e vdekjes së Ali Dinos, falë Safet Dinos, bija e vetme e Aliut dhe gruas së tij, këngëtares lirike të Athinës, Alba Dino (Monti), me origjinë nga Triestja.

Nuk do të ndalem në jetën e Ali Dinos, lindur dhe madhuar në Prevezë, nipi i Abedin Pashë Dinos dhe i biri i Rasih Dinos, shkollimin e tij në gjimnazin francez të Stambollit dhe më pas në Shkencat Politike të Universitetit të Sorbonës, zgjedhjen deputet në Parlamentin Grek, si përfaqësues i Çamërisë, vitet 1923-1925, vendosjen në Athinë, ku arriti të bëhet kryetar i Shoqatës “Bashkimi i Karikaturistëve”

të Greqisë dhe një nga drejtuesit e Shoqatës “Bashkimi i Arteve të Bukura”. Ali Dino është në krye të emrave, si themelues i “Lidhjes Shqiptaro-Greke” (Athinë 1926), me këshillin, që përbëhej nga emra të njohur si, P. Karapano, N. Karvuni, A. Konduli, S. Loverdho, A.A. Palli dhe A. Sulioti. Lexoni librin e Luan Ramës e të Niko Stylos dhe do të njiheni me Dinot e mëdhenj të Prevezës.

Albumi dhe portret i Musa Demit

Albumi “AAH NTINO” (Ali Dino) është botuar në vitin 1993, nën kujdesin e Kryetarit të Bashkisë të qytetit të Prevezës, Nikos Janulis dhe Bibliotekës Publike të qytetit. Në krye të ballinës është emri në greqisht dhe poshtë, në fund “ΔΗΜΟΣ ΠΙΠΕΒΕΖΑΣ”. Në faqen e brendshme: AAH NTINO ΜΠΕΗ - ΣΚΙΤΟΓΡΑΦΟΣ (1890-1938) dhe në fund emblema e qytetit. Albumi ka 140 faqe. Shtatëmbëdhjetë faqet e para përmbajnë në greqisht dhe anglisht shkrime nga Nikos Janulis, Safet Dino-Mavromati, e bija e Ali Dinos, martuar në Prevezë me avokatin Theodor Mavromati, parathënia e Kostas Mitropulos e më pas me shkrime të Aleks Lidorikis (1978), Selest Polikroniadi (1978), Jorgos Karacas (1978), Spiros Melas (1938), Pavlos Palaialogos (1978), Pol Nor, për t’u mbyllur me shkrimin më të gjatë të Zaharias Papantoni, marrë nga gazeta “Elefthero Vima”, 8.11.1938. Papantoni në këtë shkrim të gjatë shkruan: “Ali Dino, përshkruante në bisedat e tij zakonet tradicionale të rajonit të Çamërisë. Siç janë ato, që lidhen edhe sot mne ceremoninë e dasmës”. Mes të tjerash, Kryetari i Bashkisë së Prevezës vlerëson, zonjën Safet Dino-Mavromati “Falenderojmë ngrohtësisht për ofrimin e saj të mirë, për Bashkinë e Qytetit të veprave të babait të saj”.

Albumi përmban rreth 60 portrete, 35 karikatura, një cikël me kostume shqiptare. Siç shkruan Luan Rama, seria e skicave të tij nga Çamëria ishte jo vetëm me humor, por edhe me satirë sociale. Megjithëse ishte bej në origjinë, nuk nguronte të satirizonte edhe bejlerët e Çamërisë. Ali Dino tregoi në skicat e tij jetën e përditshme të shqiptarëve dhe të ballkanasve në përgjithësi dhe jetën social-politike greke. Është i njohur cikli i tij “Nostalgia of Arvanitis”, me një galeri të pafund personazhesh, që mbajnë gjurmët, koloritin dhe atmosferën e kohës... Ali Dino i vizatoi me dashuri vallet greke e shqiptare, vallet “çamiko” (cituar nga Luan Rama, f. 45-46).

Vend të veçantë zënë në këtë album portretet, ku dallohen ato të politikanëve grekë dhe artistëve të kohës në Athinë. Do



Nostalgia of Arvanitis



Musa Demi



Alba Dino (Bashkëshortja)



të veçoja portretet e familjarëve të tij: kemi 2 portrete të gruas Alba Dino (1926, 1927), të nënës Safet Dino (1937), të vëllait Arif Dino, të babait Rasih Dino, trajtuar me një sens të hollë humori, të Hysen Pashë Dinos.

I veçantë është portreti i Musa Demit. Nuk është shkruar data, por vetëm emri i Musa Demit, ndryshe nga shumë të tjerë, ku krahas emrit, është edhe data se kur është realizuar portreti. Mendoj se nuk është e rastit që Ali Dino ka skicuar portretin e Musa Demit, një prej figurave të shquara të Çamërisë e jo vetëm. Po të lexoni monografinë e studiuesit të mirënjohur e të palodhur çam, Hajredin Isufi, do të bindeni se përse Dino e ka pikturuar me mjeshtëri dhe dashuri e respekt Musa Demin.

Në skicën portret të Ali Dinos spikat menjëherë vështrimi i zgjuar dhe i matur i Musa Demit. Sytë e tij, disi të menduar, vështrojnë larg, shumë larg. Ai ka pozuar në Athinë, ndoshta pas takimeve të tij me politikanë grekë për gjendjen në Çamëri dhe të ardhmen e saj. Çfarë vështrojnë sytë e Musa Demit, të pikturuara nga Dino? Çfarë kanë biseduar ata para se ai të pozonte para patriotit të tij të talentuar, por edhe me vizion për të ardhmen e Çamërisë dhe përpjekjet për ta parë këtë krahinë shqiptare, edhe si urë bashkëpunimi e miqësie mes çamëve e grekëve? Ali Dino jetonte e punonte në Athinë. Ai kishte shumë miq nga elita intelektuale dhe krijuese greke. Me të drejtë, miku i tij, Pavlos Palaiologos, shkruan: “Pyesja veten se cila ishte ajo gjë e fuqishme dhe tërheqëse që ushtronte ky mysliman në Prevezë dhe që

me sharmin e vet personal, kishte ditur të bënte për vete Athinën, si dhe Greqinë, duke u kthyer në një personazh social. Dhe e gjithë kjo ndodhte se ai ishte një artist karikaturist me një stil tejet original...”

Edhe Musa Demi ishte një mendje e hapur. Në Filat e kudo, ai kishte miq të shumtë nga çamë të krishterë, grekë, vllleh. Dera e shtëpisë së tij ishte vazhdimisht e hapur. Ai ishte mbrojtës i flaktë i Çamërisë, i të drejtave të popullsisë çame ndaj veprimeve të disa “kokëndezurve”, siç do t'i quante Teodoros Pangalos veprimet e nacionalistëve ekstremistë grekë, por edhe me vizion për të ardhmen e saj. Portreti i Ali Dinos për Musa Demin flet shumë dhe është nga më të arrirët në krijimtarinë e Dinos, si mjeshtër edhe i portretit.

Me botimin e këtij albumi, Preveza, qyteti i lindjes së Ali Dinos, ka nderuar emrin dhe veprën e këtij intelektual, piktori dhe preveziani të madh, i dashuruar me aromat e detit Jon, erërat e veçanta të tij, si dhe me banorët e këtij qyteti të jashtëzakonshëm, ku çamë myslimanë e të krishterë, grekë e vllleh nuk i ka ndarë as xhamia e as kisha. Ai ishte nipi i atit të madh, Abedin Pashë Dinos, ku në një shkrim të botuar në “Kronika të Dodekanezit”, thuhet: “Lexonte sa Volterin, po aq edhe Xhelaledin Rumiun, sa Biblën, po aq edhe Kuratin, poetët klasikë, “Divanin”, po aq edhe filozofët grekë”.

Tiranë, gusht 2025.



Ali Dino

(Vijon nga faqja 11)

Në “Embsuame paskajore”, bërja e gabimeve të mëdha shndërrohet në një mal mbi të cilin ecim me plagë, “ndaj jeta jonë s’ka me u ndreqë ndryshe /s’ka me gjetë paqe as midis tokës e qiellit”, derisa të arrijmë momentin e emërtimit të drejtë, një gjest çlirues, por edhe të vonuar. “Shiu paskajor” na e jep pamundësinë e larjes së dhembjes, ku ujërat nuk e çojnë kurrë dhimbjen në lumin e harresës. “Pikëllim paskajor” e vendos të qenit “gjysmë” si një boshllëk që nuk mbushet, sidomos kur gjysma tjetër kthehet në armik.

Shumë poezi e ndërtojnë tensionin midis aktit të mundshëm dhe pamundësisë për ta çuar në fund: “Ikje paskajore” ikja nuk çon askund përveç në vajtim; “Drojë paskajore” dëshira ndalet në mungesën e mjeteve, duke u kthyer në një krimb të brendshëm që gërryen ngadalë; “Hamletiadë paskajore” e vendos ekzistencën në një pyetje pa përgjigje, ku as pyetja vetë nuk dëgjohet më. “Me folë a mos me folë /kur heshtja të gërryen me gjemba.”

Simbolet mitike si Rozafa dhe Doruntina nuk paraqiten për ta përforcuar të njohurën, por për ta çliruar nga fundi i paracaktuar: Rozafa nuk e ka dënimin e fundit te murosja, “e mos me pyetë nëse je gjallë a dekun/ /mos me besue kurrë /se murosja asht dënimi i fundit.” Doruntina nuk pret Kostandinin, por beson te vetja. Këto rishkrime të miteve i shpëtojnë mbylljes së tyre tradicionale, duke i futur në rrjedhën e hapur të paskajores.

Në fund, ky cikël është një hartë e territoreve të paqëndrueshme të qenies - dhimbje, ikje, drojë, dënime, mundësi, andrra - të gjitha të zgjatura pa fund, jashtë vijës së fundit, në një kohë që nuk është as e shkuar, as e ardhme, por një e tashme e papërfunduar.

Poezia si përpjekje për ta kapërcyer vdekjen

Në poezitë “Kangë paskajore”, “Ringjallje paskajore” apo “Lojë paskajore” të ciklit “Udhë paskajore”, fjala poetike merr formën e një akti ritual, që këndon, vallëzon e qesh - jo për të harruar, por për të shpëtuar vetveten nga fshirja. Kjo nuk është një estetikë e shpresës së lehtë, por një këmbëngulje e qenësishme për ta mbajtur subjektin në lëvizje, për ta penguar të tretet në harresë. Poezia mishërohet në trup: bëhet “kangë prej mishi e gjaku / që i kalon kufijtë e vetes...”, një formë e qëndresës që nuk shpreson, por vepron.

Ky subjekt është një “si zog i vetmuem n’kohë murtaje me qeshë”, që nuk i përgjigjet rrënimit me rezignatë, por me këngë - me një zë që vjen nga thellësia e mungesës. Pikërisht aty qëndron forca e kësaj poezie: ajo nuk premtton shërim, por e bën dhimbjen të jetueshme, barrën të përballueshme, terrin të kalueshëm, edhe kur drita mbetet e dyshimtë.

Në “Domethanie paskajore”, kufijtë e logjikës së qenies thyhen për t’i dhënë vend një përmblytjeje të përvojës: robëria bëhet një gjendje e lirisë, dhe liria - një formë e mprehtë e robërimit. “me kjenë i lirë / e me u ndi përherë i robnuem...” Poezia nuk e fsheh këtë paradoks, por e bën atë terrenin e saj të brendshëm. Fjalët këtu nuk zgjidhin ankthin, por e artikulojnë për ta bërë të bartshëm. Në këtë mënyrë, shkrimi bëhet një zbulesë që ndodh përtej kuptimit, një heshtje që flet përmes dritëhijëve të gjuhës.

Poezitë “Ringjallja paskajore”, “Hini paskajor”, “Lugatnim paskajor” dhe në veçanti “Ngritja paskajore” përçojnë idenë e një qenësie ciklike, ku vdekja nuk është fund, por kthesë. Nuk kemi rënie përfundimtare, por një lëvizje që gjithnjë kërkon rimëkëmbjen: “me më rr’zue një herë / unë ngrihem shtatë herë / e masandej s’di ma kurrë me ra...” Ky subjekt nuk aspiron për heroizëm, as për shenjtëri. Ai kërkon të ekzistojë me çdo kusht - si hi, si dritë, si hije - në një ngulmim që më shumë se forcë, është qëndresë pa shpërblim.

Në “Liri paskajore”, shfaqet një tjetër trajtë e thellë e kësaj poezie: liria si frenim, jo si çlirim. “por kënaqësia ime asht’ / mos me e ba atë që mundem...” - një thirrje që e rikthen etikën te përbrendësia. Këtu, liria nuk është dëshirë e shfrenuar, por akt i vetëpërmbajtjes, një disiplinim i egos që refuzon të bëhet ujk për tjetrin. Jo si imponim moral, por si gjest i qenies që vetë e kufizon veten për të mos shkatërruar vetveten dhe të tjerët.

Dashuria si fuqi përtej vdekjes

Në ciklin e fundit, dashuria nuk është më ndjenjë e zakonshme, por një fuqi që i tejkalon kufijtë e trupit dhe të kohës - një akt ontologjik që lidhet më shumë me shpresën për mbijetesë sesa me përmbushjen sentimentale. Te “Dashni paskajore”, ajo arrin një pikë ekstreme vetëflijimi: “me dashhtë / sa me dekë veç prej dashnie / paskajore.” Ky akt dashurie nuk është thjesht shpërthim emocional, por përpjekje për të ekzistuar përmes një tjetri që na ruan nga zhdukja. Dashuria shndërrohet në një marrëveshje të pashkruar për mos me u shuar, për me qenë ende i pranishëm nëpërmes një tjetërsimi të ëmbël

Tek “Ora paskajore”, dashuria merr formën e një procesi të pafund ritmik - “me e pritë”, “me ardhë”, “me t’dashhtë” - që nuk përmbillet kurrë, por ushqehet nga vetë vazhdimësia e saj. Në këtë hapësirë, pritja nuk është mungesë, por akt i plotë.

Në “Jetëvdekje paskajore” dhe “Dashni paskajore”, kufiri mes kundërshtive shpërbëhet: jeta dhe vdekja, dhimbja dhe gëzimi, nuk qëndrojnë të ndara, por ndërthuren në një qarkullim të pandërprerë. Këtu, kuptimi nuk gjendet në stabilitet, por në lëvizjen e vazhdueshme midis ekstremeve.

“Rozafa paskajore” e zhvendos mitin nga përjetësia e gurit drejt një sfide të vetëbesimit, ndërsa “Betim paskajor” e “Tanusha paskajore” artikulojnë dashurinë si gjest të pamundur praktikisht, por të domosdoshëm poetikisht.

“Mallkim paskajor” dhe “Kërkim paskajor” e projektojnë dashurinë si një forcë që shkon përtej jetës dhe fatit, një kërkim që nuk ndalet as në andërr, as në zhgjëndërr. Cikli e ndërton kështu dashurinë si një fushë tensioni ku çdo akt është i pezulluar në një paskajore të përhershme - një kohë që nuk rrjedh drejt një fundi, por hapet pafund drejt mundësisë së saj të ardhshme.

Në thelb, kjo nuk është dashuri që ndodh njëherë e përfundon, por një dashuri që nuk përfundon kurrë - gjithmonë duke ndodhur, gjithmonë në kërkim, gjithmonë paskajore.

Përfundim

Ky libër nuk lëshon një thirrje, por lë një gjurmë të saj - një dridhje që nuk dëgjohet me vesh, por që përshkon trupin e leximit. Fjala është vendosur në kufijtë e zërit, në pragun e padukshëm mes thënies dhe të pathënës. Nuk kemi të bëjmë me një autor që “shkruan poezi”, por me një vetëshkëputje të subjektit nga vetvetja në aktin e shkrimit. Subjekti nuk është burimi i kuptimit, por një lëvizje e vazhdueshme drejt shpërbërjes së tij nëpërmes tekstit.

Ashtu siç do të parashikonte Barti, autori është vrarë për t’i hapur vend një shumësie leximesh që sfidojnë çdo qëllim apo autoritet fillestar. Teksti nuk rrëfen, por ndodh; nuk dëshmon, por rrëshqet; nuk përmbyll, por shtyn.

Në zemër të kësaj poezie qëndron humbja - jo si ngjarje, por si themel ontologjik. Identiteti nuk paraqitet si një formë e mbyllur, por si një proces i përhershëm në ndërprerje, i ndërtuar mbi mungesën që e bën të mundur. Lexuesi nuk përballlet me një zë të caktuar, por me jehonën e tij, që lëviz nëpër vargje dhe merr herë trajtën e një “ti”-je të zhvendosur - grua, atdhe, fjalë e pashkruar - herë thjesht heshtjen që i paraprin çdo artikulum.

Leximi, prandaj, nuk është një akt kalimi linear, por një proces rikthimi, një përthyerje e vazhdueshme që na detyron të shohim atë që është lënë jashtë tekstit - boshllëqet, lapsuset, gjurmët.

Dhe në fund, ky libër nuk jep përgjigje - sepse nuk synon t’i japë. Ai na përfshin në një proces të pafund të bashkëjetesës me mungesën. Lexuesi bëhet bashkautor përmes asaj që nuk thuhet, që zhduket, që gabon - pikërisht përmes asaj që Barti do ta quante “e pashënueshmja” e leximit.

Ky nuk është një libër për t’u kuptuar. Është një tekst që dëgjohet me trup. Fjala këtu nuk përfaqëson, por rrëshqet - dhe pikërisht në këtë rrëshqitje, ajo bëhet më e vërtetë se çdo e vërtetë.

*

Shtëpia e vjetër ndodhej në një lagje rezidenciale, goxha larg nga stacioni. Meqenëse ishte në anën e pasme të një parku të madh, e përshkonte aroma e fortë e gjelbërimit. Veçanërisht pas shiut, ajri bëhej aq i dendur, sa dukej sikur rrugët që rrethonin shtëpitë ishin shndërruar në një pyll, që thujse ta merrte frymën. Jetova edhe unë për pak kohë në atë shtëpi ku tezja ime kishte jetuar e vetme. Tani që e mendoj, ajo pak kohë që kalova atje, për mua është shndërruar në një periudhë të veçantë e të çmuar. Kur e sjell ndërmend, më përshkon një ndjenjë e çuditshme. Ashtu si një përfytyrim që shfaqet papritur, duket sikur ato ditë e humbasin kuptimin e realitetit.

I kujtoj me nostalgji zemërthyesë orët e qashtra me tezen, vetëm ajo dhe unë. Mendoj se kam qenë me fat të ndaja me të hapësirën që ishte krijuar mes plasave të kohës, falë disa rrethanave krejt të rastësishme.

Më kujtohet saktësisht gjithçka. Porta e vjetër prej druri kishte një dorezë të artë, tashmë të zbehur nga koha. Barërat e këqija të kopshtit, të lëna prej kohësh pas dore, ishin rritur dhe dendur aq shumë e së bashku me pemët tashmë thujse të thara, sikur e mbulonin qiellin. Dredhka kacavirrej nëpër muret e errëta, ndërsa në njërin nga dritaret me xham të thyer, ishte mbërthyer mirë me ngjitës. Dyshemeja ishte gjithnjë e mbuluar me pluhur i cili, në kohë të kthjellët, kur i binte dielli, ngrihej duke kërcyer për t'u kthyer më pas përsëri dhe për të mbuluar qetë-qetë dyshemën. Gjithçka ishte hedhur pa kujdes, ndërsa llambat e djegura nuk ndërroheshin më. Ngjante si një botë jashtë kohe. Deri në atë çast që shkova ta vizitoja, tezja kishte jetuar në heshtje e në hije, ashtu si e përgjumur.

Ajo jepte mësimë muzike në një lice privat. Ishte gati tridhjetë vjeçe, por nuk ishte e martuar; kushedi sa vite kishte që jetonte e vetme. Ishte "mësuesja klasike e muzikës, beqare dhe serioze". Veçanërisht në mëngjes, kur shkonte në punë, ajo ishte pikërisht mishërimi i këtij përkufizimi. Gjithnjë me kostumin ngjyrë gri si të miut, pa grim, me flokët e lidhura me llastik të zi, me këpucët me takë të mesme, ecte me ritëm të rregullt nëpër rrugët e mbuluara nga mjegulla e mëngjesit. Ngjante me ato gratë që ndodh t'i takosh shpesh, me fytyrë aq të bukur, por krejt jashtë mode. I vetmi shpjegim që kisha ishte se tezja, duke u tallur me botën, kishte krijuar një imazh të saj, sikur donte të thoshte: a nuk dukem si një mësuese muzike e përkryer? Dua të them se, kur rrinte në shtëpi, shndërrohej në një njeri tjetër, duke e zbuluar tërë bukurinë e saj të përkorë.

Stili i saj i jetesës ishte mishërimi i ekstravagancës. Sapo hynte në shtëpi, vishte menjëherë pizhamet ose këmbishën e natës dhe rrinte këmbëzbathur. Dhe nëse kishte mundësi, kalonte ditë të tëra duke prerë thonjtë dhe majat e flokëve. Ajo ishte e aftë të vështronte nga dritarja me orë të tëra e zhytur në mendime dhe ta zinte gjumi në korridor. Librat që lexonte

BANANA YOSHIMOTO

Parandjenjë e trishtë

Fragment nga romani, përkthyer nga Ledia Dushi

Foto nga Fumiya Sawa



rrinin hapur, ndërsa rrobat që lante preheshin pafundësisht në makinën tharëse. Hante kur donte vetë dhe flinte kur i flihej. Përveç dhomës dhe kuzhinës, sigurisht kishte vite që nuk pastronte. Kur shkova tek ajo, në mënyrë që të kisha një dhomë ku të flija, m'u desh të pastroja gjithë mbrëmjen, deri sa nuk munda të qëndroja më në këmbë. Edhe në atë rast, pa shfaqur as më të voglin shqetësim, më tha: "Të ftuarit janë të ftuar". E kështu edhe pse ishte bërë tashmë natë, ajo u dha me mish e shpirt për orë të tëra të më përgatiste një tortë të madhe. Gjithçka ndodhte në rrethana të çuditshme. Kur mbarova së pastruari dhe u ulëm të hanim tortën, kishte ardhur agimi dhe qielli kishte nisur të kthjellohej. Gjithçka pra ndodhte kështu, pa rregullin më të vogël. E megjithatë, në lidhje me bukurinë e saj, të gjitha këto gjëra ishin çuditërisht të veshura me hijeshi. Pa asnjë dyshim, tezja kishte tipare të bukura. Sigurisht që ka gra më të bukura se ajo. Ajo që më dukej e bukur ishte mbi të gjitha mënyra e të jetuarit, veprimet, gjendja e veçantë që çlirohej edhe nga ndryshimet më të vogla të shprehjes që shoqëronin gjestet e saj. Mua më dukej se e gjithë bota e saj kishte një qëndrueshmëri

kokëfortë, dhe që asgjë nuk do të mund ta shqetësonte deri në fund të jetës. Pikërisht për këtë arsye, çfarëdo që të bënte, tezja më dukej jashtëzakonisht e bukur. Drita që lëshonte, e zbrazët por e shndritshme, e mbushte gjithë hapësirën përreth. Me mënyrën se si i fërkonte sytë e përgjumur dhe qerpikët e gjatë e të përkulur, ajo më dukej verbuese si një engjëll dhe kyçet e saj të hollë të shtrirë në dysheme, ishin aq harmonike, sa dukeshin si të skalitura. Kisha ndjesinë se edhe ajo shtëpi e vjetër dhe e pluhurosur, po zgjerohej e tkurrej butësisht në të njëjtin ritëm me lëvizjet e saj.

*

Atë mbrëmje u përpoqa disa herë ta thërrisja, por ajo nuk përgjigjej. Nën shiun e zhurmshtëm, u nisa drejt shtëpisë së saj me njëfarë ankthi. Në errësirë, një mjegull si tym ngrihej që nga gjelbërimi dhe ajri mbyttës i natës mbante një aromë të trishtuar dhe të freskët. Po ecja e përqendruar duke u lëkundur nën peshën e çantës së madhe që mbaja mbi sup. Ishte një natë shumë e errët.

Sa herë kisha nevojë të mendohesha,

ikja nga shtëpia. Pa i treguar prindërve se ku po shkoja, nisesha për ndonjë udhëtim të shkurtër dhe bujtesha me radhë te secili prej miqve që kisha. Kështu sqaroja idetë dhe isha e aftë të kuptoja shumë gjëra. Në fillim prindërit e mi zemëroheshin, por kur fillova liceun, më në fund u dorëzuan dhe nuk më qortonin më. Pra, fakti që largohesha ashtu në mënyrë të papritur pa asnjë shpjegim, ishte diçka e shpeshtë. Vetëm ideja se isha drejtuar për tek shtëpia e tezes, ishte disi i çuditshme.

Nuk kishim ndonjë marrëdhënie të afërt, përkundrazi, përveç disa takimeve familjare, e kisha parë në raste shumë të rralla. Por kushedi përse ajo teze e çuditshme më pëlqente shumë. Pastaj, me të kisha një kujtim të përbashkët.

*

Në atë kohë isha ende një vogëlushe në shkollën fillore. Mëngjesin e varrimit të gjyshit tim nga nëna, qielli ishte i shndritshëm, plot me re, dhe dukej sikur do të niste të binte borë nga çasti në çast. Më kujtohet shumë mirë. Që nga futoni vështroja qiellin e vrenjtur përtej shojit. Pranë dritares qëndronte i varur fustani i zisë që duhet të vishja atë ditë. Ndonjëherë nga korridori dëgjoja zërin e mamasë e cila telefononte pandërprerë, ashtu e mbytur në lot. Isha ende e vogël dhe nuk e dija mirë se çfarë ishte vdekja, por isha e trishtuar sepse e kuptoja që mamaja po vuante. Por mes telefonatave mbaj mend njërin prej tyre, shumë të çuditshme, kur mamaja thirri: "Çfarë? Prit pak... si mundesh...", pastaj e mbylli. Pasi heshti për pak, e dëgjova tek murmuriste: "Ah, kjo Jukino..." Unë, që e kuptova menjëherë, mendova: *me siguri tezja nuk do të vijë në varrim.*

Një natë më parë e kisha takuar gjatë vigjilimit. Në fakt kishte diçka që e bënte të binte ndesh me mjedisin. Ndër vëllezërit dhe motrat e mamasë, tezja, e cila ishte më e reja, e vetmja që nuk fliste, qëndroi gjatë tërë kohës në këmbë. Por vetëm ajo ngjante aq e bukur. Me gjasë ai ishte fustani i saj i vetëm për raste vdekjesh. Ishte hera e parë që e shihja të veshur në mënyrë formale. Madje edhe kur ime më ia hoqi etiketën e lavanderisë që i kishte mbetur ngjitur pas fustanit, nuk u vu në siklet e as nuk u shfajësua me ndonjë buzëqeshje. Përkundrazi, përkuli lehtë kokën me një gjest të ngadaltë e plot trishtim. Ndërsa qëndroja në këmbë së bashku me familjen time, duke vështruar radhën e gjatë të njerëzve që vinin për ngushëllim, nuk arrija t'ia shqisja sytë. Kishte sy të lodhur, buzët të zbehta dhe në atë kontrast bardh e zi, dukej e zbehtë si fantazmë. Përgjigjeja ndodhej një tryezë ku njerëzit linin përshtypjet e tyre, vendosur pranë një stufe që lëshonte një tym të ngrohtë nëpër errësirë. Faqet e tezes, të ndezura nga flakët kërcitëse, shkëlqenin nga një skuqe e gjallë. Atë natë kur të gjithë, të kapluar nga një shqetësim i zymtë, shkëmbenin përshëndetje dhe shtrëngonin shamitë te sytë, vetëm tezja ime vazhdonte të ishte krejtësisht e

qetë, sikur të ishte bërë pjesë e errësirës. Me vargun e perlave në qafë dhe duart të zhveshura, vetëm bebëzat dukej se i shkëlqenin duke reflektuar shkëlqimin e zjarrit.

Ajo padyshim që po përpiket shumë që të mos qajë, mendova. Duke qenë se shqetësimi kryesor i gjyshit ishte që ajo jetonte e vetme, ai i kishte kushtuar gjithmonë vëmendje të veçantë. Shtëpia e gjyshërve ishte në të njëjtën lagje me shtëpinë e saj dhe ndoshta shkonte shpesh për t'i vizituar. Edhe pse isha ende e vogël dhe nuk kuptoja shumë, duke vëzhguar tezen time që ashtu e ngurtësuar në këmbë vështronte natën, trishtimi i saj i thellë arrinte deri te unë. Po, tezen time e kuptoja në mënyrë të veçantë. Edhe pse ishte një person që fliste shumë pak, nga një gjest i saj, qoftë edhe i vogël, nga një shikim apo nga mënyra se si përkulte kokën, disi mund ta merrja me mend nëse ishte e lumtur, nëse ishte e mërzitur apo e inatosur. Kur nëna ose të afërmit diskutonin mes tyre, me një përzjerje dashurie dhe dorëzimi se, “është e pamundur të kesh një ide se çfarë po mendon”, mua, me mendjen e fëmijës, më dukeshin të pakuptimta: përse nuk e kupton askush? Pse jam e vetmja që e kuptoj kaq mirë?

Dhe teksa mendoja për këto gjëra, tezja befaz filloi të qante. Në fillim lotët filluan t'i binin pikë-pikë, i rrëshqisnin faqeve ashtu të tejdukshëm, pastaj u kthyen në ngashërime dhe në fund, në një vaj të dëshpëruar. Vetëm unë e vura re atë ndryshim. Njerëzit e tjerë përreth, të zënë në befasi, e morën dhe e futën brenda. Por asnjëri prej tyre nuk e kishte vëzhguar me kujdes. Thjesht dukeshin të çuditur. Unë isha e vetmja që e kisha vëzhguar gjatë tërë kohës. U ndjeva çuditërisht krenare për këtë gjë.

Mora vesh se atë ditë në telefon kishte thënë: “Nuk po vij në varrim. Do nisem për një udhëtim”, pastaj kishte mbyllur telefonin. Nëna ishte përpjekur ta telefononte shumë herë, por ajo nuk ishte përgjigjur. Varrimi u bë pa tezen, madje edhe pasi u ktheva, kur nëna u përpoq ta telefononte përsëri, nuk i ishte përgjigjur askush. Kaluan disa ditë pa folur dhe më në fund nëna hoqi dorë duke thënë disi e trishtuar se: “Ajo duhet të ketë shkuar diku larg. Do të përpiqem ta telefonoj përsëri pas disa ditësh”.

Të nesërmen e varrimit, e bindur se tezja ishte aty, u nisa për te shtëpia e saj. Edhe pse nuk i kisha mbushur ende dhjetë vjeç, tashmë isha një fëmijë me karakter të fortë. Sa herë që nëna dëgjonte tingullin që përhapej ndërsa formonte numrin, psherëtinte dhe e mbyllte telefonin, thoja me vete: Jam e sigurt që është aty, por nuk përgjigjet. Por gjithsesi doja të sigurohesha për këtë gjë.

Me çantën në shpinë, mora metronë dhe u nisa. Ishte një pasdite shumë e ftohtë me borë të imët. Zemra po më rrihte fort, por kisha vendosur të shkoja. Kur u gjenda përpara shtëpisë, e cila ngrihej e zezë nëpër errësirën e lehtë, më kaploi dyshimi se mos vërtet ishte larguar, prandaj i rashë ziles me njëfarë shqetësimi.

E përsërita aq shumë të njëjtin veprim, si të ishte një lutje. Më në fund, nga brenda u dëgjuan ca zhurma dhe e

kuptova që tezja ishte pas dere dhe po përpiquej të mos fliste.

“Jam Jajoi”, - i thashë.

Dera u hap me një të shtyrë dhe tezja, e cila dukej aq e tretur, më vështroi me mosbesim. Duhet të kishte qarë shumë në atë shtëpi të errët, ngaqë i kishte sytë të skuqur e të fryrë.

“Çfarë ka ndodhur”, - më pyeti.

“Isha e sigurt se do të të gjeja këtu”, - i thashë me drojë.

Nuk munda t'i thoja asgjë tjetër.

“Hyr, por nuk duhet t'i thuash asgjë nënës”, - tha tezja duke buzëqeshur paksa.

Kishte veshur një palë pizhame të bardha. Ishte hera e parë që e takoja vetëm dhe ajo shtëpi në atë gjendje të rrëmuishme më dukej e vetmuar dhe e ftohtë.

Tezja më drejtoi për nga dhoma e saj në katin e sipërm, me gjasë e vetmja që kishte një stufë të ndezur. Aty ndodhej edhe një pianoforte e zezë. Më bëri vend duke i shtyrë sendet me këmbë; mori një jastëk dhe e vendosi në tokë.

“Ulu këtu, po të sjell diçka për të pirë”, - më tha, ndërsa zbriti poshtë.

Përjashta, bora u shndërrua në breshër e ndërkohë dëgjohej zhurma e tophave të vegjël të akullit ndërsa godisnin pa pushim xhamat. U çudita se si, në zonën ku jetonte tezja, mbrëmja binte aq e errët dhe vinte shumë shpejt. Unë as që mund ta merrja me mend se si mund të jetoje e vetme në një vend të tillë; ndihesha në siklet. Në të vërtetë

doja të kthehesha në shtëpi sa më shpejt që të ishte e mundur.

Por pikërisht në atë çast, tezja u kthye dhe më pyeti: “Jajoi, a dëshiron një *Calpis*?” Qepallat e saj të fryra ishin për të ardhur keq, aq sa munda veçse të thoja “po” me kokë dhe mora filxhanin me *Calpis* të ngrohtë. Duke mos patur asnjë vend tjetër, u ul mbi krevat dhe, ndërsa më buzëqeshi për herë të parë, më tha: “Mora disa ditë pushim nga shkolla dhe kam qenë tërë kohës në gjumë”. Më në fund u ndjeva e lehtësuar. Nuk e kisha idenë aspak se përse tezja, në vend që të rrinte te gjyshërit, jetonte e vetme në atë karakatinë.

Mendoja se me vdekjen e gjyshit ajo kishte mbetur krejt e vetme. Prandaj, meqë po më trajtonte si një e rritur, kisha dëshirë t'i thoja diçka.

“Nëna tha që ishe nisur për udhëtim, apo jo?”

“Po”.

“Askush nuk e di që ndodhem këtu.

Nuk kam dëshirë të shoh asnjë nga të rriturit. Është vërtet e mundimshme. E kupton, besoj”.

“Po”.

Në atë kohë tezja ndiqte konservatorin. Nëpër rafte ishin rreshtuar partitura të shumta, ndërsa në lexhio ndodhej një partiturë e hapur.

Përmbi tryezën e ndriçuar nga një llambë, ndodhej një grumbull letrash të vendosura në mënyrë të çrregullt.

“A po ushtroheshe në piano?” - e pyeta.

“Jo”, - u përgjigj tezja duke buzëqeshur, ndërsa e hodhi vështrimin nga lexhioja. - “Jo jo, ajo partiturë gjendet aty e hapur prej kohësh. A nuk e sheh që është mbuluar nga pluhuri?”

Më pas u ngrit dhe shkoi drejt pianofortes. E fshiu pluhurin me dorë, ngriti kapakun dhe u ul.

“A do të luash diçka?”

Në buzëmbremje dhoma ishte e heshtur si vetë përjetësia. Tezja pohoi me kokë dhe pa ia hedhur sytë partiturës, nisi të luante një melodi krejt të qetë. Në piano e mbante shpinën aq drejt dhe profili i saj ndiqte me shumë kujdes lëvizjet e gishtave. Ndërkohë muzika shkrihej në mënyrë të jashtëzakonshme me zhurmën e erës dhe goditjet e breshrit. Më dukej sikur gjendesha në një vend të panjohur e të çuditshëm. Në atë çast po jetoja në një ëndërr. Për njëfarë kohe e harrova krejtësisht vdekjen e gjyshit, dhimbjen dhe gjithçka tjetër. Më kishte përpirë të gjithën ajo hapësirë e mistershme.

Kur mbaroi së luajturi pjesën, tezja psherëtiu dhe tha: “Kisha kohë që nuk luaja në piano”.

Më pas e mbylli përsëri pianon dhe më pyeti duke buzëqeshur: “A ke uri? A do që të porositim diçka?”

Shkunda kokën në shenjë mohimi dhe u përgjigja:

“Meqenëse kam ardhur fshehurazi, tani duhet të kthehem”.

“Po, ke të drejtë”, - tha tezja.

“A e di rrugën për te stacioni? Jam në pizhama e nuk mund të të shoqëroj”.

U ngrita. Ajo doli në korridor dhe ndërsa zbrisja shkallët bënte një i ftohtë aq i madh sa ndjeva ngricën të më futej deri në asht.

“Mirupafshim”, - i thashë, ndërkohë që po vishja këpucët.

E gjeta në shtëpi ashtu siç e kisha imagjinuar, por me t'u gjendur përpara saj, me gjithë ato që doja t'i thoja, nuk arrita as te hapja gojën dhe kjo gjë më dukej tmerrësisht e trishtë. Por në atë moment nuk mund të bëja më shumë se kaq. Sapo kisha dalë nga porta kur tezja më thirri përsëri.

“Jajoi!”

Ajo kishte një zë të qetë dhe dridhmues. Ndërsa e vështrova mendoja, nëse do të kthehej në atë dhomë të errët dhe do të qëndronte tërë natën zgjuar... Kisha përshtypjen se vizita ime do ta bënte të ndjehej edhe më e vetmuar. Me llambën e hyrjes pas shpine, tezja rrinte në hije dhe vetëm këmbët i dalloheshin për shkak të bardhësisë së tyre. Kishte një shprehi të çuditshme në sy. Më vështroi ngultazi, me një farë rrëzëllimi që nga fundi i bebëzave, sikur po vështronte ndonjë pikë të largët, sikur donte të më thoshte diçka.

“Jajoi, u kënaqa shumë”, - më tha më në fund, me një buzëqeshje të lehtë.

“Faleminderit”, - i thashë duke pëshpëritur. Mendova se ia kisha dalë. Tezja e kishte kuptuar arsyen e vizitës time. Ndërsa largohesha, e përshëndeta me dorë. U ktheva në shtëpi me nxitim, atë mbrëmje të errët e me ngricë. Nëna më qortoi shumë atë natë sepse u ktheva aq vonë dhe sigurisht, më pyetën se ku kisha qenë, por unë nuk i tregova asgjë. Ishte një sekret që nuk duhet t'ia zbuloja askujt.

BANANA YOSHIMOTO



Parandjenjë e trishtë

Roman

“Nuk e di qysh më erdhi, nuk e di, qysh më pushtoj një vullnet me dalë, me gjithë osteoporozen e skeletit tim, sëmundjen, dhembjet e çalimin, veç kisha dëshirë me dalë. Dita ish si e vranët, njiilloy qetësie dhe paqe e rrënjëshme ishte në oborr.”

“Po, nanë, edhe... e baba?”

“Mos ma kujto atë plak. Është dorëzu prej jetës.”

“Po, mirë nanë, tani, çka bane?”

“Më vinte disi me dalë në qytet. Më kujtohej, vjeshtë e kaluar kur me tezen tande dhe të harruara nga zhurma, kallaballëku i njerëzve dhe aromës së gështenjave duke u pjekur, patëm shëtitur tërë sheshin e qytetit.”

“Është dashuri, ... është dashuri...”

“Jo,... nuk është... nuk mund të jetë, nuk ka këso gjëra në dashuri...” i thotë femra, si në ndonjë klishe, mashkullit të saj, mu afër meje, mu afër tavolinës ku jam i ulur si çdo natë dhe pi nga dy teke e një esspreso. Ishim, “të tre”, dhe vetëm ne të tre, në Caffez, në të vetmin bar – kafene ku dal, për shumë arsye.

Që prej se “mendoj” se dashuria nuk ekziston, (që është, prej se “mendoj” që e kam lexuar Martin Heidegger-in, dhe pohimin e tij se ndërmjet njerëzve, dhe çdo krijese të gjallë, etj, ka vetëm kujdes, dhe jo edhe – dashuri –) gjithashtu mendoj se, pikërisht në këtë pohim unik të këtij filozofi, e kam gjetur atë që gjithmonë më ka munguar, në të rrahurat, pikërisht, të nënës sime, e në helmet e dashurisë në çift (nuk kam pasur shumë lidhje me femra, por ato që i kam pasur, të gjitha, së paku tani për tani, kanë përfunduar në helm). Dhe duke pas dëgjuar femrën që po i thotë mashkullit “nuk ka këso gjërash në dashuri”, mendoj, kjo gjë, aq klishe, do të dalë, ose është, ndonjë paraprijëse e ndonjë fillimi masakre si në filmat e Taratinos, diçka që do të fillojë me “vetëm – fucking - një nga ju le të lëvizë, dhe do të – fucking – ekzekutoj secilin prej – fucking - jush” (sigurisht këto – fucking – shprehjet i kuptojmë secili nga ne tanimë, dhe aq më shumë nuk dua t’i përkthej, dhe as nuk shqiten më nga gjuha jonë, etj), por, kthehem dhe shikoj, them në vete, megjithatë jemi vetëm ne tre këtu, përpos nëse nuk do ta placitkin njëri tjetrin në fund, dhe në fund nuk mendoj se do të ndodhë diçka si ky version; pastaj them, ose, kjo bisedë mes tyre është ndonjë melodramë njerëzish të harruar, ardhur nga ndonjë periferi, jo fizike, por sociologjike e shoqërisë sonë, dhe të gjetur njëri tjetrin mbaruar për njëri tjetrin dhe duke marrë frymë për njëri tjetrin, sepse, nuk arrita ta them, në zërin e tyre ndërsa flasin, përmbahet ajo thyerja e zemrës së njeriut i cili beson në dashuri, në botën me dashuri, dhe, si fëmija, sapo ka kuptuar, se bota është një bushtër, një qen shiu, e cila është duke u përpjekur të mbijetojë në këtë, botë?, apo, univers?, apo botë e të dyve bashkë, që me tërë këtë thyerje, dhe vaj përmbytur në zërin e të dyve, po e ndërtonin mu ashtu si e kishin thurur në ëndrrat e tyre krejt krejt të thella e intime të jetës paraprake njëri – tjetrit.

“Dëgjomë. Edhe ndërmjet babait dhe nënës ka pasur sado pak dashuri, ndonjëherë, megjithëse shumë rrallë, apo, qoftë edhe nëse nëna e bënte këtë vetëm për ne fëmijët. Dhe, gjithnjë në këto ditë, si e vogël, e ëndëroja se në disa ditë gjërat rikthehen si që kanë qenë, si që janë në të vërtetë, si që do të duhej të ishin. Bota bëhej e thjeshtë, si kur bie shi, dhe macja jote vjen dhe të ulet në prehër, e nuk bën asgjë në tërë këtë botë përpos që shikon shiun nga dritarja. Dhe, edhe tani, mendoj, në dashuri bota është e thjeshtë, çdo gjë e keqe që ka qenë kthehet dhe rregullohet, dramati, dhuna mes prindërve, kur ishim fëmijë, kur edhe e kishte rrënuar tërë shtëpinë babai, kur ishim fëmijë dhe, edhe bombardohej tërë kjo tokë, Kosova,...

“... edhe, shkrirja e dordolecit, dhe dielli me ndonjë tërheqje me litarë, si ato llambat

BALLSOR HOXHA

Nuk kishte arritur as te dera e fqinjëve

Tregim



e dashura, për ta ngritur diellin lartë në ditët e mërzitshme...”, them unë me ironi, por, këtë e them, sigurisht, në vete, ndërsa dëgjoj se çka janë duke folur çifti me njëri tjetrin, dhe pastaj vazhdojnë.

“Por, jo, në dashuri, bota, nuk është as e thjeshtë, dhe as nuk kthehet e të rregullohen gjërat si të gjitha rrahjet në tërë jetët tona, të secilit, këdo që ka mundur e i ka ardhur më lehtë të nxjerrë bishën nga vetja mbi ne, në dashuri bota është e mundshme, pikërisht, aty, në atë hapje, ku ti po e thua se kthehen, ato bëhen të mundshme, jetësohen. E kupton çfarë fjale është kjo, bëhet jetë, nuk rikrijohen, nuk rikthehen, nuk bëhen nga e ardhmja, por sikur, kanë pritur, sikur, më lejo të them, si ne të dy të njohim njëri – tjetrin, të arrijmë të du-am, dhe të dashurojmë njëri – tjetrin, nga një gropë, nga një botë e ndarë që për një moment, në dashuri e sipër, jetësohet. Apo, si që është në gjuhën ndërkombëtare, realizohen, bëhen - realitet” thotë djali përballë saj.

“... por, nganjëherë,” them unë në vete dhe vetëvetes, ndërsa dëgjoj bisedën e tyre, “dhe kurrë nuk e harroj, dhe as nuk ia fali vetes, që e kam lexuar se gjirit të nënës si foshnje ia ndiejmë edhe aromën e keqe të djersitjes, e të aromave të tjera të gërditshme (gjithnjë sipas psikanalistes së fëmijëve - Melanie Klain), në një kohë relativisht të hershme në jetë, dhe që nga atëherë nuk mendoj si, le të themi – shqiptar, gjë që asnjë popull a shoqëri tjetër nuk do të bënte dallim po ashtu në këtë të vërtetë vështirë për t’u pranuar, por, sidoqoftë, dhe mendoj se brenda topit të zjarrtë të dashurisë, përzihen aroma e masa e substanca të shkrira të cilat jo vetëm që ermojnë, por edhe lëshojnë masa të gërditshme, gogësimat e mënyra si hamë kur jemi të uritur, pa ndonjë vetëdije se ka të tjerë. Dua, të ju them, më falni që po e marr lirinë (i drejtohem çiftit, gjithnjë ndërsa flas në vete), - jetësimi – i botës bëhet, bëhet saktë në dashuri e sipër, por me gjithë atë që shkrihet brenda llavës së zjarrtë të saj, që as nuk mund ta bartim, dhe as nuk mund ta heqim, as harrojmë... (më kuptoni, u drejtohem, në vete, sigurisht. Dhe ndiej se jam përfshirë tërësisht në këtë bisedë, paksa i dehur, pak a shumë në zinë e

jetës, e edhe i lëçitur nga shoqëria për shkak të njëilloy veçantie timen (ekscentrikeje...)”

“Të puthë zemër, je rrëzëllues, me, mendime, ndjenja, e dashuri. Eh, sapo u – jetësua – bota” thotë femra. Puthen, dhe qeshen

Jemi të ulur, afër, siç e thash, karriget tona janë të larta, shoh prej prapa kokës së mashkullit dhe e shoh femrën përballë, gjë që harroj, nuk e di si më lejon, tërë vuajtja në jetë, etj, dhe fundosem e ngjyhem i tëri ndjeshmëri për fytyrën e kësaj femre që kam përballë, harrohem, dhe e tëra që di është se e dua, dhe më do, se si, më shikon sikur jam tërë – jetësimi – i jetës së saj, dhe, as kjo nuk më zgjon – unë të jem jetësimi i dikujt, as i nënës sime nuk isha, mendoj. Dyzohen gjërat, mendoj, dashuroj, konfliktohem dashurohem dhe urrej.

Pas pak, në këtë dehje e sipër, ndërsa e shikoj këtë femër përballë, shoh nënën time, dhe, kam guxim ta dua. Kam edhe fytyrë ta dua. Kam edhe forcë, të shpërthej tej nxënies së emocioneve nga plakja e saj, dhe ta shikoj përballë e të dukem përballë saj. Më kujtohet biseda e fundit me nënën në telefon, në të vërtetë e vazhdoj atë nga fillimi, e kujtoj, si kishte dashur të dilte në qytet, vetëm, me autobus, duke ecur.

“Tani, duke i veshur patikat nisur e vendosur për të dalë në qytet, se si më vinte edhe njiilloy zemërimi me jetën, me shtëpinë që e kemi aq larg nga qyteti, me qetësinë e paqen në këtë ditë, dhe mezi i veshja patikat.

Më dukej vetja njiilloy tradhtare e jetës, njiilloy mohuese e jetës sime, dhe në të njëjtën kohë, më dukej se në qytet kishte cirk, festë dhe lumturi, dhe se do të harroja, si atë ditë me tezen, shëtitja, në vjeshtë e kaluar, tërë vështirësitë e pleqërisë.

‘Ku po shkon oj qurë, ku po e çon veten, ku po e mbërthen veten, e ke me mbetun rrugës’ tanë kohën, më thoshte mendja.”

“Po nanë, edhe e ki një moshë, tash.”

“Eh, e kam. Por, edhe kujtimi i shëtisë me tezen, si njiilloy fëmijërie e gjetur, por, që disi, fëmijëria ime, kurrë nuk ka ekzistuar në jetën time, vlonte në mua.”

Dehem, tutje, jo si zakonisht, nuk mund t’i ndali porositë e tekeve, dhe as shikimin,

jo vetëm timin, ndaj femrës që kam përballë, por edhe shikimin e saj ndaj meje, krejt të dashur, mirëkuptues dhe të butësisë femërore. Ndërsa, femra, që është përballë meje ka marrë tërësisht fizionominë e nënës sime.

“Por, ajo ka vdekur”, them në vete, krejtësisht i habitur nga kjo harresë, për nënën time, tërësisht i dehur. “Ka vdekur para dy muajve. E kemi përcjellë për atë botë, bashkë me Fisnikun, vëllain e vogël...” Më del përpara i tërë funerali dhe njerëzit e tubuar dhe zia, jo vetëm e vdekjes së nënës, por ajo e ekzistencës sonë.

Zia përfshinë tërë kafenenë, nuk dëgjohet asgjë dhe mbyten në po të njëjtën, zi.

Mendoj, përsëri, se si, nisemi nga lindja jonë, e pakusht, qoftë edhe me gjithë dashurinë prindërore (nëse ajo ekziston), por e pakusht, sepse nuk e dimë as njohim lindjen, botën ku jetojmë, dhe as arsyen pse jemi këtu. Që e bën zinë e jetës, ekzistencës sonë, dyzim, si kjo dehje. Por, këtë moment, pyetem, jam i dehur nga kjo fytyrë e femër kaq e bukur përballë meje, apo nga dehja prej alkoolit, tekeve. Ku është nëna ime?

“Edhe i mbatha patikat. O djali im, më morri ndoshta gjysë ore me i veshë. Bash te shkallët e hymjes në shtëpi. Pasi i veshja, më dukeshin po të njëjtat shkallë, që i pastroj për çdo ditë, aq shumë, aq të larta, aq të vështira për t’i kalu, e sot i kam pastru.”

“Por, nanë, ti je për çdo ditë në oborr, e për çdo ditë del në shitore të fshatit. Çka ndodhi, pasi i mbathe patikat.”

“Joo, i mbatha, dhe u nisa, krejt e ngadaltë më dukej vetja, dhe njëfarë frymëmarrje si me luajt naj sport. Më bllokohej.”

“Tani, nanë, çka ndodhi?”

Më kujtohet e kisha pyetur, dhe tërë kohën qesheshim sinqerisht me këtë, edhe nëna edhe unë. Më tregonte në telefon tërë kohën. Nuk e merrnim seriozisht asgjë që i kishte ndodhur.

Femra, në shikimin tim, mendoj, është pikërisht nëna e kthyer, prej atje, përtej, shpërthyer zinë e njerëzores, dhe po më tregon, diçka që kurrë nuk e kam ditur, lidhur me këtë përpjekje të saj për të dalë në qytet. Nuk e kam ditur as se kishte pasur atë shëtitje, me tezen time.

“Te dera e Qamiles, fqinjës sonë, Ramadan, u ndala. Dy shtëpi tutje, prej oborrit, u ndala. Nuk mundesha, dhe edhe frikësohesha të shkoj tutje. Edhe, nuk kishte të bënte me shëtitje, qytetin e cirkun e vullnetin tim. Ishte kthimi prapa në shtëpi. Ishte si të kthehesha në varr. Kur hyna prapë në shtëpi, baba yt, duke fjetun, mu duk sikur kisha dalë prej varrit tim, tonë të përbashkët me babën tënd, pa leje.”

Nëna ime po më flet, po më tregon, dhe edhe po qeshemi me këtë morbiditet. E nxjerri telefonin e dorës, ora është rreth njëzetedy e mbrëmjes. Ta thërras? Pyetem. E shtypi numrin e saj të telefonit. “Personi që jeni duke kërkuar nuk ka qasje në – jetë”, thotë zëri nga ana tjetër e telefonit.

Si tha, mendoj, në jetë apo rrjetë. Nuk e di, por as nuk dua ta provoj përsëri, dhe as ta di.

Ngrihen, paguajnë, ndërsa tingëllojnë monedhat e metalta me të cilat paguajnë çifti, dhe mbetem vetëm. Dua të porosisë edhe një teke, por kamerieri, aq i dashur, Armendi, i cili më shërben gjithmonë në këtë kafene, më thotë se e kanë mbyllur. Shikoj përreth. E kanë ndaluar ndriçimin, dhe është zi. Kthehem të shikoj fytyrën e Armendit, nuk është më këtu.

“O Ramadan”, më pyet nëna ime përtej kësaj zie, ndërsa dëgjohet jehona e zërit të femrës që ishte këtu (ende nuk kam dalë nga kafeneja, megjithëse e tëra është e mbyllur), një zë krejtësisht i ëmbël, thotë “kur vdes njeriu?”

Poterja e saj në dhomën ngjitur nuk po e linte rehat. Ia trazonte mendimet. Mendimet ia trazonte gjithnjë-jo me qëllim, ama kishte diçka që ishte e bukur dhe komplekse përnjëherësh tek ajo. E çmonte, por kishte frikë t'ia thoshte. Raporti i tyre ishte gjithnjë në tension, dhe natyra e saj paksa tekanjoze e ushqente këtë shtrëngim. Burri joshej nga kryeneçësia e saj aq sa harronte të mendonte për veten. Si në këtë rast, edhe pse e ndiente që zhurma ishte e qëllimshme, ai nuk ndërhynte.

Në raste të tilla, gruaja priste që burri t'i kushtonte vëmendje. Por ai ngriu kryet dhe i tha vetes se këtë herë do të rezistonte, deri në momentin kur ajo do ta kuptonte mesazhin dhe do të vinte vetë tek ai.

Zhurma vazhdonte. Gjëra që hidheshin për tokë, dritare që hapeshin me vrull. Punë sekondash. Ajo u ndal. Burri priti disa minuta, pastaj disa orë. Gruaja nuk po dëgjohej dhe as nuk po paraqitej te dera. Për të treguar se ishte i vendosur, sforcohej aq shumë sa filloi t'i dridhej trupi. La cigaren në taketuke dhe u ngrit. Po endej nëpër dhomë. Pa që jashtë ishte errësuar. Ishte përqendruar aq shumë në qëndrimin e tij, sa nuk kishte vërejtur kalimin e orëve.

Iu kujtua hera e fundit kur i ishte dashur të bëjë kompromisin e dashur për të, t'i shfaqej te dera. Gjithmonë e gjente në shtrat, të lodhur e rraskapitur- e trishtë për t'u parë. Herën e fundit, situata ishte më dramatike se zakonisht. Ajo ishte ulur në cep të shtratit, aty ku i zhvillonte të gjitha dramat e saj jetësore, ato që i ekzagjeronte dhe që askush nuk mund ta bindte për të kundërtën, dhe herë të tjera, kur situatat ishin më të rënda, ajo i trajtonte me lehtësinë më të madhe.

-Çfarë po bën në shtrat?- e pyeti ai.

-Më duket që s'mund të shoh më,- i tha ajo. Në fytyrën e saj kishte shenja dëshpërimi, dhe një trashje gjuhe, fjalët mezi i shqiptonte. I kishte ulur perdet dhe kishte errësuar dhomën, kur përjashta dielli po përvëlonte.

-A ka mundësi së paku t'i heqim perdet, të shihemi në sy dhe të bisedojmë për problemin tënd?- i tha dhe u nis drejt dritares. I hapi me nervozizëm. -Dhoma jonë ka nevojë jo veç për dritë, por edhe për ajër, i tha.

Hapi dritaret. Një puhizë e lehtë hyri në dhomë. Burri mori frymë thellë dhe e luti që të çohet e të shkonin në dhomën tjetër, aty ku ai premtoi se do t'i përkushtohej çdo kërkesë të saj.

-Do?

Ajo ngriti zërin. Po i bërtiste. Zhvendosi bisedën në diçka tjetër, më pak të rëndësishme, duke e akuzuar se me heqjen e perdeve po përpiquej ta paraqiste si një grua të marrë e gënjeshtare, në kohën kur ajo po mendonte se si do t'ia bënte jetës.

-A jetohet kështu?-e pyeti me një naivitet të dhimbshëm.

Burri, që ia njihte viktimizimin si mjet për të arritur qëllimet, u përmbajt kur pa që buza po i shkonte në gaz. Nuk donte ta tensiononte më shumë situatën.

- Qe sa je ulur këtu? - e pyeti.

-Që nga dje.

-Ti po çmendesh,- i tha.-Dje kemi qenë bashkë në kinema, pastaj në park për orë të tëra. Flisje pa pushim për filmat, më thoshe që vetëm ti i kupton të metat e tyre. Që regjisorët nuk i kapin detajet.

I kujtoi një moment, ajo fliste për



një çift në sfond, në një skenë filmi. Ata bisedonin për jetën dhe vendin ku donin të jetonin në të ardhmen. Ai kishte qeshur me përkushtimin e saj ndaj detajeve. Ajo u zemërua dhe ia futi vrapit. Ai e ndoqi deri në stacionin e autobusëve, ku e mori në krahë dhe e puti fort.

-Të kujtohet?- tha.- Të thashë që nuk do të bëja regjisore, por asistente regjisor, sepse ti shihje në perspektivë atë që nuk e shihnte regjisorin vetë. Dhe ti qeshe. Më shtrëngove kokën. U thoshe të tjerëve që nuk kisha shpëtim nga ti. Qesha dhe unë. Shumë. Aq sa pata frikë nga ajo lumturi.

-Kjo nuk ka ndodhur dje, e ke ngatërruar me javën e kaluar. Aty diku në dollap ose në çantë i kam biletat, mund t'i marrësh dhe t'i shohësh,- i tha ajo, më e sigurt se kurrë.

-Mos fol marrëzira,- i tha burri.- Nuk mund të më hutosh për diçka që e kam përjetuar vetë. Është vetëm një ditë më parë.

Gruaja u acarua më shumë. Hodhi dyshime se ai kishte qenë me një grua tjetër në kinema. Ai u trondit nga kjo situatë e re me të cilën nuk e kishte përballur më parë, sado që nuk kishte lënë gjë pa bërë.

E kuptoi menjëherë argumenti i tij, sado i detajuar, nuk do ta ndihmonte më. Nuk kishte hapësirë për tërheqje. U përpoq të gjente rrugëdalje. Qëndroi aty, i shtangur, si një njeri që kërkon rrugë në mjegull. Ndiente se çdo fjalë, çdo përpjekje, për ta përmbysur situatën do ta nxiste edhe me shumë gruan.

Ajo nuk ishte më prezente. Ishte përqendruar diku larg, në një pikë të padukshme. E kishte parë më parë këtë gjendje të përhumbjes që nuk ndodh me hapa, por me mendime.

-Po sytë?- e pyeti ai.

-Më duhet të dal pak,- i tha ajo.

Fliste sikur po shkonte në banjë, jo sikur po dilte nga shtëpia. Mbylli derën ngadalë. Më ngadalë se zakonisht. Nuk u kthye për disa ditë.

...

Pritja po ia shthurte mendimet. Përgjumshëm, pa ngrënë. Kishte pirë shumë cigare, shumë alkool. Po i villej. Shkoi në banjë dhe atje volli sa nuk mbajti më. U ul në pllakat e ftohta. Çoi kokën lart.

Në tavan pa një dritare në formë kubi, s'e kishte parë kurrë që ishte e tillë. Tani po e shihte. Mendja iu turbullua edhe më shumë. Nuk e kuptonte nëse ishte ditë apo natë. Mbi dritare lëkundeshin gjethet e një peme.

“Duhet të ketë qenë ndonjë arkitekt i mirë”, mendoi. Ai që kishte bërë planin e kësaj shtëpie. Shumë e pyesnin për të, por ai s'kishte asnjë ide kush ishte. Mbase shtëpia ishte ndërtuar para pesëdhjetë vitesh. Nuk e dinte. Dinte veç që jetonte në të prej dhjetë vitesh. Jo aq e madhe, por as aq e vogël sa të të zinte frymën. Tani, po e shihte më me imtësi, aty, i ulur për tokë.

Iu kujtua që gruaja, sa herë lahej, i thoshte, “E çuditshme banja. Gjithmonë më krijon një ndjesi pasigurie”. I fliste për fytyra të çuditshme, për forma që shfaqeshin, herë si njerëz, herë si lakuriq nate, sorra...

E kishte pyetur disa herë i shihte këto ditën?

“Jo”, i kishte thënë. “Ditën vetëm gjethet, kur fryn era valëviten, të duket sikur je duke e parë një skenë baleti”.

Gjethet po i shihte edhe ai tani.

“Do të thotë që është ditë”, mendoi.

Kjo mund t'ia sqaronte pak mendimet.

Nëse ajo i kishte thënë që gjatë ditës shihte vetëm gjethet, dhe ai po shihte vetëm gjethet- edhe pse ajo i kishte përshkruar si të valëviteshin, e ai s'ishte i sigurt... mund t'ishte ditë.

Zhurma në dhomën ngjitur kishte ndodhur në mëngjes, në orët e para të ditës. Atëherë i binte që ajo ishte ngujuar në dhomë, kishte bërë zhurmë gjatë ditës. Dhe nëse tani ai po i shihte gjethet, i binte që ishte ditë.

Nga turbullimi i trurit nuk arrinte të kuptonte, a ishte ende ajo ditë? Ajo e

zhurmës? Apo kishte kaluar një natë dhe kishte filluar dita tjetër?

Kishte një hile këtu.

Po e përjetonte ndjenjën e vjelljes, por nuk po mund të çohet të pinte ujë. Muskujt e tendosur ia vështirësonin lëvizjet, ndërsa lodhja frymëmarrjen. Merrte frymë ngadalë, çrregullt. Po mbante gjoksin me duar, mendohej të rregullonte ritmin. Pika të zeza i shfaqeshin para syve.

“Nuk kam ngrënë as pirë,” -tha me zë të ulët.

Kjo, edhe më shumë, ia nxitte dyshimet.

A ishte brenda së njëjtës ditë me zhurmën, apo kishte kaluar edhe një ditë tjetër?

Po të ishte ende e njëjta ditë, nuk kishte ngrënë mëngjes. Po plogështia që ndiente nuk mund të ishte thjesht nga një mëngjes i munguar. Po të kishte kaluar një natë, atëherë bëhej më e kuptueshme ajo sasi e madhe duhani dhe alkooli që kishte pirë.

Gjasat që të ishte ende brenda së njëjtës ditë ishin të vogla.

... atëherë pse nuk kishte dëgjuar asgjë prej saj? As hapje dere, as përdorim banje, as zhurmë uji. Nevojat bazike?

Shikoi sërish lart. Dritarja nuk iu duk më si në formë kubi, por si një sy i madh që do ta kapërdinte nga çasti në çast. Në cep vuri re një gjethë që lëvizi dy-tri herë dhe u ndal.

Sikur po përpëlitej për herë të fundit, para se të jepte shpirt.

...

Ajo ishte ulur përballë televizorit, pasi kishte pastruar shtëpinë nga gjërat e tepërta. Kjo punë i merrte më shumë energji se cilado tjetër, por rregulli i pëlqente. S'kishte pasur ditë më të trishtueshme se kjo, nuk e dinte pse. Pikërisht kjo mosdije, kjo gjendje pa emër, ishte ajo që e bënte edhe më të trishtueshme.

Shpesh e kalonte duke bërë dush.

U ngrit dhe shkoi në banjë me idenë që dushi i nxehtë do ta qetësonte. Dushi i ndihmonte t'i rregullonte mendimet, por shpesh i nxiste të tjera, më të rënda, më të thella. Momenti e kërkonte, edhe një dush për të larë trupin, për të hequr erën e keqe nga flokët e lëkura. “E marrë”, i tha vetes me buzëqeshje të lodhur.

U kthye pak të merrte gjërat, peshqir, kremra, shampo. Dhoma ishte errësuar shumë. I hoqi perdet, hapi dritaret. Perdet ia ngushtonin mendimet, ka një kohë të gjatë që kishte menduar t'i hiqte krejt, po nuk u kishte ardhur radha.

Nga brenda dushit, ajo ndjeu që dikush po e vështronte. S'u tremb. Ishte si një ndjesi e vjetër. Ktheu kokën nga dritarja mbi banjë, përtej xhamit të mjegulluar, gjethet qëndronin të palëvizura.

Qëndroi ashtu për pak. Nuk lëvizi. Trupi ishte nën ujë, por mendja i rrinte pezull, si në një vend bosh ku nuk depërtonte më zhurma e jashtme.

Vuri re një lëvizje, jo jashtë, por brenda saj, brenda barkut të saj. Një ndjesi e ngjashme me atë kur ndihesh i huaj në trupin tënd. Sikur s'kishte qenë kurrë aty. Ishte e larë, e pastër, por njëlloj e huaj.

Në një moment, iu duk se po e dëgjonte atë, po ia dëgjonte frymëmarrjen e çrregullt, por nuk lëvizi e as nuk ktheu kokën. Mbylli sytë dhe qëndroi nën ujin që tani i dukej më i rëndë.

PAUL VALÉRY (1871-1945)

Poet, eseist dhe filozof francez, Valery ka qenë i nominuar për 12 vite të ndryshme për të fituar Çmimin Nobel. Qe përfaqësues i Francës në Lidhjen e Kombeve për Çështjet e Kulturës. Konsiderohet si njëri ndër eruditët më bindës të shekullit të XX-të.

ENGJËLLI QË MË DHA NJË LIBËR

Duke ma dhënë në duar librin, engjëlli tha: Përmban gjithçka që ti kishe dashtë me dijtë, Dhe u zhduk. Kështu që e hapa librin. Nuk kishte shumë fletë. Ishte i shkruar në një alfabet të panjohur. Dijetarët e kanë përkthyer, por në variante krejt të ndryshëm. Madje nuk janë në një mendje se si duhet lexuar, a nga lartë-poshtë apo nga poshtë-lart, nuk bien dakord të lexohet nga fillimi në fund a nga fundi në fillim. Pranë mbarimit të këtij vegimi, m'u duk sikur libri u shkapërnda, aq sa

Nuk mund ta dalloje më nga objektet e botës që na rrethon

WALLACE STEVENS (1879-1955)

SHTËPIA ISHTE E QETË DHE BOTA ISH E QETË

Shtëpia ishte e qetë dhe bota ish e qetë. Lexuesi u bë libri; dhe nata e verës

Ishte si qenësia e vetëdijshme e librit. Shtëpia ishte e qetë dhe bota ish e qetë.

Fjalët shqiptoheshin sikur të mos kishte libër, Përveçse lexuesit që ish përkulur mbi fletë,

Donte të përkulej, donte aq shumë të ishte Dijetari për të cilin libri është i vërtetë, për të cilin

Nata e verës është si përsosmëria e mendimit. Shtëpia ishte e qetë sepse kështu duhej të qe.

Qetësia ishte pjesë e kuptimit, pjesë e mendjes: Hyrja e përsosmërisë në fletë.

Dhe bota ishte e qetë. E vërteta në një botë të qetë, Në të cilën s'ka kuptim tjetër, vetë

Është e qetë, vetë është verë dhe natë, vetë,dhe Është lexuesi i përkulur vonë dhe duke lexuar atje.

SEAMUS HEANEY: Nobelist, Irlanda e Veriut

Seamus Heaney (shqiptohet Shejmës Hini), Çmimi Nobel 1995) - Poet, Eseist dhe përkthyes - ashtu si të gjithë intelektualët e shekullit të XX, provoi një ndërprerje-shkëputje me ambientin nga vinte. Ndryshe nga prindërit e vet, nga bashkmoshatarët dhe miqt e ti, ai zgjodhi të ec përmes një shtegu tjetër nga ai i fermerve dhe tregtarëve fermerë irlandez. Ndonëse në poezinë që po paraqesim, ai flet për këtë shkëputje, për të cilën është i vetëdijshëm, prapë se prapë ai përpiqet ta shkurtoj sa më tepër distancën ndarëse të saj. Ai pohon se profesioni i vet tij në fakt nuk është shumë larg nga profesioni i babait të tij a i gjyshit të tij. Ndryshojnë veç mjetet e profesionit. Të parët e poetit gërmonin me lopatë, ndërsa ai gërmon me penë. Për Shijmës Hinin, poezia është një profesion tokësor.

Nuk e di se sa snobë kooperativash me flokët bisht,-kali, që pozojnë intelektualin e rreptë të nahijes tonë, do ta konsideronin poezinë një profesion të tillë.

GËRMIM

Mes gishtit tregues dhe gishtit të madh Qëndron stilolapsi i trashë; I sigurt si armë.

Nën dritaren time, një zhurmë që gërricë e ndihet qartë Kur në tokën me gurë futet një lopatë: Tek gërmon im At. Shikoj jashtë Derisa të pasmet e tij tendosur në vllajë Përkulen poshtë, e shfaqen sërish, njëzet vjet më parë Anuar me ritëm në brazda patatësh Atje ku gërmonte at'herë.

LEXUESI QË BËHET LIBËR

Zgjodhi dhe përktheu : Rudolf Marku

Zgjodha, për lexuesit e ExLibrit, pesë poetë të shekullit XX (njëri prej tyre i shekullit XXI), dhe pesë poezi të tyre me temën e Poezisë. Pra, si të thuash, ky cikël poetik përbëhet nga Poezi për Letërsinë. Nuk është gjë e re. Preokupimi i poetëve për poezinë është shqetësimi i natyrshëm i mjeshtrit për zanatin e vet. Një preokupim që vjen, krahash tjerash, dhe nga pakënaqësia e vetë poetve për keqkuptimet që krijojnë rreth krijimtarisë poetike studjuesit dhe kritikët, të cilët, sa herë që flasin për krjimtarinë e Poetëve, bëjnë që poetët të ndërmarrin vendimin që të shkruajnë vetë për krijimtarinë artistike, qoftë dhe në formën e Ars Poetica .



Portret nga Pashk Përvathi

Mbështetur mbi teh çizmen e trashë, Doreza shtërnguar fort me gjunj mbi aks Shkulte pjesët sipër, fuste tehun e ndritshëm thellë Për të nxjerrë patatet e reja që i mblidhnim, E donim fort ftohtësinë e tyre në duart tona.

Për at Zot, plaku ishte mjeshtër në lopatë. Ashtu si plaku i tij.

Gjyshi im priste më shumë torfë për një ditë Se çdo burrë tjetër në moçalin Toner.

Një herë i çova një shishe me qumësht, Mbyllur keq me letër. I dha trupit drejt Me e pi, pastaj u kthy menjëherë prapë Duke i prerë plisat dhe ndarë saktë, Hedh copat pas, duke zbritur thellë e më thellë Për torfën e mirë.

Gërmim. Era e ftohtë e mykut të patateve, përplasje dhe pllakama E torfës së lagësht, prerjet-shkurt të tehut Më zgjojnë në mendje tek kalojnë nëpër rrënjët e gjalla,

Por unë s'kam lopatë të ndjek burrat si ata. Ndërmjet gishtit tregues dhe të madh Qëndron stilolapsi i trashë. Unë do gërmoj me të. (1966)

MARIN SORESCU : Rumani (1936-1996)

...kam patur fatin, së bashku me Aurel Plasarin, që ta takoj Marin Soreskun, në Bukuresht, në vitin 1994/5, jo vetëm një poet i mrekullëshëm, poezitë e të cilin Seamus Heaney ia përktheu dhe ia botoi në Angli, por dhe një njeri i mrekullueshëm. Më pat shprehur dëshirën e madhe që të bënte një vizitë në Tiranë, dëshirë që zyrtarët shqiptarë nuk ia plotësuan asnjëherë, ndonëse ai vetë aso kohe qe Minister i Kulturës i Rumanisë.

SHEKSPIRI

Shekspiri e krijoi botën në shtatë ditë. Ditën e parë krijoi qiellin, malet, thellësitë e shpirtit, Ditën e dytë krijoi lumenjt, detet, oqeanet, Dhe të gjitha ndjenjat, Për t'ia dhënë Hamletit, Çezarit, Mark Antonit, Kleopatrës, Ofelisë, Othellos dhe të tjerëve Që, këto ndjenja, të jenë të tyret dhe të pasardhësve të tyre, Shekuj pas shekujsh.

Ditën e tretë Thirri të gjithë njerëzit që t'u mësojë shijet: Shijen e lumturisë, të dashurisë, të dëshpërimit, Shijen e xhelozisë, të lavdisë, e kështu me rradhë Deri në fundin e shijeve; Atëherë ca njerëz të vonuar erdhën në minutën e fundit, Shekspiri u përkëdheli kokat me dhëmbshuri Dhe u tha se ata do bëhen Kritikë letrare, Që ta shajnë veprën e tij. Dita e katërt dhe e pestë qenë rezervuar për të qeshurën. I la kllounët të vijnë, Për të bërë pirueta; Bëri që Mbretërit, Perandorët, Dhe të gjithë fatkeqët e tjerë të kësaj bote, të harronin. Ditën e gjashtë U mor me zgjidhjen e ca punëve administrative; Lëshoi një stuhi, Dhe i mësoi mbretit Lir Si të vendosë në kokë një kurorë prej kashte. Ngase kishin mbetur ca hedhurina nga krijimi i Botës, Me to bëri Rikardin e Tretë. Ditën e Shtatë, vështroi nëse kish gjë tjetër për të bërë. Drejtorët e Theatrove e kishin mbushur planetin me afishe; Shekspiri mendoi se pas një pune aq të lodhshme, E meritonte dhe ai vetë të shihte një shfaqje, Por, ngase qe i lodhur në ekstrem Shkoi të vdiste pak.

Liu Ligan- Kinë

LIGJERATË LETËRSIE (Përktheu nga gjuha mandarin në anglisht nga Dong Li)

Lao She u mbyt në një liqen. Fu Lei u var. Xiong Shil vdiq nga greva e urisë. Dhe Shen Congwen iu kthye studimit të veshjeve të lashta kineze. Është një listë dërrmuese, që mbijeton dimrat si narciset e fishkura mbi dritare, si bishtat e hudhrës që nxjerrin gjethe të sëmura të një epoke tjetër. Ende student, lexoja veprat e tyre, qoftë letërsi apo filozofi. Më mësuan se “Letërsia është studimi i Humanizmit,” e rëndë, si një shtëpi solide mbi shkëmbinjt që shoqëron degëzimet e trazuara të letërsisë sovjetike dhe perdet prej kadifeje të Realizmit Kritik. Jam ende i hutuar nga pafuqia e letrarëve të vjetër dhe braktisja e tyre njëzëri. Kuptimi i tyre për natyrën njerëzore s'ndihmoi të hapej një rrugë e drejtë mes shkurreve për brezat e

ardhshëm.

Përkundrazi, u përzien vetë dhe trashën
mjegullën e kohëve të errëta. Kishte vetëm
rrufe të zhurmshme të Letërsisë së
Plagëve,

por askund nuk gjendej rrufeja e heshtur
që përshkonte
perdet prej hekuri. Midis kampeve të
punës dhe arave të orizit,
midis bojës blu të errët dhe ingranazheve
të mprehta e të shpejta,

a duhet që shkrimtarët të jetojnë me
përulësi
për gjithçka që dëshirojnë të shkruajnë,
apo duhet, tek heqin dorë nga talenti dhe
misioni,

të refuzojnë pjatat e njollosura dhe të
vdesin?

Në lulëzimin e rinisë sime, isha i
magjepsur
pas tipave të fortë të Hemingway-t, derisa
heronjtë
u bënë po aq të zakonshëm sa vetë
mjekrat.

Kur fillova të mendoja për çështje
si përgjegjësia, veprimi letrar, e të tjera,
rastësisht, u drejtova te një shtëpi
në një rrugicë pranë shtëpisë së gjyshit,
ish-shtëpia e një shkrimtari dekadent të
harruar.

Në ligjëratat e mia letrare, shkolla e
Rosave Mandarine
dhe e Fluturave' ishte thjesht një bonsai që
shtonte
ngjyra në jetë. Ideja për të hedhur veten
në pus
për bimë të shkelura dukej dyfish absurde.
Në atë pasdite, në atë kopsht të braktisur,
papritur e kuptova
se vetëm vdekja e Zhou Shoujuan
mund të quhej vdekja e vërtetë e letërsisë,
së bashku me gjithë zhgënjimet e
zakonshme, të vogla,

të parëndësishme të bukurisë, dhe fijet
e tërhequra nga koçonat e zemrës,
dhe shpirtërat e thyer të lirisë
mbi flamujt e qepur me ngut, dhe një
stilolaps i topitur
që thyeret në zhurmën e këngës së
eunukut.

Nga ai çast e tutje, e dija se ajo që po
trashëgoja
ishte një trashëgimi e madhe heshtjeje.
Kur e gjitha një gjeneratë shkrimtarësh
u kthyen në fantazma, të paaftë të
mbyteshin apo të vdisnin urie,
qoftë kur marr penën si rebel
apo dorëzohem për hir të fjalës së shkruar,
jam i dënuar të bie në një vorbull të
pashmangshme,

në një mospërputhje fatale: diçka e
ngjashme
me dridhjen pa shpresë të një pacienti me
Parkinson,

me shikimin e hutuar, po aq i lodhshëm
sa një bisedë e gjatë që luhatet
midis pyetjeve, po aq e zymtë
sa palat e të brendshmeve të një zonje të
moçme
dhe heshtja e përjetshme përreth kafkës.

Shënim: Lao She, romancier, u torturua
gjatë revolucionit kinez, aq sa ai u mbyt. Fu
Li, përkthyes dhe kritik u persekutua dhe vrau
veten. Xiong Shii, eseist dhe filozof u shndrua
në një objekt abuzimesh dhe torturash fizike në
fillimet e revolucionit kultural. Shen Congwen,
romancier, u sulmua ngase, për herë të parë
një shkrimtar kinez fitonte Çmimin Nobel për
letërsinë, por vdiq dy ditë më parë se ta merrte
Nobelin. Zhou Shoujuan ishte përfaqësuesi
i letërsisë eskeipiste, një lloj Lasgushi kinez,
përfaqësues i shkollës "Rosat Mandarine dhe
Shkolla e Fluturave", i cili u hodh në një pus
gjatë revolucionit kinez.

MEHMET ELEZI

Romeo pa emër

Tregim



ROMEO PA EMËR I ROZA XH.

Pas shfaqjes së filmit të ri në qendër të
fshatit, qe larguar dy herë nga shtëpia dhe
të dy herët qe kthyer të nesërmen. Tashti po
mbusheshin dy ditë e dy net pa lajm prej tij.

Nga na humbe, e ngucën shokët herën
e parë, është e bukur? Në fytyrë i kishte
rrëshqitur pjerrëtazi një dritë e kuqeremtë,
si shkrepja e hënës në një shpatinë me borë.

Hapën sytë kur zuri në gojë Shkodrën.
Domethënë ajo jeton në qytet, bash në
Shkodër?

Diçka ngecte megjithatë. Ku e njohu?
Djali kish heshtur për këtë pyetje. Veç kësaj,
Shkodra s'i shpjegonte dy zhdukjet e tij.
Shko e eja në Shkodër brenda 24 orësh, ishte
e pamundur. Edhe në paç Ferrari. Katër orë
të mira duhen me u djergë në këmbë deri në
rrugë të makinës, aty prit për ndonjë kamion
kromi deri te miniera, mbaseandej për
ndonjë kamion të ndërmarrjes së sharrave
dhe, me pasë shumë fat, kalon ndonjë Gaz
kinez i gjeologjisë. Pa folë për anën tjetër.
Vajza në kuk të Shkodrës, ky mbase maleve,
i hupun. Ajo në shkollë a me punë të mirë në
qytet, ky... Këto plasaritje i zbuste disi shtati
e tij prej atleti dhe syri i madh, i ujshëm, që
e përthiente dritën si xixëllonjë. Dhe kokrra
e djalit, i mirë sa të duash.

Dy ditë e dy net, nuk po kthehet. Mbase
përnjimend ka mbërri në Shkodër, është
ndalur atje?

Dy herët e para kish veshur tirq e jelek,
ia kish dhënë përgjegjësi i vatrës së kulturës,
ishin shokë. Këtë herë e kishin parë me
pantallona dhe xhakët të bukur kadifeje. I
bleu pik për rastin a ia huajti dikush?

Katërdhjetë e tetë orë, as shenjë as
dokë. Familja në ethe. Një lajm thotë në
Qafë të Dredhëzave është rrezuar një zetar,
karrocieria ka zënë përfund dikë. Do të jetë
grahësi i zetorit, shkretani. A ndonjë rrezikzi
prej katundeve matanë qafës, lëvizin me
mjete rrethanore.

E njohën prej së largëti, nga kostumi i
bukur prej kadifeje. Sytë e mëdhenj mbetur
çelë, lëngëzimi i tyre burues, i ngrirë. Bebja
e syrit të hapur të viktimit është diçka si
kutia e zezë e avionit, tha zëvendëshefi i
policisë. Ruan fytyrën e mbrame që ka parë,
zakonisht është fytyra e vrasësit. Po te ky
rast s'ka ç'zbulon syri, tundi kryet. Duket
qartazi, aksident rrugor.

Karrocieria kish bërë disa rrotullime, ish
përplasur në trungun e një pishe, duke ia
çaraveshur e rjepur lëvoren, dhe aty kish
ngecur. Zetori kish përfunduar thellë në
përrua.

Nga këqyrja në laborator shtangën. Në
bebëzen e ngrirë përnjimend qe fotografuar
një fytyrë. Nuk qe fytyrë burri. Qe fytyrë
gruaje. Grua e re, dritë e bukur. Vrasëse kjo?!
Nuk, s'. Pastaj nga mbiu ajo në atë rrëgalle,
ku u rreknye dhe theu qafën traktori?

Filmin e ri të Kinostudios e pat sjellë
autokinemaja në katund. Gjindja nuk e
hiqnin goje vajzën, që luante aty. Djali me
sy të lëngëzuar, që e përthyenin dritën si
xixëllonjë, u ngurua, thua e shitoi zana. Të
lutem eja edhe nesërmbërma, dua ta shoh
prapë, i tha shoferit të autokinasë. Dhe
e mbylli gojën.

Më vonë u zhduk dy herë, pa u marrë
vesh ç'u bë. Qe tashti e treta!

Zëvendëshefi i policisë vrojtoi
portretin e zbehtë, të ëndërrt, mbetur në
sytë e viktimit, mblodhi buzët me habi dhe
shqiptoi:

- Bash ajo është!

Ajo dhe djali i vrarë qenë parë një herë
dhe kurrë më. Një herë, aty, te stalla e
kooperativës.

Ajo lëvizte nëpër murin e sapolyer
me gëlqere. Muri i bardhë i stallës kishte
shërbyer si ekran për filmin, që kish sjellë
autokinemaja.

Ai ngulur pip në oborrin me barishte, me
bagla e me guralecë, mes turmës që ndiqte
filmin gojëhapur.

Ajo quhej Roza Xhuxha.

VETËVRASJA

Ajo në vit të fundit në fakultet, unë në
të parin. Pas një zënke koti te biletaria e
Kinemasë *Studenti*, çuditërisht qemë bërë
miq.

- Ç'kemi?, ia shkela syrin.

Po më dukej interesante.

- Yll fare. Kadareja duhet të vrasë veten.

Bebëzat ngjyrëlaithi iu zmadhuan
rrathë-rrathë. Mbi bluzë i ranë stërpikë
drite.

Nuk po e kuptoja.

- Me "Gjeneralin..." e tij po e pushton
botën, tha. 34 vjeç, në zenit. Po të vdesë
tashti, qajnë të gjithë. Po të vdesë tashti,
edhe pas treqind vjetësh do të qajnë njësoj
të gjithë. Sa i ri e aq i madh, ah sikur të kish
jetuar. Siç thonë për Mozartin.

Të nesërmen te hyrja e fakultetit
nxinte një foto me kornizë të zezë. Një erë
e matanbotshme e kishte shuar dritën e
bebëzave ngjyrëlaithi. Mollëzave shpërhapej
një re e hollë me pluhur hiri. Diçka qe djegur.

Ajo kishte vrarë veten.

ASNJË HIJE NË CEREMONINË E AMBASADORIT TË PAQES

Lajmi se bashkia e qytetit B. do të
dekorojë me ceremoni një ujë, u duk si
gallatë kafenesh. Qyteti ynë e ka në soj
hajgaren, kemi edhe traditë karnavalesh.
Edhe ftesat për të marrë pjesë në ceremoni
u panë si trashje e kësaj gallate, ani pse një
ftesë që bën lojna me firmën e kryetarit të
bashkisë e me vulën e institucionit, duket
si guxim i tepruar. Fjala e përhapur për
dekorimin e ujkut u bë më intriguese,
kur njerëzit çukitën në faqen zyrtare
bashkiabalkan.eu. Një tekst i shkurtë me
disa hollësi organizative, ku rreshtoheshin
edhe emrat e rrugëve të qytetit që do të
bllokoheshin atë ditë për arsye sigurie,
shpërndante çdo dyshim. Apo faqja zyrtare
e qeverisë vendore është hakëruar?

Portale, kafene e feisbukra gëlojnë, lajmi
i shekullit: ujkut do të nderohet me titullin
Ambasador i Paqes! Ujkut Ambasador i
Paqes?! Pse jo. Duhet trimëruar, kur jep
qartazi shenja se po përfaqon vlerat e
shoqërisë sonë. Po ployës në vathë, ç'emër
t'i vemë? Dëgjo, në ecsh me kryet kthyer
mbrapa, nuk bën kurrë përpara.

Zbardhet zanafilla e dekorimit. I lodhur
prej ployës, me sy të lëbyrur, ujkut ndalet
me marrë frymë pak. Dallon një qingjöz
mbështetur te muri. Varra i kullon pikë-pikë,
gëzofi i bormë bërë i kuq, në buzë i kanë
mbetur dy fije bari, s'ka fuqi me i përtypë.
Diçka i ndërmendet nëpër tym ujkut. Po, ia
kish ngulur qingjözës një dhëmb në fyt, e
kish lënë kush e di pse dhe ishte kthyer te
të tjerat, pastaj e kish harruar. Tashti ujkut
të ngimë i vjen keq për qingjözën. E qet në
shpinë dhe lëshohet në pikë të vrapit drejt
spitalit. Kamerat shkrap e shkrup.

Ndërhyrje kirurgjikore, transfuzion
gjaku, qingjözë e merr veten.

- Zoti ujk, akti juaj human na mrekullon.

Një sjellje e tillë nuk mund të kalojë pa u
vlerësuar. Kemi kënaqësinë t'ju propozojmë
për titullin Ambasador i Paqes.

Pushteti vendor fërgëllon në ethet
përgatitore për ceremoninë. Njoftohet një
ndryshim programi. Meqë salla e bashkisë
është e vogël, ceremonia do të zhvillohet
përjashta, në shesh. Shërbimi meteorologjik
jep siguri për mot të bukur. Është ftuar krejt
qyteti. Hotelet përreth ding me gazetarë.
CNN, BBC, Euronews dërgojnë reporterët
më në zë, që kanë raportuar nga vatrata e
nxehta të luftës.

Ujkut i vezullon qimja. Ka veshur kostum
të zi e kollare flutur. Edhe kryebashkiaku
me kostum të zi e kollare flutur. Në
sytë e qingjözës çelin dy luleshqerra.
Qerpikët hijeshuar me rimel. Jo, s'është
rimel, saktëson karrocieri dhëmbërrënë i
ndërmarrjes së gjelbërimit, duke ia veshur
pelës me kamxhik. Qingjözën ashtu e ka
hijeshuar Zoti, është sykë. Ujkut dhe syka e
bardhë si flok bore ecin krah për krah. Ujkut
përsëndet me elegancë, duke u përkulur
lehtazi.

Papritmas qingjözë mpyhet, thua e
nguruan zanat. Një hap s'e hedh dot.
Ndonjë lëvizje pa takt e ujkut, ia ngriu
gjakun? Me sytë hapërruar e vështrimin
e ngrirë, bukuroshja e vogël, e brishtë, nis
me u dridhë. Njerëzit e bashkisë në alarm,
nuk mund të lejohet kurrfarë hije mbi
ceremoninë. Ia beh me ngut mjeku. Mjeku
e këqyr me kujdes qingjözën. Mbledh buzët,
s'kam ç't'i bëj. Bën me dorë kah bebëzat e
kthjellta të sykës. Le me kuptue diçka, që ai
nuk e shqipton.

Në sytë e dëlirë të qingjözës ëngjëllore
pasqyrohet një re e lëbardhme tymi. Nëpër
të flakërojnë zjarret, ku një varg qingjash
po piquen në hell, për drekën zyrtare me të
ftuarit VIP në ceremoninë e shpalljes së
ujkut Ambasador i Paqes.

Në qytetin e Nju Jorkut të sotëm, një përkthyes shqiptare pranon me ngurrim të punojë me Alfredin, një i mbijetuar nga torturat në luftën e Kosovës, gjatë seancave të tij të terapisë. Pavarësisht paralajmërimeve të burrit të saj, ajo shpejt përfshihet në problemet e klientit. Ankthet e Alfredit i zgjojnë kujtimet e saj të varrosura. Romani i parë i shkrimtares shqiptaro-amerikane Ledia Xhoga, “Misinterpretation”, u vlerësua me Çmimin e Librit në qytetin e Nju Jorkut, u rendit në finale të “Center for Fiction First Novel Prize”, u rendit në listën e librit më të mirë të vitit 2024 nga Debutiful dhe tashmë është e renditur në listë si kandidate për Çmimin Booker 2025. Romani është botuar fillimisht nga Tin House, Nju Jork 2024, dhe më pas nga Daunt Books Londër 2025.

Romani “Keqinterpretim” është krijuar mbi një strukturë delikate të përjetimeve ndërnjerëzore në një kontekst migrimi, shumëkulturore dhe emocionalisht i fragmentuar. Në thelb, romani ndërton një botë ku përkthimi nuk është vetëm akt gjuhësor, por edhe ekzistencial, ku fjalët, gjestet dhe heshtjet përkthejnë botëkuptime, frikëra dhe intimitete të paartikuluara. Në qendër të romanit ndodhet përkthyesja shqiptare në SHBA, e cila lëviz ndërmjet personazheve të ndryshëm, Alfredit, refugjatit kosovar me traumë të pazbuluar, Lejlës, një poete kurde e ndjekur nga dhuna familjare dhe paranoia, dhe bashkëshortit të saj Billy, një profesor filmi i cili përfaqëson një jetë të stabilizuar por emocionalisht të zbehur.

Ky lloj konfigurimi është dinamik gjithnjë në lëvizje, në tension dhe shpërbërje të vazhdueshme. Vetë përkthyesja e ndien këtë lëvizje kur thotë se “ka një intimitet të panatyrshëm që zhvillohet mes meje dhe klientëve të mi”. Ajo lëviz vazhdimisht ndërmjet rolit profesional dhe përfshirjes emocionale, duke mbajtur në duar një sistem të paekuilibruar emocionesh që nuk mund të përkufizohen lehtë.

Marrëdhëniet ndërtohen mbi një lloj asimetrie emocionale, ku afërsitë krijohet shpejt por pa themele të forta, ndërsa ndarja ndodh pa u kuptuar, si një rëshqitje. Alfredi krijon një besim të menjëhershëm tek përkthyesja, Lejla kërkon mikpritje, mbnështetje dhe siguri. Të dy këto personazhe, kërkojnë më shumë nga protagonistja, sesa ajo është në gjendje të japë. Kjo gjeneron një gjeometri të pjerrët, ku energjia emocionale rrjedh në mënyrë të pabarabartë dhe shpesh në mënyrë të nënkuptuar.

Në qendër të romanit, përkthyesja shqiptare në New York, ftohet për të përkthyer terapinë e Alfredit, të mbijetuar nga dhuna dhe torturat në luftën e Kosovës. Por sa më thellë hyn në këtë akt, aq më shumë kupton se përkthimi nuk është një pasqyrë e fjalës, por një akt që transformon, që zhvendos, që vendos barrë emocionale. Këtu ndodh një shndërrim epistemologjik, ku përkthyesja nuk është më e padukshme. Ajo bëhet figura qendrore e procesit të kujtesës, dhe në këtë mënyrë, letërsia ndërton një etikë të vëmendjes, ku të përkthesh do të thotë të kujdesesh, të marrësh përgjegjësi për dhimbjen që nuk është jotja.

Në roman, marrëdhëniet mes personazheve kryesorë, përkthyeses, Alfredit, Lejlës, Billit, ndërtohen mbi një afërsi të papërshtatshme, komunikime të ndërlikuara, dëshira të pashprehura, dhe një ndarje që nuk është e mbyllur, por pezull. Kjo krijon një gjeometri të paqëndrueshme, një lloj figure jo të rregullt ku emocionet nuk e gjejnë qendrën e tyre të balancuar. Kjo është thelbi i keqkuptimeve/misinterpretation.

Romani është vlerësuar jashtë mase, ku nëpër vlerësime janë përmendur fraza, si: “subtly blurs the distinction between help and harm... strangely human/që turbullon

Romani *Misinterpretation/Keqinterpretim* është kandidat për Çmimin Booker Prize 2025

Spiralet analitike të “MISINTERPRETATION”, romani i autores Ledia Xhoga

Nga Pol Milo



në mënyrë delikate dallimin midis ndihmës dhe dëmit... çuditërisht human” nga juria e Booker Prize 2025/The Booker Prize. Po ashtu, është përshkruar si një narrativë “ruminative and propulsive/përtypës dhe shtytës” që interrogon temat e ndjenjave, përkthimit dhe kufijve emocionalë.

Romani ka një ton etik të padukshëm por shpesh të nënkuptuar. Ai shndërrohet në përvojë estetike, pa kaluar në moralizim. Ndeshmëria, kujdesi, përballja me transformimin, janë të bukura jo sepse janë të mëdha/groteske, por sepse janë të vërteta dhe të ndeshme. Aika një strukturë narrative ku përvoja e brendshme e personazhit kryesor nuk ndjek një vijë të drejtë zhvillimi linear, por rrotullohet rreth vetes, duke u thelluar gradualisht në ndërgjegje, përmes rikthimeve, kontradiktave dhe zhvendosjeve të vazhdueshme. Kjo spirale emocionale dhe


njohëse është thelbësore për mënyrën se si lexuesi përjeton dhe kupton transformimin e personazhit.

Në qendër të spirales është takimi me Alfredin, një personazh fillimisht i huaj, i panjohur, që vjen nga trauma. Ajo mendon se është vetëm një rast tjetër përkthimi, por, si një spirale që kthehet dhe afrohet përherë e më shumë rreth qendrës, takimet me të sjellin një intimitet gjithnjë e më të ndërlukuar. Fillon me një ndihmë përkthimi për dentistin, më pas vazhdon me ndjesi fizike të prekjes dhe shtrëngime duarsh. Pastaj me kërkesën e Alfredit për ta shoqëruar në terapi të psikoanalisti, derisa ajo merr pjesë në trajnim dhe shkon në kufijtë e shkëljes profesionale. Çdo kthesë e spirales e zbërthen një shtresë të re të vetëdijes, që lidhet me ndeshmërinë, ndalimin, dyshimin dhe tërheqjen. Por nuk

ka kthim prapa, ka vetëm thellim.

Romani ndërton dy spirale që zhvillohen paralelisht dhe ndonjëherë ndërthuren. Njëra është marrëdhënia me Alfredin, që e çon drejt intimitetit me dhimbjen e tij. Tjetra është marrëdhënia me Lejlën dhe Sanazin, që përballlet me dhunën ndaj grave, paranojën, përkushtimin emocional dhe cënimin e mikpritjes ndaj tyre. Këto spirale nuk janë harmonike. Ato krijojnë disa përplasje që kulmojnë me shpërthimin e Bilit, shkatërrimin e murit dhe krisjen e botës së brendshme të protagonistes.

Pika më e thellë e spirales është kur ajo ndien se dhimbja e Alfredit, makthet e tij, hallucinacionet mitologjike, e ndihmojnë edhe atë, jo si terapistë, por si qenie njerëzore që nuk e ka përballuar ende vetminë, humbjen e babait, nënën e izoluar, martesën e përgjumur. Në atë çast, shfaqet si një



subjekt i gjendur brenda spirales së tjetrit, që ndërkohë është spirala e saj. Këtu forma e spirales analitike mer formë ontologjike, çdo përpjekje për të ndihmuar tjetrin kthehet në rrotullime drejt vetes. Spiralja, si strukturë narrative, shmanë përfundimin tradicional të romaniit. Ai nuk ka një mbyllje klasike, por pluskon në një lëvizje të hapur, midis braktisjes dhe qëndrimit, në një trajektore që nuk përfundon, por zhytet më thellë në të panjohurën. Kjo është natyra e spirales analitike, ajo nuk të çon asnjëherë në një “pikë fundore”, por në një greminë të vazhdueshme të përvojës dhe ndërgjegjes.

Në qendër të dilemës qëndron një konflikt: A mund të qëndrosh pranë dikujt që ka nevojë për ty, kur ti vetë nuk je më e mbrojtur nga trauma? Manualët e interpretimit psikosocial e ndalojnë këtë. Etika profesionale e ndalon gjithashtu. Por etika e përjetimit nuk mund të ndalojë spiralen që lëviz? Të dyja përvojat përshkruhen me heshtje, me fragmente të ndërprera si dhe me metafora të ngarkuara. Kjo bën që në ndërgjegjen e protagonistes, rrëfimi i Alfredit të rezonojë me kujtimet e saj. Kështu që procesi i përkthimit transformohet në pasqyrim të brendshëm. Kur ajo përkthen, nuk është thjesht “kanal neutral” por aktivizohen përvojat e veta dhe fillon t’i lexojë fjalët e tij edhe përmes filtrit të kujtesës së saj.

Edhe pse burimet janë të ndryshme ngjashmëritë strukturore të traumës janë të njejta, simptomat si ankthi, ndjenja e humbjes, pamundësia për tu rikthyer në normalitet, janë të ngjashme dhe krijojnë një përzierje të dhimbjes. Ky ngatërrim i bën kufijtë midis dëshmuesit dhe dëgjuesit të paqartë, përkthyesja bëhet bashkëprotagoniste e një narrative traumatike të dyfishtë.

Romani fiton thellësi psikologjike sepse nuk është më një përvojë e vetme, por një rrjet kujtimesh dhe përjetimesh të mbivendosura, që e vështirësojnë edhe procesin e shërimit.

Romani krijon një mozaik estetik të dy narrativave traumatike që pasqyrojnë dy anë të Ballkanit pas viteve ’90, luftën në Kosovë dhe tranzicionin shqiptar. Ngatërrimi i dy traumave nuk e zbeh vuajtjen e secilës, por tregon se dhimbja kolektive nuk respekton kufij shtetërorë. Ajo ka gjuhë dhe mekanizma të ngjashëm kudo. Madje, kjo mbivendosje ngre pyetje mbi rolin e dëshmitarit, a mund të dëshmosh për tjetrin pa u bërë pjesë e dhimbjes së tij?

Vlerësimi i romanit është i dyfishtë, për letërsinë shqipe sepse tregon që narrativa jonë, me të gjitha ngjyrat dhe kompleksitetin e saj historik, mund të artikulojë trauma universale me një gjuhë artistike të denjë për skenën ndërkombëtare. Por edhe për dramën dhe traumën e rajonit, sepse sjell në qendër jo vetëm plagën e Kosovës, por edhe plagët e heshtura të tranzicionit ballkanik, duke i ndërthurur në një mënyrë që lexuesit e huaj mund t’i kuptojnë e t’i ndiejnë ato. Në këtë kuptim, romani bëhet një urë etike dhe estetike, nga përvoja e dhimbshme individuale, në një reflektim kolektiv që i kalon kufijtë.

Romani “Misinterpretation” i Ledia Xhogës shfaqet si një fitore e dyfishtë, qoftë artistikisht, sepse arrin të ndërthurë me mjeshtëri dy kronotope të ndryshme të traumës ballkanike, luftën e Kosovës dhe tranzicionin shqiptar, në një narrativë të vetme, të ngarkuar me tension emocional dhe reflektim etik, por qoftë edhe nga ana kulturore, sepse dëshmon se letërsia shqipe mund të artikulojë plagë të thella historike me një gjuhë që depërton në ndërgjegjen globale. Ky roman nuk është vetëm dëshmi e një historie personale apo rajonale, por një akt i fuqishëm i kujtesës kolektive, që e shndërron dhimbjen në formë arti dhe e vendos zërin tonë letrar në hartën e dialogut ndërkombëtar.

Dyrrah 2025

“Gjithë dashnorët e natës”, ku ndër të tjera, flitet edhe për vetminë e një gruaje dhe dëshirën e saj për ta luftuar atë duke pirë... shumë!

DILEMA E DYFISHTË E IDEALIT FEMËROR

Jo Hamya/NYT

Në librin “Gjithë dashnorët e natës” të Mieko Kawakami-t, një korrektore letrare 34-vjeçare, Fujuko Irie, merr dy herë një shishe parfum ngjyrë të verdhë të zbehtë të markës luksoze Chloé. Të dyja shishet janë dhurata nga mikeshat e punës: fillimisht nga Hixhiri magjepsëse, një feministe neolibérale pa doreza, e cila e tregon tërheqjen e saj duke e angazhuar rregullisht Fujuko-n për punë si profesioniste e lirë; dhe më pas nga Kjoko, një redaktore në shtëpinë botuese të Tokios që Fujuko e lë në fillim të romanit, për të punuar vetëm.

Për të painformuarit, aromat Chloé janë, në mënyrë karakteristike, jofyese dhe të bukura — të buta, pudrore dhe të tregtuara si “femërore në thelb”, me reklama që paraqesin modele me flokë të shpupurishur e pamje natyrale. Gjatë një mbrëmjeje me pije, Hixhiri vëren se Fujuko nuk ka vënë makijazh dhe e pyet: “Nuk je një nga ato tipat natyralë, apo jo?” Jo një nga ato gratë që janë “të gjitha kështu, oh, unë jam kaq natyrale, thjesht duke qenë ajo që supozohet të jem.” Libri i tretë i Kawakami varet nga ky ngërç i dyfishtë i krijuar nga

ideali femëror: melankolia e lindur nga dështimi i pashmangshëm i një gruaje për t’iu përgjigjur standardeve të pamundura të bukurisë dhe pëlqyeshmërisë, e shoqëruar me mungesën e çdo kuadri tjetër të disponueshëm përmes të cilit ajo mund të shikojë veten ose bashkëmoshataret e saj.

Fujuko e vuan këtë *in extremis*. Me pak miq, pa hobi dhe një karrierë të vetmuar duke gjuajtur për gabime të imtësishme në dorëshkrimet e librave, ajo përqeshet nga gratë e tjera për pamjen e saj të zbehtë dhe mungesën totale të aftësive shoqërore, jetës familjare apo jetës romantike. Në punë ajo sakrifikon interesat dhe kuriozitetet e saj në shërbim të rregullave të vendosura të gramatikës, drejtshkrimit dhe verifikimit të fakteve — një ngurtësi që pasqyron qasjen e saj ndaj jetës në përgjithësi.

Kjo përqeshje, megjithatë, nuk e ndalon atë të gjykojë privatisht të tjerët në bazë të peshës, moshës, veshjes dhe normave shoqërore. Në pikën e parë të madhe të kthesës së romanit, ajo sheh pasqyrimin e saj në një dritare në një ditë vere, me sy të futur brenda dhe e shkujdesur. “Ajo që pashë

në pasqyrim isha unë,” vëzhgon ajo, “thjesht një grua e mjerë, që nuk mund të kënaqej as në një ditë të mrekullueshme si kjo, e vetme në qytet.” Menjëherë pas kësaj, Fujuko përpiqet të imitojë konsumin e alkoolit të Hixhiri-t duke e detyruar veten të pijë birrë dhe sake, gradualisht por me dashje, në mënyrë që të lirohet — ose siç e thotë ajo, “të heq dorë nga vetja ime e zakonshme.” Në një përpjekje të dehur për vetëpërmirësim, Fujuko regjistrohët për kurse në një universitet dhe përfundon duke vjellë në sallën kryesore të tij. Aty, ajo shpëtohet nga një mësues fizike, Mitsutsuka. Të dy krijojnë një miqësi ngurruese, duke u takuar çdo javë për të diskutuar “Berceuse” të Shopenit dhe vetitë e dritës, derisa formohet një tërheqje e heshtur, në dukje e ndërsjellë. Jashtë këtyre takimeve, Fujuko vazhdon të përshtatet me punën si profesioniste e lirë ndërsa pi në sasi të mëdha.

Ka një zgjuarsia në mënyrën se si “Gjithë dashnorët e natës” i trajton këto ndryshime, romantike dhe profesionale, në jetën e protagonistes së tij. Duke përfshirë alkoolizmin mes tyre, Kawakami i anashkalon klishetë e rrëfimeve të stisura të “përmirësimit rrënjësor” dhe e ruan Fujuko-n si një enigmë: ende e ngathët dhe e mjerë për pjesën më të madhe të romanit, por më e akorduar me ofertat e rreme dhe hipokrizitë e vetëimponuara që duron seksi i saj.

Një ribashkim me Kjoko-n më vonë në libër mbushet me një ironi që të shijon, teksa urimet e shoqes së saj për autonominë e re në karrierë të Fujuko-s shtrembërohen në një kritikë ndaj Hixhiri-t që ndjek të njëjtën gjë. “Ka shumë njerëz që duan ta nxjerrin veten në pah, duke konkurruar për vëmendje,” thotë Kyoko, “gjë që krijojnë shumë probleme për ne të tjerët. Por ti nuk ke pse të shqetësohesh për këtë, sepse ti nuk je ashtu.” Kyoko përsërit thashethemet për jetën seksuale të Hixhiri-t (“ajo nuk ka vetëkontroll”), duke ia atribuuar sigurinë e saj në vetvete pamjes së saj të bukur. “Të gjitha ambiciozet si ajo,” thotë ajo, “ato u bëjnë kaq shumë presion grave rreth tyre. ... Ajo i ka bindur të gjithë burrat, dhe të gjithë kolegët e saj, se gratë në zyrë duhet të jenë në lartësinë e shembullit të saj dhe të duken bukur ndërkohë që e bëjnë këtë.” Menjëherë pasi Kjoko denoncon Hixhiri-n vjen zbulimi se zgjedhja e tyre e përbashkët e parfumit i lidh ato me të njëjtin standard bukurie.

Megjithatë, ajo që e bën romanin e Kawakami-t kaq brilant është të kuptuarit se pse gratë mund t’u përmbahen me dëshirë mënyrave regresive të feminitetit performativ, ndonëse e kritikojnë atë. Dëshira për t’u dashur nuk është gjë e vogël. Fujuko është skeptike ndaj një jete të zvogëluar nga pritshmëritë gjinore — në një moment, një e njohur e fëmijërisë i thotë Fujuko-s se mëmësia i ka grabitur pavarësinë financiare dhe ndjenjën e vetvetes, ndërsa, me të njëjtën frymë, i kërkon Fujuko-s të bëjë fëmijë — dhe megjithatë, joshja e një jete me Mitsutsuka-n është e mjaftueshme për ta bërë atë të provojë. Ndoshta e ndikuar nga ëndrrat e përsëritura në të cilat një version i saj jeton në lumturi shtëpiake, por pastaj transformohet në Hixhiri-n, Fujuko merr pjesë në takimin e saj të parë (dhe të fundit) zyrtar me Mitsutsuka-n me rrobat e Hixhiri-t, me flokë të krehur me tharëse, e lyer me makijazh.

Tragjedia kulmore në “Gjithë dashnorët e natës” nuk është zbulimi shqetësues i Mitsutsuka-s pas këtij takimi, por një frazë e qetë, mizore nga Hixhiri që i bën jehonë qëllimisht një traume që Fujuko ka përjetuar në adoleshencë. Romani i Kawakami-t është pa kompromis i sinqertë në vlerësimin e dëmit që gratë i shkaktojnë njëra-tjetrës, duke mos i humbur kurrë nga sytë strukturat gjithëpërfshirëse që i çojnë ato ta bëjnë këtë në radhë të parë. Kompakt dhe elastik, është një arritje jashtëzakonisht inteligjente.

Nga autorja bestseller e “Gjinj dhe vezë” dhe “Qielli”

GJITHË DASHNORËT E NATËS



MIEKO KAWAKAMI

OnufriRoman

Si të rrëfesh një histori për luftën, Semigrimin dhe identitetin, kur krijesa e vetme që të dëgjon është një mace që flet e nuk ndalet së thëni të vërtetën? Në romanin *“My Cat Yugoslavia”*, realiteti shpërbëhet si flamuri i një shteti që nuk ekziston më, e në vend të tij ngrihen kujtimet, kafshët që flasin dhe të kaluarat që nuk duan të qëndrojnë të varrosura. Një roman i plumbtë, i ngurtë dhe i zymtë për vetminë, dëshpërimin dhe fantazmat e një atdheu që nuk e ka pranuar kurrë njeriun e vet. Nuk është veç historia e një djali dhe e nënës së tij, por një reflektim i ftohtë për boshllëkun që lind kur njeriu mbetet i përjashtuar nga çdo hapësirë ku pretendohet të ndihet i pranuar, qoftë në shtëpinë e fëmijërisë, në trupin e vet, në gjuhën e nënës, apo në marrëdhëniet që kërkon për të mbajtur shpirtin gjallë. Macja që shfaqet në këtë roman është një shenjë e mjegullt, një simbol i një marrëdhënieje të krisur, ku gërshetohen fantazia, historia dhe realiteti, duke e lënë lexuesin të përhumur mes konfuzionit dhe frikës së pafundme.

Nga Kosova në Helsinki, por kurrë në shtëpi

Romani i Statovci është një thikë me dy tehe: në njërin anë qëndron Emineja, një vajzë kosovare, e dhunuar, e shtypur, e martuar pa dashuri; ndërsa në anën tjetër, Bekimi, djali i saj i rritur, i cili jeton në Finlandë, mes refuzimit të gjithçkaje që ka trashëguar dhe zbrazëtisë që nuk mbushet as me seks, as me mace, as me kujtime.

Dy rrëfime që rrjedhin paralelisht dhe nuk takohen asnjëherë, sepse ngjarjet e Emineje nuk trajtohen veç si mirazhe të historisë së nënës së Bekimit, por shtjellohen si një udhë e verbër e një epoke që Bekimi nuk mund ta kapërdijë dot, por as ta fshijë. Thellë-thellë, Bekimi është një krijesë që nuk e duron veten, sepse s’ka ditur kurrë ta ndërtojë një identitet që i pëlqen e që e përmbush; i përjashtuar si shqiptar, i përjashtuar si homoseksual, i përjashtuar edhe nga vetë macja me të cilën fle. Nga ana tjetër, Emineja, dikur vajzë e vogël e plot ëndrra, kalon një kalvar, të rrahur shpesh në kulturën shqiptare, ku është gjithçka, përveçse bashkëshorte me një fije lumturie.

Kur njerëzit më pyesin për emrin, zakonisht u them të vërtetën, por ndodh shpesh të them që quhem Majkëll, Xhon, Albert ose Henri, se kështu shmang pyetjen tjetër: nga je?

Macja që flet

Po ç’është kjo mace që flet? Një gitar i mbrapshtë? Një alegori? Një dashnor? Një diktator? Është gjithçka dhe asgjë në të njëjtën kohë. Është një zë që flet në mënyrë mizore, që tall dhe urdhëron, që bën seks dhe ngjall neveri, që përçmon gjithçka të Bekimit, qoftë tipar, fjalë apo veprim. Është një dhuratë e helmuar: një mace e stilit kafkian, që del nga

Një mace që flet, një identitet që hesht – Pajtim Statovci

Nga Xhoina Salaj

askundi dhe përbën gjithçka të errët që gjen te vetja.

Në fakt, është si një pasqyrë e atij që urren origjinën, trupin, të kaluarën; një formë magjike e vetëhomofobisë, vetëurrejtjes, vetëshkatërrimit, e zhveshur nga çdo ngushëllim fantastik; një projektim i brendshëm, i shpërfytyruar, i kafshëruar nga dëshira dhe urrejtja e gjithçkaje që shoqëria e ka mësuar Bekimin ta refuzojë, por që ai nuk mund ta shmangë. Është vite larg

maces së famshme *Hello Kitty*, por një robot me kthetra e me qime, që flet me gojën e tij pa u menduar dy herë.

Macja, simbol i fuqishëm e kompleks, shumëkuptimor, ngërthen një sërë temash që ndërliken me identitetin, dëshirën, pushtetin dhe dhunën. Ja disa nga shtresimet kryesore të simbolikës së saj:

- Dëshira dhe seksualiteti i shtypur

Macja që shfaqet në jetën e Bekimit si një krijesë joshëse, arrogante dhe

manipuluese, është një figurë që mishëron dëshirën seksuale të tij, por njëkohësisht edhe turpin, frikën dhe përbuzjen që ai ndien për veten. Ajo është si një partnere që e tërheq, por edhe e poshtëron, një pasqyrim i marrëdhënieve të tij toksike dhe të papërpunuara me veten dhe me seksualitetin në një shoqëri homofobe.

- Dhuna dhe kontrolli

Macja flet, jep urdhra, kontrollon, e poshtëron Bekimin, një entitet që e zhvesh nga vullneti. Në këtë aspekt, simbolizon zërin e brendshëm të dhunës që Bekimi ka përvetësuar nga fëmijëria e tij patriarkale dhe e mbushur me frikë. Macja është një trashëgimi e dhimbshme e traumës së tij, një projektim i asaj që i është bërë dhe që ai, në mënyrë të pavetëdijshme, e përsërit.

- Tjetri, i huaji, i panjohuri

Si një qenie që nuk është as njeri, e as kafshë, macja përfaqëson edhe diçka tjetër: një të huaj që flet me gjuhë të njohur, por sjell trishtim dhe ankth. Ajo është vetë Bekimi, por e çngjyrosur, e përçudnuar, e zbuluar në brendinë më të errët, si një alter ego.

- Satirë ndaj patriarkalizmit toksik

Sjellja e maces është një karikaturë e maskilizmit dominues: ajo është agresive, seksiste, e etur për kontroll dhe e pafuqishme emocionalisht. Përmes kësaj figure, Statovci ndërton një kritikë të nënkuptuar ndaj modeleve të burnnisë që rriten në shoqëritë e mbyllura dhe që më shumë shkatërrojnë sesa ndreqin.

- Element surreal që ndërton realitetin e fragmentuar të personazhit

Prania e një maceje që flet dhe vepron si njeri, e zhyt romanin në një atmosferë surrealiste, duke shprehur përmes absurdit atë që është e paarritshme përmes realitetit linear. Është mënyra se si trauma, dhuna dhe mërgimi përçohen jo vetëm si përvoja, por edhe si përjetime të përçudnuara, ku realja nuk është më e besueshme.

Pavarësisht se në shqip përdorim fjalën “mace” për kafshën femër dhe “maçok” për mashkullin, në libër përmendet vetëm fjala “cat” dhe pa përemra specifikes si “he” apo “she” për të identifikuar gjininë.

Sipas *The Guardian* dhe analizave të tjera, ata e referojnë macen si “it” apo “they”, duke nënkuptuar një trajtim neutral dhe jo personifikues. Macja



është më tepër një entitet antropomorf, ndaj mungesa e përshkrimit gjuhësor e bën gjininë të paqartë dhe jo pa qëllim, por zgjedhje letrare që i lejon të mbetet një figurë universale, misterioze dhe simbolike.

Molla e sherrit, figurë që lë gjurmë në dy kohë

Ngjitësi që lidh të dyja rrëfimet, jetën e Eminesë në Kosovën e viteve '80 dhe atë të Bekimit në Finlandën e sotme, është figura e babait: një prani toksike që, edhe kur mungon, vazhdon të helmojë hapësirën përreth. Si një mollë e ndaluar e dhunës dhe turpit, ai u mohon të dyve lirinë për të zgjedhur, për të dashur dhe për të qenë vetvetja. Emineja rritet nën peshën e një patriarkati brutal, ndërsa Bekimi, edhe pse i larguar gjeografikisht, mbart plagët e një babai që nuk e pranoi, nuk e deshi dhe e la të humbiste rrugën në një vend të huaj. Statovci e portretizon këtë figurë jo si personazh të plotë, por si një fuqi përçmuese që shemb ura dhe krijon qorrsoakë, si në jetën e nënës, ashtu edhe në atë të të birit; një traumë që nuk njihet kufij dhe që shndërrohet në makth të trashëguar.

Identiteti si shpërbërje

Romani nuk të ofron ngushëllim. Nuk ka personazhe që *përmirësohen*, nuk ka përballje heroike, por ka vetëm mjegull, dhe me bollëk madje. Edhe në çastet kur rrjedha e jetës së personazheve ndryshon, Statovci i rrotullon ata në të njëjtën vorbull, ku nuk janë asgjë më shumë sesa pasoja të rrëskut të vet. Petku i mjegullës që i bashkon është vetë realiteti i emigrimit, i përkatësisë së braktisur, i një shoqërie që të buzëqesh me ftohtësinë e një sistemi nordik.

Bekimi është gjithnjë në teh të thikës: i buzëqeshur në supermarket, i ftohtë në krevat, i thyer në mendime. Finlanda nuk është vendi i shpresës, por i heshtjes. Ai nuk e thyen dot atë heshtje, por e pranon, e gëlltit, e transmodelon në seks të shpejtë dhe rrëfime të zbehta pa lajlelule. Bekimi madje është një djalë që nuk qesh as kur flet e fle me macen.

Jugosllavia si mit e si turp, por sidomos si mallkim

Titulli është një enigmë poetike, po nga ato që s'ka nevojë për zgjidhje. "My Cat Yugoslavia", një kombinim absurd e i paprituri i një kafshe shtëpiake dhe një entiteti historik dhe gjeopolitik të rrënuar. Dhe ky absurditet është pikërisht thelbi i romanit: si të pajtohesh me një të kaluar që nuk e do, por nga e cila nuk mund të shpëtosh?

Jugosllavia nuk është më një vend, por për Eminënë dhe Bekimin mbetet ende një hije që i ndjek kudo që shkojnë. Është figura e të atit që kontrollon, e bashkëshortit që rreh, e komunitetit që përçmon. Për fat të keq, është gjithmonë aty, edhe kur nuk përmendet e nuk

ekziston më, si një nëntekst që nuk vdes, por thjesht ndryshon formë, si një mace rruge që vjen natën e të futet në shtrat.

Pjesa e parë e titullit, "My Cat", i referohet një lidhjeje personale, pothuajse emocionale, por në kontekstin e romanit ajo është gjithçka përveçse e ngrohtë apo e zakonshme. Macja është një figurë që përfaqëson të panjohurën, të frikshmen, të dëshiruarën dhe të neveritshmen njëkohësisht. Duke e konsideruar si të vetën, Bekimi i jep pronësi diçkaje, që në fakt, e sundon dhe e kontrollon, një marrëdhënie e ndërlikuar midis posedimit dhe nënshtrimit.

Nga ana tjetër, Jugosllavia është simboli i një atdheu që nuk ekziston më, një vend që është zhdukur nga harta, por që vazhdon të jetojë në kujtesën e njerëzve dhe në identitetin e personazheve. Për Eminënë, është vendi ku u rrit, u martua dhe ku u shtyp, ndërsa për Bekimin, është origjina që e ndjek si një hije në mërgim, që e përkufizon edhe kur ai përpiket ta mohojë. Jugosllavia mbetet sërisht aty, edhe pas shumë vjetësh, si një kujtesë e dhimbshme kolektive e të qenit pjesë e diçkaje që është shkatërruar.


Duke *ngecur* mes një krijese si macja dhe një shteti të zhdukur, titulli përfiton një ironi therëse, si një mënyrë për të shpalosur se trauma historike dhe ajo e identitetit është aq intime, aq personale, sa bëhet pjesë e pandashme e përditshmërisë, e dhomës, e mendimeve dhe e trupit. Ashtu si një mace që të shikon nga cepi i dhomës, edhe historia dhe rrënjët familjare nuk të lënë të jetosh i qetë, por gjenden gjithmonë aty, si një prani e heshtur, por jashtëzakonisht e fuqishme.

Nga ana tjetër, në romanin me titullin "Bolla" të të njëjtit autor, kafsha nuk është vetëm një prani enigmatike, por një forcë mitike që mishëron instinktet, fuqinë dhe të pamposhturit e natyrës së egër. Bolla shfaqet si një figurë arketipale, e ngarkuar me simbolika që lidhen me urën mes njeriut dhe tokës, me ciklet e jetës dhe vdekjes, si dhe me fuqinë e trashëgimisë kulturore. Në atë libër, kafshët janë shpesh një kanal për ritin dhe mitin, duke sjellë në pah një botë të fshehtë ku ligjet e natyrës dhe shpirtit bashkohen në një ekuilibër të brishtë. Përmes figurës së tij, libri trajton përplasjen mes instinkteve primitive dhe normave shoqërore, si dhe reflektimin mbi forcën që mund të ketë legjenda dhe trashëgimia në formësimin e identitetit personal dhe kolektiv. Kafsha këtu është më shumë se një simbol, por një entitet që sfidon përfytyrimet tradicionale të qenies njerëzore dhe sjell në pah dimensionet e padukshme të ekzistencës, përmes një lëvizjeje mes mitit dhe realitetit.

Tekefundit, tek të dy librat përdoren kafshët si figura kyçe për të tjerë gjerë e gjatë tema ekzistenciale dhe kulturore, por në mënyra të ndryshme: macja shërben si një pasqyrë e identitetit të copëtuar dhe e historisë së trazuar, ku përzihen kujtimet personale me ato kolektive, ndërsa bolla përfaqëson fuqinë e egër dhe mitike të natyrës, si dhe lidhjen rituale me trashëgiminë shpirtërore.

"A marvel, a remarkable achievement, and a world apart from anything you are likely to read this year."

—Téa Obreht, *The New York Times Book Review*



Shqipja si kujtim dhe si peng

Në veprat e Statovcit, lënia me kast në shqip e disa shprehjeve dhe fjalëve tipike të vendit tonë, ruan në mënyrë të ndërgjegjshme frymën e jetës rurale dhe urbane. *Nënë, hallë, kanagjegj, bukë, byrek*, e dhjetëra të tjera, nuk shërbejnë vetëm si shenja autentike të origjinës së personazheve, por si dritare drejt një bote që nuk është më, një bote që jeton vetëm në kujtesë dhe në gjuhë. Në këtë mënyrë, Statovci ndërton një tekst ku gjuha bëhet një mënyrë për të ruajtur identitetin, por edhe për ta ndier si barrë mbi supe. Traditat shqiptare, si dasmat, ritet e burrërisë, zakonet e nderit dhe të turpit nuk shpjegohen, por ekspozohen, si për të na treguar se ato janë aty, të paprekshme dhe të pashpjegueshme për të huajin, por tepër të njohura për vendasit.

Proza e akullit, e mprehtë dhe e heshtur e Statovcit

Statovci shkruan si kirurg: nuk ka ngarkesë emocionale dhe nuk i dridhet qerpiku. Ka fjali të thjeshta, që të godasin me shkëlqimin dhe mprehtësinë e akullit. Proza e tij nuk bërtet, por të vret me heshtje. Nuk përpiket t'i sjellë personazhet simpatikë (një nga aktet më të guximshme që mund të bëjë një shkrimtar), të mos kërkojë falje për trishtimin që të jep.

Lexuesit që kërkojnë ngrohtësi, rritje personale apo klimaks emocional, do të zhgënjehen, ama ata që dinë të vëzhgojnë si ndodhin thyerjet e mëdha ashtu nën qetësi, do të gjejnë në këtë roman një dritare të veçantë për dhimbjen e brendshme që nuk shpërthen, por të gërryen nga dita në ditë. Ky është një roman për ata që nuk ndihen në asnjë vend si *guri i rëndë*; për ata që e kanë harruar gjuhën e nënës dhe nuk duan ta mësojnë të të atit; për ata që flenë me mall dhe zgjohen me neveri; për ata që ndihen të ndryshëm, edhe mes të përjashtuarve.



Karikaturë nga Arben Mexi